




Hëna e Re

Viti XXXV | Nr.371 | Gusht 2022 | Muharrem - Safer 1444 | Çmimi 50 den

99 emrat më të bukura të Allahut (xh. sh.): Mozaik nga Zeqir Memeti, Zhelina, Tetovë



Nga Sunneti: Koha për t'u radhitur

BFI KONKURRON ME VLERA

Dy segmente janë të rëndësishme për çdo institucion - në veçanti, për institucionin e lartë siç është BFI e RMV, edhe atë: kultivimi i vlerave morale, i frymës shpirtërore dhe ngritja e profesionalizmit dhe strategjisë për të ardhmen e organizimit të jetës në përgjithësi.

Këto dy segmente janë shtyllat kryesore të lëvizjes sonë drejt një rrugëtimi të pastër dhe konkurrimit me vlera.

Koha bashkëkohore është ambient i një dinamizmi të paparë në të gjitha sferat: në atë fetare, morale, ekonomike, sociale, politike, shkencore etj.

Andaj, për të notuar në këtë oqean dinamik kërkohet hyrje në skenën e konkurrimit të vlerave, që nuk njeh asgjë tjetër pos vetëm veprim dhe aksion.

Teoria dhe fjala kanë kuptim vetëm atëherë kur përcillen prej veprave, andaj veprimi pozitiv është arsyeimi i ekzistencës së çdonjërit në kohë dhe në vend dhe përgjigjja më e mirë kundër neglizhencës, parazitizmit, destruktivitetit, agresivitetit, sfidave etj.



Vetëm në këtë mënyrë do të jemi bartës të denjë të misionit islam në kohë dhe në vend.

/6.08.2022/

Bashkësia Fetare Islame e RMV (Shaqir ef. Fetahu, Facebook)

EMRI ALLAH

Në Kuran emri ALLAH është përdorur 2.690 herë. Po t'ia shtojmë kësaj edhe emërtimin që rrjedh po prej këtij emri, "Lil-lah", ose "ilah", ose "lehu", ose "huve", atëherë del se ai është përmendur mbi 2.700 herë.

Emri ALLAH do të thotë se nuk ka të adhuruar tjetër që meriton të adhurohet përveç Tij.

Duhet ditur se vetëm me emrin Allah plotësohet dëshmia islame, e cila është: "La ilahe il-la Allah, Muhammedun resulullah."

Allahu i ka 99 emra apo veti. Bashkë me "Allah" bëhen 100. Me këtë emër të lartë hyjnor fillojmë çdo punë dhe me këtë emër hapen të gjitha kaptinat e Kuranit: **Bismil-lahi Rrahmani Rrahim.**

Lista e emrave: 1. **ALLAH** – Zot; 2. **ER-RAHMAN** - i Gjithëmëshirshëm; 3. **ER-RAHIM** - Mëshirëplot; 4. **EL-MELIK** – Sundues; 5. **EL-KUDDUS** - i Pastër, i Shenjtë, i Shndritshëm; 6. **ES-SELAM** – Paqëdhënës; 7. **EL-MU'MIN** – Sigurues dhe Mbajtës i premtimit; 8. **EL-MUHEJMIN** – Mbi-zotërues, Mbikëqyrës; 9. **EL-AZIZ** – Fuqplot, Madhështor; 10. **EL-XHEBBAR** - i Gjithëfuqishëm, Mbizotërues; 11. **EL-MUTEKEBBIR** - i Madhërishtëm; 12. **EL-KHALIK** – Krijues; 13. **EL-BARIU** – Fillues (me vullnetin e Tij zbatohet urdhri hyjnor "bëhu!"); 14. **EL-MUSAVVIR** – Formëdhënës; 15. **EL-GAFFAR** – Gjithëfalës; 16. **EL-KAHHAR** – Mposhtës; 17. **EL-VEHHAB** – Dhurues; 18. **ER-RREZAK** – Furnizues; 19. **EL-FETTAH** – Zgjidhëdhënës; 20. **EL-'ALIM** - i Gjithëditur; 21. **EL-KABID** – Shtrengues; 22. **EL-BASIT** – Dhënë; 23. **EL-HAFIDU** – Përlules; 24. **ER-RAFIU** – Lartësues; 25. **EL-MUIZZU** – Ngritës; 26. **EL-MUDHIL-L** – Nënshtrues; 27. **ES-SEMI'U** – Dëgjues; 28. **EL-BESIR** – Vështrues; 29. **EL-HAKEM** – Gjykues; 30. **EL-'ADL** - i Drejtë; 31. **EL-LETIF** - i Butë; 32. **EL-KHABIR** - i Gjithinformuar; 33. **EL-HALIM** – Përdëllimtar (Mëshirues); 34. **EL-ADHM** – Madhështor; 35. **EL-GAFUR** – Falës; 36. **ESH-SHEKUR** – Mirënjohës; 37. **EL-ALIJJ** - i Lartë; 38. **EL-KEBIR** - i Madh; 39. **EL-HAFIDH** – Ruajtës; 40. **EL-MUKIT** – Ushqyes; 41. **EL-HASIB** – Llogarimarrës; 42. **EL-XHELIL** – Fisnik; 43. **EL-KERIM** – Bujar; 44. **ER-RREKIB** – Vigjilues; 45. **EL-MUXHIB** – Lutjepranues; 46. **EL-VASIU** – Gjithëpërfshirës; 47. **EL-HAKIIM** - i Urtë; 48. **EL-VEDUD** - i Dashur; 49. **EL-MEXHID** - i Lavdishëm; 50. **EL-BAITH** – Ringjallës; 51. **ESH-SHEHID** – Dëshmues; 52. **EL-HAKK** - i



Vërtetë; 53. **EL-VEKIL** – Përkujdesës; 54. **EL-KAVIJJ** - i Fortë; 55. **EL-METIN** - i Pathyeshëm; 56. **EL-VELIJJU** – Mbrojtës; 57. **EL-HAMID** - i Falënderuar; 58. **EL-MUHSI** – Gjithënjohës; 59. **EL-MUBDI** – Nismëtar; 60. **EL-MU'ID** – Rikrijues; 61. **EL-MUHJI** – Jetëdhënës; 62. **EL-MUMIT** – Jetëmarrës; 63. **EL-HAJJ** - i Gjallë; 64. **EL-KAJJUM** - i Përtjetshëm; 65. **EL-VAXHID** – Kreator i Universit; 66. **EL-MA-XHID** - i Nderuar; 67 & 68. **EL-VAHID, EL-EHAD** - Një i Vetëm; 69. **ES-SAMED** – Strehimtar; 70. **EL-KADIR** - i Fuqishëm; 71. **EL-MUKTEDIR** - i Gjithëmundshëm; 72. **EL-MUKADDIM** – Nismëtar; 73. **EL-MUEHHIR** – Paslënës (që vonon ndonjë dënim ose ndëshkim); 74. **EL-EVVELU** - i Parë; 75. **EL-AKHIRU** - i Fundit; 76. **EDH-DHAHIRU** - i Dukshëm; 77. **EL-BATINU** - i Padukshëm; 78. **EL-VALI** – Udhëheqës; 79. **EL-MUTEALI** - i Gjithëlartësuar; 80. **EL-BERR** – Mirëbërës; 81. **ET-TEVVAB** – Pendimpranues; 82. **EL-MUNTEKIM** – Ndëshkues; 83. **EL-AFUVVU** – Mëkatfalës; 84. **ER-RREUF** - i Dhembshur; 85. **MALIKUL-MULK** – Pushtetmbajtës; 86. **DHUL-XHELALI VEL IKRAM** - Atij i takon madhështia dhe nderi. I Vetmi absolut, i përsosur në cilësitë e Tij; 87. **EL-MUKSIT** – Drejtësidhënës; 88. **EL-XHAMIU** – Tubues; 89. **EL-GANIJ** - i Pasur; 90. **EL-MUGNI** – Pasuridhënës; 91. **EL-MANI'U** – Privues; 92. **ED-DARRU** – Dëmsjellës; 93. **EN-NAFI'U** – Dobiprurës; 94. **EN-NUR** – Dritë; 95. **EL-HADI** – Udhëzues; 96. **EL-BEDIU** – Shpikës; 97. **EL-BAKI** - i Përhershëm; 98. **EL-VARITH** – Trashëgues; 99. **ER-RESHID** – Frymëzues; 100. **ES-SABUR** – Durimtar. (Wikipedia/desk/HeR)

EDITORIAL

35 VJET "HËNA E RE"

Viti 2022 shënon 35-vjetorin e botimit të numrit të parë të revistës "Hëna e Re", me ç'rast botuesi i saj, Rijaseti i Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë së Veriut do të organizojë konferencë shkencore më 28-29 shtator të këtij viti, në Shkup, me temë: "Hëna e Re" - 35 vjet jetë mes sfidave dhe suksesit".

Me qëllim që të sensibilizohet konferenca në fjalë, për të marrë pjesë në të sa më shumë punonjës shkencorë, në vijim me disa rreshta do të vëmë në spikamë rolin, rëndësinë dhe kontributin e kësaj reviste dhënë në zhvillimin e jetës fetare islame në këtë nënqiell.

Rrugëtimin e saj "Hëna e Re" e filloi para tridhjetë e pesë viteve, pikërisht në muajin maj të vitit 1987. Botimi i saj ishte një dritë në fund të tunelit, që jepte shpresë për përfundimin e sistemit të njëmendësisë, sistem ky që për botimet në gjuhën shqipe ishte shumë i vështirë, ngase përpos ngufatjes dhe reduktimit të botimeve, ato u nënshtroheshin kontrolleve të rrepta. Dalja e saj në dritë, njëherësh, plotësoi boshllëkun në sferën e informimit të mirëfilltë të pjesëtarëve të Islamit lidhur me aktivitetet e nduarnduarta të jetës fetare-islame që bëhen nga BFI.

"Hëna e Re" nëpër vite pati një rrugëtim përplot sfida dhe vështirësi, të cilat i tejkaloi me sukses, duke kryer misionin e saj për të cilën edhe është themeluar. Ajo me kujdes të madh ka bërë bartjen e dijes, kujtesës, informatës, përvojës njerëzore prej gjeneratës në gjeneratë, duke u shndërruar kështu në një përkujtues i përpiktë i ngjarjeve gjatë kësaj periudhe.

Andaj, në revistën "Hëna e Re" gjejmë shumë informata të rëndësishme rreth shpërbërjes së federatës ish-jugosllave, luftërave që ishin rezultat i kësaj shpërbërjeje, qëndrimet dhe veprimet e Bashkësisë Fetare Islame ndaj këtyre ngjarjeve. Në të përshkruhen edhe shumë skena të dhimbshme të popullatës myslimane nga Bosnja dhe nga Kosova, e cila ishte e detyruar të marrë rrugën e refugjatit, për të ikur nga vrasjet dhe torturat e agresorëve. Po ashtu, "Hëna e Re" rëndësi të madhe i kushtoi shuarjes së sistemit enverist dhe lindjes së sistemit demokratik në Shqipëri, ku për këtë botoi edhe një numër special kushtuar lejimit të feve, pas një ndalesë administrative disavjeçare në këtë vend.

Revista "Hëna e Re" gjatë kësaj periudhe ka qenë edhe një mejdan i punimeve të shumta nga sferat e ndryshme të shkencave islame, por jo vetëm, sepse në të janë botuar edhe shumë punime të karakterit kulturor dhe informativ. Përmbajtja e Revistës është e pasur, me shumë punime dhe studime të çmuara nga sfera teologjike, nga autorë të respektuar të hapësirës kulturore dhe shkencore të vendit tonë, por edhe më gjerë. Pos kësaj, Revista sjell studime nga disa disiplina shkencore: mjekësia, gjuhësia, letërsia dhe historia, nga autorë të respektuar.

S'ka dyshim se kjo revistë, gjatë këtij rrugëtimi, lexuesit i ofroi një përmbajtje cilësore falë bashkëpunëtorëve të përkushtuar, punës përkushtuese të autorëve dhe redaktorëve të saj. Duke u nisur nga fakti se në histori mbetet fjala e shkruar, numrat e botuar gjer më tani janë tejet të rëndësishëm edhe për lexuesin e sotëm, por edhe për lexuesin e së nesërme. Numrat e deritashëm të saj flasin për shumëçka. Thënë ndryshe, secili numër i saj mund të shërbejë si referencë për studentët dhe studiuesit, sfera studimore e të cilëve është zhvillimi i jetës fetare-islame në organizim të BFI-së.

Ajo, edhe sot, edhe në të ardhmen, me ndihmën e Allahut (xh. sh.) e vazhdon rrugëtimin e saj, duke i ofruar publikut dije fetare në mënyrën më të qartë, më të kuptueshme, më të thjeshtësuar, sa më bindëse dhe profesionale; ofron mësim të thukëta fetare, kulturë të gjerë për ta kuptuar fenë në mënyrë të mirëfilltë e të drejtë, pa shtrembërime, pa mjegullina, ashtu siç i ka zbritur Muhamedit (a. s.).

Në të hidhet dritë mbi shumë çështje e probleme, duke e paraqitur Islamit në mënyrën sa më autentike, nga burimet e Shpalljes së pastër, me qëllim që të ofrojë arsimim e kulturë për popullin tonë, që të dalë nga padija dhe mosnjohja e fesë së cilës i takon dhe për të ndriçuar mendjet e tyre me Islamit burimor, me gjuhën e argumentit, të fakteve dhe studimeve të përpikta të dietarëve të shquar islamë.

Q. Osmani



KONFERENCË SHKENCORE NË 35-VJETORIN E “HËNËS SË RE”



Rijaseti i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me rastin e 35-vjetorit të revistës “Hëna e Re” (1987-2022) më 28-29 shtator, 2022, në Shkup do të organizojë Konferencën shkencore më temë: “Hëna e Re, 35 vjet jetë mes sfidave dhe suksesit”, thuhet në njoftimin e BFI.

TEZAT E MUNDSHME TË KONFERENCËS:

- Themelimi, rritja dhe zhvillimi i gazetës-revistës “Hëna e Re”;
- Tri dekada e gjysmë të “Hënës së Re”;
- Rrethanat shoqërore-politike në RMV në filllet e daljes së “Hënës së Re”;
- Kontributi i “Hënës së Re” në ngritjen e mendimit fetar dhe kombëtar;
- Kontributi i “Hënës së Re” në fushën e edukimit dhe të arsimimit islam në vendin tonë;
- Kontributi i “Hënës së Re” në fushën e ruajtjes së trashëgimisë islame;
- Kontributi i “Hënës së Re” në ruajtjen e unitetit fetar në RMV dhe më gjerë;
- Kontributi i “Hënës së Re” në fushën informimit;
- Kontributi i “Hënës së Re” në kultivimin e tolerancës dhe të mirëkuptimit ndërfaqet dhe ndërnacional;
- Kontributi i “Hënës së Re” në promovimin e vlerave fetare dhe kombëtare;
- Kontributi i “Hënës së Re” në kultivimin e shkencave islame, siç janë: tefsiri, hadithi, fikhu, historia etj.
- Kontributi i “Hënës së Re” në ruajtjen dhe denacionalizimin e pronës së vakëfit në RMV;
- Trajtimi i rikthimit të lirisë fetare në Republikën e Shqipërisë pas viteve ‘90 në “Hëna e Re”;

- Trajtimi i luftës dhe i krizës humanitare në Republikën e Bosnjës në “Hëna e Re”;
- Kontributi i “Hënës së Re” në trajtimin e luftës dhe të krizës humanitare në Republikën e Kosovës;
- Pasqyrimi i konfliktit të vitit 2001 në “Hëna e Re”;
- Kontributi i “Hënës së Re” në ngritjen dhe promovimin e familjes;
- Kontributi i “Hënës së Re” në promovimin e figurave islame dhe kombëtare;
- Kontributi i “Hënës së Re” dhe ndikimi i saj tek Mërgata;
- Mërgata shqiptare në “Hëna e Re”;
- Kontributi i “Hënës së Re” në arsimimin e femrës myslimane në përgjithësi;
- Sfidat dhe problemet me të cilat ballafaqohet revista “Hëna e Re” në kohën e digjitalizimit
- Etj.

Konferenca do të jetë dyditore dhe në të ftohen të marrin pjesë studiues nga Maqedonia e Veriut, nga Shqipëria, Kosova, Mali i Zi, Lugina e Preshevës dhe nga Mërgata. Studiuesit, titullin e temës dhe abstraktin duhet t’i paraqesin deri më 10 shtator 2022. Kumtesa për lexim mund të jetë prej 3-5 faqe, kurse për botim maksimum deri në 15 faqe.

Temat e paraqitura, që nuk kanë të bëjnë me temën bosht të Konferencës, nuk pranohen.

Me respekt, nga Këshilli organizativ.

Kontakti:
E-mail: konferenca35hr@gmail.com
Tel: +389 75 374 414
+389 75 374 404
+389 79 212 121

(26.07.2022)

PËR EDUKIMIN E FËMIJËVE TANË

Në vend që të merremi me Facebook dhe Instagram, le të flasim me fëmijët për jetën e personaliteteve të mëdha. T’u lexojmë libra me tregime të moralshme, që flasin për sjellje shembullore, për trimëri, për mëshirë.

Youtube dhe Tik-Tok shfaqin një botë ëndrrash që nuk i përgatit fëmijët për sfidat e jetës.

Tematikat e filmave vizatimorë po-

thuajse aspak nuk janë edukative dhe shtrembërojnë realitetin.

Investimin që do të bëjmë sot duke i edukuar, do t’ia shohim dobinë nesër. Ndërkaq, prindërit që sot janë rehat derisa fëmijët e tyre edukohen me internet, do t’ia shohin dëmin nesër. (27.07.2022)

Përgatiti: **Arlind Musliu/**
në bashkëpunim

BFI PËRUIROI VEPRAT E AKADEMIK HASAN KALESHIT NË KËRÇOVË

BASHKËSIA FETARE ISLAME NË R.M.V.

Me rastin e 100 vjetorit të lindjes së akademik Hasan Kaleshit
Organizon përrurimin e veprave të
HASAN KALESHIT
VEPRA: 1 - 2 - 3 - 4 - 5 - 6 - 7 - 8

30.07.2022 (e shtunë) ora 11:00 Pallati i Kulturës - Kërçovë

Pjesëmarrja e juaj nderon veprat e akademik Hasan Kaleshit dhe neve.

Më 30 korrik, 2022, në Pallatin e Kulturës në Kërçovë u përruruan veprat e akademik Hasan Kaleshit, organizuar nga Bashkësia Fetare Islame e RMV, thuhet në njoftimin e BFI.

Prezent ishin figura të jetës fetare dhe publike, në mesin e të cilëve Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës Myftiu mr. Naim ef. Tërnavë, Myftiu i Kërçovës z. Qamil ef. Rushiti, Myftiu i Shkupit dr. Qenan ef. Ismaili, Myftiu i Tetovës prof. dr. Qani ef. Nesimi, Myftiu i Gostivarit h. Sabahudin ef. Zendeli, z. Ali Ahmeti nga Bashkimi Demokratik për Integritim, Zv/Ministri i Arsimit dhe Shkencës prof. dr. Lulzim Aliu, Kryetari i Komunës së Kërçovës Fatmir Dehari, Kryetari i Komunës së Pllasnicës Alija Jaoski, akademikët e respektuar/autorë të librave të Hasan Kaleshit: akad. dr. Feti Mehdiu dhe akad. dr. Muhamed

Mufaku, Kryetari i KMSHZ (DAIGS) Mehas ef. Alija dhe Kryetari i Kuvendit të KMSHZ, Kryetari i Kuvendit të BFI-së Fejsal ef. Kadriu, drejtues të institucioneve brenda vendit, imamë dhe shumë personalitete të shquara të jetës shkencore, akademike, shoqërore dhe fetare.

Akademik Feti Mehdiu foli rreth ecurisë së botimeve dhe perspektivës së prezantimit të figurës së akademik Hasan Kaleshit, prof. Qerim Lita foli në rolin e referuesit, duke dhënë sqarime rreth të vërtetave të këtyre veprave dhe jetës së Kaleshit, akad. Muhamed Mufaku foli për planet dhe perspektivën e së ardhmes së botimeve për jetën dhe veprën e Hasan Kaleshit në gjuhë të ndryshme dhe mr. Elez Ismaili, në mbyllje, doli me propozimin konkret për emërtimin e ndonjë/disa institucioneve me emrin e Hasan Kaleshit.

Gjithashtu, me video-mesazhe u paraqitën akad. Esat Durakoviç në gjuhën boshnjake, dr. Basem al-Zu’bi në gjuhën arabe, ndërkaq miku i Hasan Kaleshit, z. Idriz Lamaj, për herë të parë shfaqti për publikun letrën që akademik Kaleshi ia kishte shkruar 11 ditë para se të mbyllte sytë përgjithmonë.

Në fund të aktivitetit, Kryetarët e dy Bashkësive Islame dhe Kryetari i Komunës ndanë mirënjohje për autorët dhe ata që ndihmuan në realizimin e përrurimit të veprave të Kaleshit.

Pas aktivitetit, Kryetari i Komunës së Kërçovës shtroi një drekë modeste për mysafirët, thuhet në njoftimin e BFI.

Botuar nga Shoqata e Orientalistëve të Kosovës, në Institutin Albanologjik të Prishtinës janë përruruar kohë më parë katër vëllime që përmbledhin studimet e Hasan Kaleshit në 100-vjetorin e lindjes së tij.

SHAQIR EF. FETAHU PËR AKADEMIK HASAN KALESHIN

Në fjalën e rastit më 30 korrik, 2022, në Kërçovë, në 100-vjetorin e lindjes së akademik Hasan Kaleshi, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, Kryetar i BFI të RMV, tha:

Të nderuar të pranishëm,

Sot të gjithë ne ndihemi krenarë për këtë eveniment kulturor, me ç'rast përurorim veprat e dr. Hasan Kaleshit në 100-vjetorin e lindjes së tij. Jemi krenarë nga fakti se nga gjiri i popullit tonë u lind një figurë markante akademike shkencore me përmasa ndërkombëtare, u lind një nga figurat më të shquara shqiptare, i cili shquhet për kontributin e tij në shumë lëmenj shkencorë si: filologji, albanologji, letërsi, histori, etnografi, shkencat orientale etj.

S'ka dyshim se tabanin e rrugëtimit shkencor, në sferat e përmendura, akademik Hasan Kaleshi e përfitoi nga gjyshi i tij, myderrizi Ali efendiu, i cili studimet e larta i kishte kryer në Stamboll; po ashtu edhe nga babai i tij, myderrizi Adem efendiu, i cili kishte studiuar teologjinë në "Fatih", institucionin më të lartë dhe më të njohur të asaj kohe në Stamboll.

Pra, Hasan Kaleshi rrjedh nga një familje e njohur besimtare, intelektuale e këtij nënqielli. Aftësinë e tij intelektuale akademik Hasan Kaleshi e tregoi qysh si fëmijë, ku krahas mësimve fillestare, nga prindërit e mësonte edhe Hifzin dhe në moshën dhjetëvjeçare Hasani i vogël e mori titullin Hafëz i Kuranit Famëlartë.

Gjatë shkollimit të tij, qoftë në shkollën e mesme apo fakultet, dr. Hasan Kaleshi tregoi afinitet të madh për nxënie të diturisë në sferat e gjuhësisë. Andaj, ai shquhet edhe si poliglot i vërtetë, sepse i zotëronte pothuajse të gjitha gjuhët kryesore lindore dhe perëndimore; përveç gjuhës shqipe, serbe, kroate, boshnjake, bullgare, zotëronte për bukuri turqishten, osmanishten, arabishten, persishten, italishten, frëngjishten, gjermanishten dhe anglishten.

Përgatitja dhe aftësia e tij shkencore e bënë atë njërin ndër studiuesit më të njo-



hur të orientalistikës, të gjuhësisë, të historisë, kulturës, letërsisë, ndërsa, konsiderohet emblema e shkencave orientale të shqiptarët. Se sa i përgatitur shkencërisht ka qenë dr. Hasan Kaleshi, tregon edhe fakti se ai ka marrë pjesë me kumtesa, studime, punime të ndryshme shkencore në mbi 40 simpoziume, konferenca shkencore, në Evropë, Amerikë, Azi dhe Afrikë. Ka ligjruar në universitetet kryesore të botës: në Paris, Hamburg, Berlin, Muni, Vjenë, Stamboll, Romë, Ankara, Kajro, Nju-Jork, Çikago, Athinë, Sofje, kuptohet edhe në Prishtinë, në Tiranë etj. Për rreth një çerek shekulli botoi rreth katërqind punime të ndryshme: kritika, polemika, artikuj, studime, përkthime, në disa gjuhë të huaja, si dhe në gjuhën shqipe.

Veprimtaria studimore e dr. Hasan Kaleshit përfshihet në tri kategori kryesore:

1. Trashëgimia kulturore shqiptare – gjuha dhe letërsia shqipe.
2. Trashëgimia kulturore arabo-islame.
3. Trashëgimia kulturore osmanoturke.

Në kontributin e tij për çështjen kombëtare, vërehet se dr. Hasan Kaleshi ka qenë kritik shkencor i guximshëm. Kjo vërehet edhe në studimin e tij me titull "Letërsia bashkëkohore shqipe në Jugosllavi", të publikuar në vitin 1952, me qëllimin që t'ua paraqiste letërsinë shqipe sa

më shumë popujve të tjerë në Jugosllavi, të cilët me shumicë mendonin se shqiptarët nuk janë veçse furraxhinj, bozaxhinj, sharraxhinj.

Guximi i dr. Hasan Kaleshit për të thënë të vërtetën për çështjen shqiptare vërehet edhe në një tezë të re të tij, e cila ishte në kundërshtim me historiografinë shqiptare të kohës, e cila me depërtimin e osmanlinjve në Ballkan dhe me islamizimin e shqiptarëve gjen vetëm elemente negative. Në këtë studim dr. Hasan Kaleshi në tezën e vet, ndër të tjera, shkruan:

"Në kohën kur shqiptarët ishin pa shtet, pa kishat e tyre, pa traditë kulturore, pa shkollë, të rrethuar nga Bizanti në një anë, nga shteti serb në anën tjetër, nga Venediku në anën bregdetare, me këto rrethana nuk ka pasur fare gjasa të ekzistonte si komb; me depërtimin turk në Ballkan, me shkatërrimin e Bizantit, të shtetit serb, si dhe me çorientimin e kishave të tyre, pengohet asimilimi i shqiptarëve nga elementet e lartpërmendura."

Sa më shumë të flasësh për figurën e dr. Hasan Kaleshit, aq më shumë vërehet se shumë pak thuhet për të, në krahasim me veprimtarinë krijuese të tij. Duke i dëshiruar suksese këtij tubimi, ndihemi borxhlinj që në të ardhmen institucionalisht t'i përkushtohemi sa më shumë dr. Hasan Kaleshit, i cili për gjeneratat e reja është shkollë më vete.

Ju faleminderit.

NJOFTIMI I BFI-së

Bashkësia Fetare Islame e RMV që në datën 25.07.2022 doli me njoftimin në të cilin thuhej:

Me rastin e 100-vjetorit të lindjes së akademik Hasan Kaleshit, Bashkësia Fetare Islame e RMV organizon përvurimin e veprave 1-8 të akademik Hasan Kaleshit. Vendi: Pallati i Kulturës në

Kërçovë. Data: 30.07.2022 (e shtunë). Koha: 11:00. Jeni të mirëseardhur të gjithë.

"Shqiptari i madh nga Kërçova u detyrua të linte vendin e punës në Fakultetin Filologjik të Beogradit nga presioni i Fehim Bajraktareviqit dhe..." - studimi i historianit Qerim Lita për ve-

prën e prof. dr. Hasan Kaleshit është botuar në Memorie.al, me të drejta të rezervuara, në këtë vegëz: <https://memorie.al/shqiptari-i-madh-nga-kercova-u-detyrua-te-linte-vendin-e-punes-ne-fakultetin-filologjik-te-beogradit-nga-presioni-i-fehim-bajraktareviqit-dhe-studimi-per-vepren-e>

FETI MEHDIU: PËR KONTRIBUTIN E SHKOLLËS KALESHIANE...

Paçit faqen e bardhë... (Esselamualejkum... Të nderuar miq, dashamirë e bashkëvendës të akademik Hasan Kaleshit, dashamirë të dijës...)

Kam privilegjin dhe kënaqësinë e veçantë që në emër të kolegëve, të bashkëpunëtorëve dhe të ish-studentëve të profesor Hasanit, të cilët me angazhimin e tyre u kanë sjellë juve sot këtu – në Kërçovën e Hasan Kaleshit (që unë i quaj arganistë të profesor Kaleshit): akad. Muhamed Mufakun, akad. Esad Durakoviqin, prof. dr. Irfan Morinën, prof. dr. Sadik Mehmetin, prof. dr. Nuridin Ahmetin, prof. dr. Zeni Ballazhin, të cilët qëndruan në vijën e parë, pa kursyer veten - dhe jo vetëm këta, edhe ata në vijën e dytë të frontit: prof dr. Musa Gashin, dr. Abdullah Rexhepin, mr. Elez Ismailin, Hamdi Ilazin, mr. Qemajl Morinën, dr. Isa Memishin dhe dr. Kujtim Kasamin, të ju përsëritës dhe të ju falënderoj për pjesëmarrjen në këtë akt të rrallë kulturor, me çka, ju të pranishëm, i bëni nder prof. Kaleshit dhe neve, gjurmëtarëve të profesor Kaleshit!

Ju faleminderit të gjithëve që keni nderuar Kërçovën e Kaleshit! Falënderoj veçanërisht mysafirët që kanë kaluar kufijtë shtetërorë, ata nga Prishtina, pastaj ata nga Shkupi, nga Tetova etj., të cilët kanë marrë rrugën dhe sot janë këtu bashkë me ne.

Jam me fat dhe i privilegjuar që kam rastin – për së treti herë, nga ky ambient (1996, 2012, 2022) – t'ua drejtohem bashkëvendësve të Hasan Kaleshit me disa fjalë, me të cilat rikujtojme veprën e Kaleshit.

Të nderuar miq të dijës, të librit e të vizionit të akad. Hasan Kaleshi, me këtë rast para jush del vepra e Hasan Kaleshit (pjesa e parë... me 8 vëllime).

Me këto 8 vëllime, në katër gjuhë të cilat i ka botuar studimet prof. Kaleshi: shqip, serbisht, arabisht dhe turqisht, ne, arganistët e veprës së tij, të lajmë pjesërisht një borxh ndaj profesor Kaleshit dhe ndaj opinionit shkencor shqiptar dhe më shumë se kaq.

I vëmë para duarve opinionit shkencor shqiptar dhe botëror një kapital, të cilin opinionin botëror ka nisur ta vlerësojë si **kontribut i shkollës kaleshiane, si vazhdimësi e veprimtarisë së tij shkencore.**



Të nderuar të pranishëm. Me këto 80 kontribute shkencore të akad. Hasan Kaleshit, që janë përfshirë në këto vëllime, i bëhet e ditur opinionit të gjerë se kanë të bëjnë me një figurë të rrallë shkencore në hapësirën shqiptare dhe më gjerë. Kanë në duar **veprën** e një dijetari shumëdimensional, i cili duke filluar nga viti 1949 e deri në vitin 1976 ka lënë gjurmë në studimet e filologjisë orientale dhe islamologjisë, të publicistikës etj.

Veprat kapitale të prof. Kaleshit janë dhe mbeten: **Dokumentet më të vjetra të vakëfit në gjuhën arabe në Jugosllavi, Srpsko-hrvatski-arapski recnik etj.**

Me VEPRAT 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 opinionin shkencor do ta njohë kontributin e prof. Kaleshit edhe si një prijatar për themelimin e institucioneve shkencore: *Instituti Albanologjik* në vitin 1953, të organit shkencor të këtij instituti: *GJURMIME ALBANOLOGJIKE*; të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, 1975, sidomos me themelimin e Katedrës së Orientalistikës në Fakultetin e Filologjisë, që është, siç shprehet akad. Esad Durakoviq, **VAKËF I HASAN KALESHIT**, të cilin ia la shkencës dhe kulturës, veçanërisht për studimet historike dhe islamologjike.

Të nderuar të pranishëm, zotërinj Myftinj të Republikës së Kosovës, Myftinj të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kryetar i Komunitetit të Kërçovës, më lejoni që në fund, në emër të arganistëve (lëviztarëve) të veprës së Hasan Kaleshit, t'i shpreh falënderimin tonë të sinqertë Myftinisë së Kërçovës, me Myftiun Qamil ef. Rushitin në krye, për iniciativën dhe përkrahjen gjatë këtij rrugëtimi, Kryetarit të Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë së Veriut që e përkrahu dhe e inkurajoi Myftininë e Kërçovës për ta shënuar këtë ngjarje të rëndësishme për kulturën shqiptare.

Të gjithëve ju faleminderit që erdhët ta nderoni punën tonë, ta nderoni kontributin shkencor të akademik Hasan Kaleshit dhe Kërçovën e Kaleshit.

Hasan Kaleshi është jo vetëm një shkencëtar i nivelit botëror, por lirisht mund të themi se është INSTITUCION SHKENCOR, i cili duhet të jetë objekt studimesh në disa fusha. Kjo mbetet detyrë e brezave që vijnë dhe që i dinë gjuhët në të cilat botoi akad. Hasan Kaleshi: shqip, arabisht, turqisht dhe gjermanisht.

Ju faleminderit të gjithëve!
Paçit bekimin e Krijuesit të Gjithëpushtetshëm.

Kërçovë, 30 korrik 2022

HASAN KALESHI, NJË FIGURË ME PËRMASA TEJKOMBËTARE

Të nderuar të pranishëm, pjesëmarrës në aktivitetin përurues të kolanës së veprave të profesor Hasan Kaleshit.

Është një moment i veçantë dhe i rëndësishëm për dijen dhe kulturën shqiptare shënimi i 100-vjetorit të lindjes së njëres prej figurave më të rëndësishme dhe më të njohura në përmasa tejkombëtare, Hasan Kaleshi.

Akad. Feti Mehdiu dhe akad. Muhammed Mufaku, duke u përkrahur nga një numër mbështetësish të pakursyer, ia dolën që veprën e Hasan Kaleshit ta sjellin në një format prej tetë vëllimesh dhe në këtë mënyrë ta shënojnë me dinjitet këtë përvjetor.

Jam së tepërmi i nderuar që mund t'ju drejtohem me disa fjalë vlerësimi për veprën e Hasan Kaleshit dhe me disa fjalë miradije për të gjithë ju që e pasuruar fondin e studimeve albanologjike me një literaturë jo shumë të pranishme, por tejet të nevojshme në jetën tonë shkencore.

Duke e pasur të pamundur që sot të jem mes jush fizikisht, ju lus t'ju pranoni përshëndetjet dhe urimet e mia të sinqerta si për aktivitetin e sotëm, ashtu dhe për gjithë punën njëvjeçare të profesorëve të nderuar, të cilët punuan me përkushtim për ta sjellë në këtë format veprën e një dijetari të përmasave globale.

Botimi i veprës së Hasan Kaleshit në tetë vëllime në gjuhë të ndryshme, përkatësisht në variantin origjinal të shkëritit të tyre, përbën një nismë me vlerë të madhe historiografike, filologjike e kulturologjike. Ndonëse bëhet fjalë për studime e shkrime të botuara para gjysmë shekulli, as sot nuk mund ta mohojmë rëndësinë e saj shkencore, të artikuluar në gjuhë të ndryshme - orientale, rajonale e oksidentale, të botuara në revista me repute ndërkombëtare e ku trajtohen aspekte të historisë dhe të kulturës shqiptare, duke i bërë të njohura ato në përmasa ndërkombëtare.

Edhe me këtë rast dua të ritheksoj ne-



vojën e njohjes sa më të plotë dhe të vlerësimit kritik e të drejtë të punës shkencore të Hasan Kaleshit, por edhe nevojën imediate që të kemi vijimtarë të denjë e institucionalë të punës së tij. Instituti Albanologjik, punonjës shkencor i të cilit ishte Hasan Kaleshi gjatë viteve 1968-1970, ende nuk ka kapacitete të mjaftueshme studimore që do ta mbulonin periudhën osmane në cilindo aspekt të saj (të periudhës osmane). Të gjithë jemi koshientë se është fjala për një trashëgimi të pasur e disashekullore, për një materie fare pak të trajtuar, e cila është e domosdoshme të nxirret në dritë, të vlerësohet me kritere shkencore dhe pa paragjykime të thadruara përgjatë dekadave.

Duke shmangur çdo lloj paragjykimi biografik, uroj që për të mirën e dijes shqiptare dhe në interes të qartësisimit të

shumë aspekteve jo aq të njohura historiografike dhe kulturologjike të botës shqiptare, vepra e Hasan Kaleshit të lexohet gjithnjë e më shumë, të trajtohet si një fakt dituror e kulturor, të avancohen më tej rezultatet e punës së tij, sepse vetëm kështu bëjmë detyrën që sot para nesh shtron shkencë moderne.

Të nderuar të pranishëm, punë të mbarë aktivitetit të sotëm dhe përgëzime të shumta për të gjithë ata që kontribuan në aktivitetet shënuese të 100-vjetorit të lindjes së Hasan Kaleshit dhe veçmas ata që në cilëndo formë kontribuan për botimin e veprës së tij.


Prishtinë-Kërçovë, 30 korrik 2022.
Prof. dr. Hysen Matoshi, Drejtor i Institutit Albanologjik-Prishtinë

LETRA E BOTUESIT NGA JORDANIA

Me emrin e Zotit, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit. Të nderuar të pranishëm, së pari dëshiroj të falënderoj Myftiun e Kërçovës, Shejh Qamil Rushitin, për ftesën që më dërgoi për të marrë pjesë në këtë event në shënimin e njëqindvjetorit të shkencëtarit akademik Hasan Kaleshi, birit të këtij qyteti, i cili u bë i njohur në qarqet shkencore në Evropë dhe në Lindjen e Mesme.

Por, më vjen keq që në momentin e fundit rrethanat më penguan të vij që të jem me ju, prandaj ju drejtohem me këtë fjalë. Do të kisha dashur të isha i pranishëm në këtë event, për të mësuar më shumë për institucionin që përfaqëson myslimanët në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe që kujdeset për çështjet e tyre fetare dhe kulturore dhe për atë çfarë ai (institucion) boton nga librat që meritojnë përkthimin në përvojat e qytetërimit të myslimanëve në këtë pjesë të Evropës.

Në cilësinë e drejtuesit të shtëpisë botuese "Al-Aan" në Amman të Jordanisë, e cila deri më tani ka botuar më shumë se 800 tituj, jam krenar që shtëpia jonë është plotësuar dhe pasuruar me atë që është botuar në botën arabe, me libra mbi hi-



storinë dhe qytetërimin e myslimanëve në Ballkan etj.

Në këtë drejtim, ne mirëpritëm që në kuadër të 100-vjetorit të lindjes së Hasan Kaleshit të botojmë studime të zgjedhura për të në gjuhën arabe, me titull: "Islami, politika dhe kultura në Ballkan", përkthyer nga prof. dr. Muhamed Mufaku el-Arnauti, i cili për herë të parë sjell një tablo gjithëpërfshirëse të jetës së këtij modeli dhe fushat e studimit, të cilat do t'ju kontribuojnë lexuesve arabë në aspekte të rëndësishme të historisë dhe të kulturës së shqiptarëve në vendin e tyre gjatë sundimit osman në Ballkan, që shtrihej në rreth 500 vite.

Ky libër ka marrë vëmendje në shtypin arab, gjë që na gëzon që shtëpia jonë botuese ka kontribuar në botimin e këtij libri, në prezantimin e një dijetari të madh, që nuk ishte i njohur për ne. Këtu mjafton t'i referohemi asaj që shkroi akademikun tunizian Najm al-Din, Khalaf Allah, në prezantimin e këtij libri, që u botua në gazetën kulturore "Al-Arabi al-Xhedid" më 19 prill 2022, se ky libër ka arritur t'i prezantojë lexuesit arab shkollën kaleshiane, e cila cilësohej me saktësinë, arritjen dhe gjithëpërfshirjen.

Shpresojmë që me botimin e këtij libri, dhe me komunikimin me Bashkësinë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, e cila në mënyrë kushtetuese i përfaqëson myslimanët, bashkëpunimi të vazhdojë dhe lexuesit arabë të mësojnë më shumë për historinë dhe kulturën e myslimanëve në RMV dhe në Ballkan në përgjithësi.

Paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi ju.

Amman, Jordani, më 27.07.2022
Prof. dr. Basim Azza`abi, Drejtor i Përgjithshëm i SHB "Al-Aan"

FJALA E DR. ESAD DURAKOVIQIT, SARAJEVË

Zonja dhe zotërinj, profesorë të nderuar, miq të dashur! Kam kënaqësi të veçantë t'ju drejtohem me rastin e shënimit të 100-vjetorit të lindjes së akademik profesor Hasan Kaleshit.

Ky shkencëtar i jashtëzakonshëm i formatit të rilindësve, Hasan Kaleshi, më ka pranuar në Fakultetin Filozofik si asistent për gjuhën arabe, në një kohë kur, për arsye ideologjike, i kam pasur të mbyllura dyert në Sarajevën time. Në Prishtinë, në Fakultetin Filozofik, punova 15 vjet e gjashtë muaj, por fatkeqsisht, pak kam punuar me profesor Kaleshin, sepse ai ndërroi jetë në moshën kur shkencëtarët kontribuojnë më së shumti dhe i kurorëzojnë veprat e tyre më të suksesshme. Megjithatë, edhe për atë kohë, të shkurtër, kam mësuar, më për së afërmi, nga njeriu me dije të jashtëzakonshme e të gjerë. Ky fakt me bën krenar.

Edhe pse profesor Kaleshi shkoi shumë herët, ai arriti të lë Degën e Orientalistikës, të cilën unë e konsideroj një lloj "vakëfi shpirtëror". Në hapësirën ku

jetoi dhe veproi profesor Kaleshi, madje dhe më gjerë, nuk kishte orientalist që të ketë shkruar në aq gjuhë dhe në aq vëllime. Ai edhe për këtë ishte unikat.

Në bazë të njohurive personale, sa e kam njohur unë prof. Kaleshin, dhe në bazë të veprave të tij, e di se ishte kosmopolit autentik. Vetëm kështu mund të jetë shkencëtar i vërtetë. Në kohën kur Dega e Orientalistikës në Beograd, si edhe shumica e institucioneve evropiane të kësaj fushe kultivonin platforma negative eurocentrike ndaj botës orientaleislame, prof. Kaleshi ishte shkencëtar i cili në studimet e veta mbajti qasje shkencërisht strikte, objektive, pa imlikuar frymë ideologjike e politike. Këtu qëndron madhështia e tij.

Unë gjithashtu jam krenar për faktin se si shkencëtar dhe humanist jam rritur në Kosovë, në një periudhë bukur problematike - kur ashpërsohej sidomos ndjenja e vazhdueshme kundër vlerave universale.

Puna me Kaleshin në Kosovë, në ato rrethana, për mua ka qenë tepër e çmue-

shme dhe ishte përvojë gjurmëlënëse.

I falënderoj të gjithë ata që kanë respekt për vlerat e veprave të Hasan Kaleshit - jo vetëm ndaj veprave të shkruara, por edhe të asaj vepre që e shohim sot në Orientalistikën e Prishtinës.

Ndihem shumë i lumtur që mora pjesë në këtë projekt, të cilin sot ia dhuojmë opinionit publik dhe vendlindjes së Hasanit: këto 8 vëllime. Veçanërisht falënderoj iniciatorët dhe bartësit e këtij projekti, akademikët Feti Mehdiu dhe Muhamed Mufaku.

Duke punuar në krijimtarinë e prof Kaleshit, si mision më i lartë e më fisnik në këtë botë, me këtë rast do të parafragoza mendimin e Roland Bartit: Vdekja ka atë lloj vlere, me të cilën e amortizon nënshkrimin e autorit dhe veprën e tij e shndërron në mit. Në këtë mënyrë e refuzojmë faktin se vdekja i kapet atij për të cilin kemi më së shumti nevojë dhe që jeton përsëjta.

Të gjithëve ju përsëjtes ngrohtësisht.

NJË THESAR I TRASHËGUAR



Bismilahirr rrahmanirr Rrahim. Në emër të Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit.

I nderuar Kryetar i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i nderuar Kryetar i BI të Kosovës Myfti Naim ef. Tërnavë; shumë i nderuar udhëheqës politik i shqiptarëve në vendin tonë, në MV, Kryetar i BDI-së z. Ali Ahmeti; i nderuar Kryetar i Komunës së Kërçovës Fatmir Dehari; i nderuar Kryetar i Komunës së Pllasnicës, z. Alija Jaoski; shumë të respektuar kolegë të mi, Myftinj të Myftinive të BFI të RMV; të nderuar profesorë, akademikë; i nderuar Drejtor i Institutit për Studime Islame në Prishtinë, z. Sabri Bajgora, të nderuar të pranishëm, kam nderin dhe kënaqësinë që t'ju uroj mirëseardhje në këtë aktivitet tonin të përbashkët, me rastin e 100-vjetorit të lindjes së akademik Hasan Kaleshit.

Ky përvjetor dallon nga të tjerët, për arsye se para vetes kemi një përmbledhje të veprimtarisë së tij shkencore dhe atë që do të shtohen në të ardhmen, ngase për t'u rumbullakuar krejtësisht veprimtaria e tij, ky numër i veprave do të duhet edhe të shtohet.

Kjo veprimtari del në dritë falë punës së përbashkët dhe të palodhshme të njëzëzve që bashkëjetuan dhe që bashkëve-

pruan me Hasan Kaleshin - profesor Feti Mehdiu, Muhamed Mufakun, Esat Durakoviçin dhe kështu me radhë.

Vetë fakti që kemi para vetes disa vepra të Hasan Kaleshit, edhe atë në disa gjuhë, na dëshmon për kapacitetin e tij intelektual dhe për ngritjen e tij shkencore. Sot e tutje opinioni shqiptar, por edhe ai më gjerë, do të ketë mundësi që shumë saktë dhe objektivist të njihet me jetën dhe me veprimtarinë shkencore të akademik Hasan Kaleshit.

Interesi që ne shfaqëm si Myftini e Kërçovës, respektivisht si Bashkësi Fetare Islame e RMV, nën patronazhin e së cilës organizohet edhe ky takim, për të ndihmuar daljen në dritë të këtyre veprave, ishte ideja që asnjëherë nuk do të mundemi të ecim suksesshëm drejt së ardhmes po që se nuk e kthejmë kokën mbas dhe të shohim se ajo që ne sot jemi dhe përfaqësojmë si kulturë dhe qytetërim, si vlerë kombëtare e fetare, është vetëm një thesar i trashëguar nga paraardhësit tanë, të cilët e kanë ruajtur dhe kultivuar me shumë dashuri dhe përkushtim, edhe në kohëra dhe rrethana më të rënda dhe më të vështira sesa ne sot, atë zhvillim. Prandaj, e pakta që ne mund të bëjmë është të shprehim mirënjohje të thellë dhe falënderim për tërë atë sakrificë që ata kanë bërë.

Në fund, unë dëshiroj të shpreh ca falënderime: këto aktivitete të kulturës sonë nuk do të mund të bëheshin aq lehtë, përveç se atëherë kur pas tyre qëndron me tërë kapacitetin e tij institucioni Komunë dhe Kryetari i saj.

Prandaj, e falënderoj nga zemra Kryetarin Fatmir Dehari, që u bë bashkëpunëtor yni për realizimin e këtij aktiviteti. Dëshiroj të falënderoj për ndihmën që na ofroi mërgata jonë, e cila ka qenë gjithmonë - dhe vazhdon të jetë - një nga mbështetësit më të fuqishëm të projekteve tona, qofshin ato kombëtare ose fetare. Në fund, më paraqet kënaqësi të veçantë që sot, në qytetin tonë, edhe atë për të na nderuar neve dhe veprën e akademik Hasan Kaleshit, qëndrojnë udhëheqësit më të lartë të Bashkësisë Islame të shteteve tona: të shtetit të Kosovës, Myftiu Naim Tërnavë dhe të vendit tonë, Reis'ul-Ulema Shaqir ef. Fetahu, në shoqërim të liderit të Bashkimit Demokratik për Integrim, Ali Ahmeti, i cili tashmë që disa vjet me radhë e udhëheq politikën e shqiptarëve këtu në vendin tonë. Falënderit shumë, Kryetar, që jeni bashkë me ne dhe i jepni peshë këtij takimi. Falënderit ju, të gjithë të pranishëm.

Kërçovë, 30.07.2022
Qamil ef. Rushiti,
Myfti i Myftinisë së BFI-Kërçovë

JU DËRGOJ LETRËN E FUNDIT TË HASAN KALESHIT



Të nderuar. Më erdhi mirë që u takova me prof. Muhamed Mufakun në Nju-Jork më 15 korrik 2022, në një takim që u përqendrua në jetën dhe veprimtarinë publicistike e shkencore të të ndjerit prof. Hasan Kaleshi, gjë që për mua ishte kënaqësi dhe nderim i veçantë.

Mbledhja dhe ribotimi i shkrimeve të tij, ashtu siç keni vepruar ju dhe kolegët tuaj, është e vetmja mënyrë për të orientuar trajtimin objektiv të studimeve shkencore, të deformuara rrënjësisht në periudhën e regjimit komunist. Ndaj, e shfrytëzoj rastin që tani t'ju falënderoj për ftesën që të paraqitemi në këtë ceremoni për 100-vjetorin e të ndjerit Hasan Kaleshi, duke çmuar lart kontributin e të gjithëve që të mbahet ceremonia me ekspozimin e 8 vëllimeve me punimet e të ndjerit në shqip, turqisht, boshnjakisht e arabisht.

Unë kam pas fatin të njihem me personin, me prof. Kaleshin, dhe të komunikoj me të në një periudhë të ndërlikuar, gjatë 6-7 viteve të fundit të jetës së tij. Në shenjë falënderimi vëllazëror për ribotimin e shkrimit tim në Veprat e shkrimeve të tij, të botuar në mërgim para 45 vjetësh, po ju dërgoj letrën e tij të fundit, në të cilën qartazi kuptohen shumë gjëra. Këtë letër prof. Kaleshi ma dërgoi 11 ditë para se të mbyllte sytë përgjithmonë:

Fort i ndershëm z. Lamaj,

E mora letrën tuaj me të cilën më urruet për kumesën. Mjerisht e kam shkruar me një shpejtësi të madhe që të mbrijë në kohë. Besoj se studimin e Konicës e kam orjentue kah një drejtim tjetër - ai arkival, që asht me randësi, se janë thanë mjaft fjalë të mëdha, fraza, fanfora, e duhet të jemi ma konkret. Nëse ket e kam arritur, jam i knaqur. Kam shumë materiale mbi Konicën, por botimi i studimeve mbi të në Kosovë asht i vështirë, se këtu i imitojnë ata të Shqipnisë si majmuna, e unë kam hy në konfliktet të haptë me ta, kryesisht për shkak të falsifikimeve. E falsifikimet i bajnë në folklor, në



letërsi, në histori - e kudo, vetëm sipas shablloneve. Shkruejnë mbi Naimin e e lanë në harresë Qerbelanë, që asht vepra ma e madhe e tij. Kur e lexon njeriu historinë e popullit shqiptar, mendon se 500 vjet vetëm kemi luftue kundër Turqëve, e na jemi këputur tue luftue bashkë me ta dhe jemi bashkëkrijues të Perandorisë Osmane etj... Por këto janë muhabete të gjata.

Të fala

Hasan Kaleshi.

Munchen , 9. 7. 1976. Këtu kam ardhur ka 5 ditë dhe në Universitetin e këtu shëm mbajta një ligjeratë me titull: "Roli i depërtimit turk në Ballkan dhe i islamizmit për popullin shqiptar."

Ju falenderit për vëmendjen.

Idriz Lamaj, publicist, studiues dhe aktivist i komunitetit shqiptaro-amerikan, ish-gazetar i 'Zërit të Amerikës' në gjuhën shqipe, bashkëpunëtor i gazetës "Dielli" të organizatës pashqiptare "Vatra" (SHBA).

VITI I RI 1444 HIXHRI - INSPIRIM PËR VEPRA MADHORE

Më 29 korrik, 2022, në Filarmoninë e Maqedonisë së Veriut në Shkup Bashkësia Fetare Islame organizoi manifestimin qendror "Hixhri 1444", me rastin e ndërrimit të viteve sipas kalendarit hënor, thuhet në njoftimin e BFI.

I tërë programi, me pjesëmarrje të gjerë të ftuarish, është transmetuar drejtpërdrejt në Kanalin e Dytë të Radiotelevizionit Publik të RMV (TVM2).

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, në fjalimin që mbajti me këtë rast tha:

Bota islame për çdo vit përkujton dhe me zell të madh feston ngjarjen më madhështore në historinë e myslimanëve dhe të njerëzimit në përgjithësi, Hixhretin. Fjala "hixhreh" është shprehje e gjuhës arabe, që do të thotë "emigrim", "ndarje", "largim", ndërsa në terminologjinë fetare-islame do të thotë "largim, ndarje nga vendi i pabesimit, i të keqes dhe errësirës". Në rastin konkret, fjala "hixhreh" nënkupton "emigrimin e Muhamedit (a. s.) dhe të myslimanëve të parë nga Meka në Medinë, me qëllim të mbrojtjes, të kultivimit dhe të zhvillimit të të vërtetës hyjnore-Islamit.

Çdo vepër madhështore është rezultat i sakrificimit, i luftës, i mundit, lëvizjes, emigrimit –hixhretit dhe atë e gjejmë prej njeriut të parë dhe, si i tillë, është pjesë përbërëse e jetës në këtë botë, e në veçanti cilësi e njerëzve të mëdhenj, të cilët potencialet e veta i vendosin në shërbim të shpëtimit dhe të ngritjes së popujve.

Shkurt thënë, hixhreti është lëvizje dhe kusht kryesor për ngadhënjimin e idealeve më të larta hyjnore. Kurani famëlartë flet për personalitetet e mëdha historike, si të dërguar të Zotit, idealistë të mëdhenj, të cilët përjetuan rrugën më të vështirë-rrugën e hixhretit, të vetëdijshëm se lufta kundër të keqes dhe injorancës bëhet vetëm në lëvizje dhe dinamizëm të fortë.

Hixhreti i të dërguarit të fundit të Allahut (xh. sh.), Muhamedit (a. s.), ndodhi në fillim të shekullit VII, përkatësisht në vitin 622, kohë kjo në të cilën njerëzimin e kishte mbuluar injoranca e paparë. Pi-



kërishit në këtë kohë filloi të përhapet e vërteta - misioni hyjnor nga Muhamedi (a. s.), me çka filloi ndërtimi i bazave kryesore drejt një ardhmërie të shëndoshë të njerëzimit, duke formuar individë, familje dhe shoqëri të shëndoshë, besim të shëndoshë, me dije, me moral, për paqe dhe tolerancë njerëzore.

Por, në këtë luftë diçka ishte e qartë: nuk mundej një grup i vogël, me një përpjekje dhe luftë statike, të bëjë ndryshimin historik në kohë dhe në vend me një grup të vogël dhe në mënyrë statike. Andaj, Muhamedi (a. s.), i frymëzuar nga i Madhi Zot, ishte i vetëdijshëm se lufta për të vërtetën dhe për ideale të shenjta bëhet në lëvizje dhe në një dinamizëm të gjallë, andaj duhet menduar një strategji lëvizëse dhe largpamëse, që nënkuptonte lëvizjen, një vend më të sigurt dhe pjellor, ku duhet të mbillet Islami dhe prej aty të fillojë rruga e formimit të një ardhmërie të shëndoshë të njerëzimit. Pra, ndjenja e lartë e përgjegjësisë së obligimit hyjnor për të ngadhënjyer e vërteta, bëri që Muhamedi (a. s.) dhe shokët e tij me dëmbje të thellë, por krenarë, ta lëshojnë vendlindjen, duke sakrificuar gjithçka, edhe atë - më të dashurën dhe më të dhimbshmen, vendlindjen e tyre, ku janë lindur dhe ku janë rritur. Dashuria ndaj Zotit dhe obligimi e vendosmëria për të mbrojtur dhe për të përhapur misionin hyjnor, si dhe për zhdukjen e gjithë asaj që e nënçmon njeriun, bëri që Muhamedi (a. s.) dhe shokët e tij të përbijnë dashurinë ndaj atdheut. Strehim të vetëm dhe më të për-

shtatshëm gjetën në Medinë, te banorët e saj, ku u pritën në mënyrë shumë të ngrohtë.

Prej këtij vendi filloi të merrte hov Islami dhe kështu të përhapet në të katër anët e botës, ndërsa myslimanët me shekuj të tërë të jenë udhëheqës të vërtetë të njerëzimit në të gjitha sferat e jetës - duke filluar prej asaj fetare e deri tek ajo shkencore, kulturore, ekonomike etj.

Pa dyshim, Hixhreti është një ngjarje e madhe në historinë e njerëzimit dhe, si i tillë, me një kuptim të përherëshëm dhe të pashtershëm.

T'i qasemi atij vetëm nga prizmi e tij historik, si një ngjarje që ka ndodhur në një kohë dhe hapësirë, do të thotë interpretim dhe qasje e mbyllur, e ngurtë dhe e kufizuar e Hixhretit.

Është e vërtetë se ndodhi në një vend dhe kohë të caktuar, por kurdo dhe kudo që rrezikohen vlerat për të cilat edhe ndodhi, Hixhreti është më se i nevojshëm dhe më se i domosdoshëm, pa marrë parasysh kohën, vendin dhe nivelin intelektual të njerëzimit.

Andaj, hixhreti nuk është ikje nga armiku, përkundrazi është aksion dhe lëvizje e bazuar në sakrificim të pasqor për të ngadhënjyer e Vërteta, përkatësisht besimi në një Zot - parim ky që e dallon njeriun nga qeniet tjera, që i çliron sjelljet dhe të menduarit te njeriu.

Hixhreti është aksion dhe lëvizje për kultivimin dhe formimin e një hapësire për t'u praktikuar e vërteta, është formim i kushteve dhe përgatitje për t'i dhënë gru-

shte të keqes në mënyrë të organizuar. Këtë e vërteton fakti se Muhamedi (a. s.) menjëherë pas hixhretit bëri hapa historikë për të vendosur bazat e një organizimi të fortë dhe të sigurt, si:

- ndërtimi urgjent i institucioneve fetare-kulturore e shkencore, si: xhamitë dhe shkollat;

- vëllazërimi i fiseve të ngatëruara në Medinë, përkatësisht ngritja e

- unitetit në shkallën më të lartë;

- formimi i Shtetit Islam, ku u gjetën të barabartë të gjithë qytetarët,

- pa marrë parasysh racën, kombin, fenë etj.

Me këtë, edhe një herë u vërtetua rëndësia e Hixhretit dhe porosia kryesore e tij, se nuk ka organizim më të fortë dhe se nuk ka ardhmëri të shëndoshë të një populli pa institucione fetare-kulturore e shkencore dhe pa unitet të nivelit më të lartë gjithëpopullor.

Sakrificimi i gjithë asaj që e lanë në Mekë dhe luftërat e shumta që pësuan pas Hixhretit, dhanë shembull të paparë se në mbrojtjen e institucioneve, të unitetit dhe të shtetit duhet sakrificuar gjithçka, po bile edhe jetën, se vetëm në këtë mënyrë arrihet mbrojtja e nderit dhe ndihma e Allahut (xh. sh.).

Për këtë Allahu (xh. sh.) thotë: **"Ata që besuan, që migruan dhe që luftuan me pasurinë dhe veten e tyre në rrugën e Allahut, ata kanë pozitë më të lartë tek Allahu (xh. sh.) dhe vetëm ata janë fatlumë."** (Et-Teubetu: 20)

Rezultatet e kësaj u vërtetuan më vonë, kur Muhamedi (a. s.) dhe myslimanët e çliruan Mekën, duke u kthyer triumfalisht në vendlindjen e tyre. Me këtë edhe një herë u vërtetua se ndër porositet themelore të Hixhretit është lidhmëria e ngushtë dhe e paluhatshme e besimtarit me vendlindjen – me vatanin, përkatësisht Hixhreti bëhet për vendlindje, duke mos e humbur lidhmërinë me të dhe duke synuar gjithmonë te kthimi në të, me qëllim të sjelljes së lirisë, të pasurisë dhe çdo të



mirë asaj. Për këtë Muhamedi (a. s.) pas çlirimit të Mekës tha:

"Nuk ka emigrim pas çlirimit, por ka mund, përpjekje dhe qëllim të pastër."

Hixhreti paraqet afirmim të plotë të moralit njerëzor, që do të thotë përpjekje maksimale e njeriut për ndërtimin e një pozicioni të nivelit të lartë, ku do të vijë në shprehje jetesa e shëndoshë konform normave morale, respektivisht për një reformë rrënjësore për t'u ndryshuar gjendja në favor të së mirës dhe për zhdukjen e së keqes.

Hixhreti, pra, është largim nga e keqja dhe jeta e zymtë amorale, drejt njerëzores dhe morale; përpjekje për ndërtimin e personalitetit të moralshëm, i cili do të jetë subjekt kreativ dhe konstruktiv në kuptimin e plotë të fjalës, që do të shkatërrojë të keqen dhe do të rrenjos të mirën dhe pozitiven në jetën individuale dhe shoqërore.

Në një rast, ata që nuk u takonin atyre që e kryen Hixhretin e pyetën Pejgamberin e Allahut (xh. sh.) se si mund të arrihet shkalla më e lartë e Hixhretit. Muhamedi (a. s.) u përgjigj:

"Muhaxhir është ai që largohet nga ajo që e ka ndaluar Allahu (xh. sh.) dhe e pranon atë që e ka urdhëruar."

Pra, Hixhreti është luftë e vërtetë fizike-shpirtërore në drejtim të ndryshimit të njerëzimit, për t'i reformuar ata në të

gjitha sferat e aktivitetit të tyre, me qëllim të formimit të personaliteve të shëndosha dhe të bashkësisë që do të jetë bartëse e vërtetë e praktikimit të mësimëve të Allahut (xh. sh.).

Në trojet ku jetojmë dhe veprimë porositë e Hixhretit janë gjithnjë e më aktuale, kur dihet se dekadave të fundit, nën ndikimin e elaboreteve pansllaviste, si dhe nën ndikim e kushteve të vështira politike dhe ekonomike, paraprakisht të përgatitura, qindra mijëra, mos të themi miliona njerëz të popujve të këtyre trevave u larguan nga vatani i tyre, duke iu nënshtruar asimilimit të paparë fetar e kombëtar.

Andaj, Hixhreti i Muhamedit (a. s.) mëson që të gjithë këta **muhaxhirë** të bëjnë përpjekje të jashtëzakonshme që kurdoherë të kthehen në vatrën e tyre, të mendojnë për vatanin e tyre, duke mos humbur lidhmërinë me vatanin dhe shpresën për t'u kthyer në të.

Por, sot për ne Hixhret do të thotë mobilizim i të gjitha forcave intelektuale, politike e fetare në shërbim të formimit:

1. Sistem të shëndoshë të arsimimit dhe ngritjes profesionale dhe intelektuale të të gjitha shtresave të shoqërisë sonë;

2. Çelje e një rruge të sigurisë ekonomike për t'u formuar hapësirë e fuqishme për të gjetur mundësinë e jetës në vatanin e vet;

3. Ngritja e vlerave morale për një jetë pa kriminalitet, pa korrupsion, pa padrejtësi, së cilës do t'i kthehej pastërtia shoqërore për një ekzistencë të shëndoshë në familje dhe në shoqëri.

Në fund, mund të konkludojmë se Hixhreti i dha impuls të fuqishëm pjekurisë shpirtërore dhe intelektuale, përsosmërisë etike dhe humane dhe, si i tillë, paraqet një epokë të re, një revolucion të ri shpirtëror, kulminacion i sakrificimit shpirtëror dhe material – tha Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në manifestimin në Filarmoninë e Maqedonisë së Veriut në Shkup me rastin e Vitit të Ri 1444 Hixhrij.

EPOKË E RE

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, në emrin e tij personal dhe në emër të BFI-së ka uruar të gjithë besimtarët me rastin e Vitit të Ri Hixhri. Në urim thuhet:

Me rastin e hyrjes në vitin e ri 1444 Hixhrij, të gjithë besimtarëve ju shprehim urime të përzemërta, duke iu dëshiruar kënaqësi familjare dhe paqe në çdo vend. Viti i ri bazohet në ngjarjen e madhe të

Hixhretit - migrimin të Muhamedit (a. s.) nga Meka në Medinë, që ndodhi në vitin 622, me çka filloi epoka e re e Islamit, e myslimanëve dhe e njerëzimit në përgjithësi.

Hixhreti na inspiron në vetëdije të lartë për sakrificë të mendimit, të pasurisë dhe të jetës, për zhvillimin e idealeve të shenjta në shërbim të Zotit dhe të vlerave njerëzore.

Urime viti i ri 1444.

Reis'ul-Ulema i BFI të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu
(29.07.2022)

DY RIEMETIME NË TVM2

BFI e RMV ka njoftuar besimtarët myslimanë dhe opinionin e gjerë më 29 korrik, 2022, se pas transmetimit të drejtpërdrejtë, TVM2, Kanali i Dytë i Televizionit Publik të RMV, ka pasur dy riemetime të Manifestimit Hixhri 1444 më 30.07.2022: në orën 04:55 minuta dhe në orën 12:00.

HAXHI 2022: DUARTROKITJE PËR KRERËT E BFI-SË

Dy grupet e fundit të haxhinjve kanë mbërritur në Shkup më 25 korrik, 2022, me aeroplanin e katërt dhe të pestë. Njëri aeroplan ka ateruar në Aeroportin Ndërkombëtar në ora 07:15 minuta, ndërsa aeroplani tjetër në ora 17:00. Haxh dhe ibadete të pranuar për haxhinjtë tanë, thuhet në njoftimin e BFI.

Familjet e gëzuara për arritjen e haxhilerëve kanë duartrokatur krerët e Bashkësisë Fetare Islame, Kryetarin e BFI h. hfz. Shaqir ef. Fetahu dhe Myftiun e Shkupit dr. Qenan ef. Ismaili, me bashkëpunëtorët e tyre, të cilët kishin dalë për t'i pritur edhe haxhinjtë e fundit, pas gjithë të tjerëve në ditët më parë, të cilëve po ashtu u ishte bërë pritje nga krerët e BFI-së. Kthimi i grupit të fundit të haxhinjve u transmetua drejtpërdrejt, në kohë reale, në platformat elektronike të BFI-së.

Grupi i katërt i haxhinjve kryesisht ishte nga qyteti i Shkupit, Ohri, Struga,



Kërçova dhe Dibra.

I pari që u dëshiroi mirëseardhje dhe u shtrëngoi dorën në shenjë respekti ishte Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu së bashku me Myftiun e Myftinisë së Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili, të shoqëruar edhe nga delegacioni i pritjes i Rijasetit të BFI.

Myftiu i Strugës, mr. Salim ef. Sulejmani, në emër të Kryetarit të Bashkësisë

Fetare Islame të RMV i priti haxhinjtë e grupit të fundit, të pestë, dhe i pari u shtrëngoi dorën, duke iu dëshiruar mirëseardhje në vendlindje.

Të gjithë haxhinjtë u kthyen shëndoshë e mirë dhe në pritjen e tyre kishin dalë qindra familjarë, të cilët i pritën me lot gëzimi dhe me buzëqeshje. E lusim Allahun e Plotfuqishëm që t'ua pranojë Haxhin dhe ibadetet, thuhet në njoftimin e BFI.

TAKIM KONSULTATIV ME KRYESINË E HAXHIT 2022/1443

Më 3 gusht, 2022, Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, konvokoi mbledhje konsultative me Kryesinë e Haxhit 2022, me koordinatoret dhe me Kryetarin e Kryesisë së Haxhit, h. Abedin ef. Imeri, ku gjerësisht u analizuan të gjitha aktivitetet rreth Haxhit 2022/1443, thuhet në njoftimin e BFI.

U bë një bisedë e hapur, konstruktive dhe, mbi të gjitha, Kryetari i BFI të RMV u informua në detaje me rrjedhën e kryerjes së Haxhit në këtë vit, ku në të njëjtën kohë u dhanë këto mendime:

1. Parapërgatitjet për në Haxh kanë qenë me një përkushtim të nivelit të lartë nga të gjitha organet e BFI, duke filluar nga Rijaseti e deri te Myftinitë;

2. Udhëtimi i haxhinjve është realizuar në mënyrën më precize nga Aeroporti i Shkupit deri në Xhide të Arabisë Saudite - si gjatë shkuarjes, ashtu dhe gjatë kthimit, falë precizitetit të agjencisë "Freebird";

3. Kushtet gjatë qëndrimit në Mekë dhe në Medinë kanë qenë të një standardi të mirëfilltë, duke iu ofruar haxhinjve

Haxh sa më komod dhe të rehatshëm;

4. Udhëheqësia, koordinatoret dhe udhëheqësit e grupeve bashkë me ekipin mjekësor kanë qenë në krye të detyrës;

5. Rrjedhat administrative në vendet e shenjta kanë ecur me përpikëri dhe me precizitetin më të madh;

6. Disiplina e haxhinjve ka qenë plotësisht në përputhje të plotë me programin e hartuar nga Kryesia e Haxhit;

7. Disponimi i haxhinjve, si gjatë qëndrimit në vendet e shenjta, po ashtu edhe gjatë kthimit, ka qenë në nivel të lartë;

8. Përcjellja dhe pritja e haxhinjve në aeroportin e Shkupit nga Komisioni i BFI, në krye me Reis'ul-Ulemanë dhe bashkëpunëtorët e tij, myftinjët etj., kanë qenë të mira dhe në shërbim të haxhinjve dhe janë cilësuar mbresëlënëse të haxhinjtë dhe familjet e tyre;

10. Përgjegjësit e Aeroportit treguan respektin dhe nivelin e lartë profesional, duke treguar vetëdije të lartë si ndaj haxhinjve, po ashtu edhe ndaj eprorëve të BFI të RMV;

9. U dhanë edhe sugjerime konstruk-

tive nga Kryesia për një Haxh edhe më të mirë në të ardhmen;

10. Në këtë mbledhje Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu u shprehur falënderime të përzemërta haxhinjve, imamëve, Myftinive - në krye me myftinjët, sektorëve të Rijasetit dhe në veçanti Kryesisë së Haxhit, duke u uruar shëndet të plotë dhe suksese të reja në jetën e tyre;

11. Të gjithë haxhinjve iu urua kryerja e Haxhit dhe u falënderuan për vetëdijen dhe disiplinën e nivelit të lartë që kanë treguar gjatë plot 25 ditëve qëndrimi në vendet e shenjta;

12. Mbetet t'i qasemi edhe një herë në mënyrë më serioze Haxhit në mbledhjen e rregullt të Rijasetit të BFI, që do të mbahet në të ardhmen, menjëherë pas përfundimit të pushimeve.

13. Allahu Fuqipotë të gjithë faktorët brenda dhe jashtë BFI të RMV, për kontributin e dhënë në organizimin e këtij obligimi të madh hyjnor, siç është kushti i pestë islam - Haxhi, t'u japë shëndet, jetë të gjatë dhe çdo të mirë në jetë, thuhet në njoftimin e BFI. (7.08.2022)

BFI PËR RASTIN NË PRESILLË

Bashkësia Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë së Veriut reagon ndaj qëndrimit të një grupi individësh, të cilët kanë ngritur iniciativë për të vendosur kryq mbi fshatin Presillë, komuna e Krushevës, akt i cili ka nxit pakënaqësi të madhe te banorët e fshatit, në të cilin jetojnë 99% shqiptarë të konfesionit islam.

Këtë veprim BFI e RMV e konsideron si një akt tendencioz, i cili tenton të provokojë dhe të nxit prishjen e marrëdhënieve ndërkonfesionale dhe bashkëjetesën në komunën e Krushevës.

I bëjmë apel grupit në fjalë, anëtarët e të cilët nuk janë as banorë të këtij fshati, që të ndërpresin këtë akt provokues, sepse kjo aspak nuk i duhet shoqërisë sonë në këtë kohë. Njëherësh, këshillojmë banorët e fshatit Presillë që të jenë të përmbytur dhe të evitojnë çdo konflikt të mundshëm eventual.



Po ashtu, BFI e RMV kërkon nga faktorët politikë dhe fetarë të Krushevës, në veçanti nga Kryetari i Komunës z. Tome Hristovski, që të ndërmarrin hapa të duhur ligjorë që të mos eskalojë situata.

BFI e RMV dhe Myftinia e BFI-Prilep po e përcjellin me kujdesin dhe me përgjegjësinë më të madhe situatën e krijuar dhe bashkë me organet kompe-

tente do të jenë në shërbim të qetësisë të situatës.

Objektet fetare dhe simbolet fetare duhet të jenë në shërbim të paqes, të bashkëjetesës dhe të harmonisë fetare dhe të ndërtohen për nevojat shpirtërore të besimtarëve në vendin ku jetojnë.

Shërbimi për Informim i BFI të RMV

(17.08.2022)

NJOFTIM

Pas reagimit të Bashkësisë Fetare Islame të RMV dhe të Myftinisë së Prilepit, si dhe në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës së Krushevës z. Tome Hristovski, situata tashmë është e qetë, pas tentimit për vendosjen e kryqit në territorin e fshatit Presillë, Krushevë.

BFI e RMV dhe Myftinia e Prilepit

edhe më tutje do të vazhdojnë të jenë në kujdesin më të madh që të mos përsëritet tentimi i mëparshëm, si dhe provokimet tjera, të cilat nuk janë në dobi të askujt.

Falënderojmë Myftiun e Prilepit, h. Shefket ef. Imeri, Kryetarin e Komunës së Krushevës dhe organet e rendit për

kontributin e dhënë në qetësimin e situatës. Qytetarët e Presillës të jenë të bindur se BFI e RMV me organet e saj gjithmonë do të jenë në shërbim të tyre.

Shërbimi për Informim i BFI të RMV

(18.08.2022)

KRIMBI

Miku im, mos u bëj si krimbi.

Krimbi i arrës e hap një vrimë në lëvoren e saj dhe hyn brenda. Brendësia e arrës ngjason me trurin e njeriut dhe ai fillon ta hajë atë.

Deri këtu është gjithçka normale. Duke ngrënë, krimbi trashet dhe i rritet barku.

Pas ngrënies së tepërt, ngihet dhe dëshiron të dalë, por vrima ku kishte hyrë tashmë është bërë shumë e vogël.

Më e keqja, arra e shpuar tashmë është tharë dhe forcuar dhe është e pamundur që vrima të zgjerohet.

Krimbi ndalet dhe mendon: e vetmja zgjidhje për të dalë është humbja e peshës.

Duke vazhduar urinë, kthehet në formën e vjetër dhe një ditë del nga arra.

Por, në dalje, tashmë, stina është kryer. Çka kishte mbetur, ishte vetëm një krimb i uritur dhe një arrë e zbrazët.

Shumë njerëz të dehur nga prona dhe pasuria i ngajnë krimbit të arrës.

Kur esëllohen dhe e ndalin vrapin pas pasurisë, vërejnë se



pranverat dhe verat kanë mbaruar.

Ajo çka ka mbetur, janë vetëm 'vjeshtat' dhe 'dimrat' e jetës, për të cilat ndoshta do të duhen shumë ilaçe e dieta për të mbi-jetuar. /27.07.2022, në bashkëpunim/

(Nga Senad Maku, Imam i Xhamisë së Klleznës, Ulqin)

NGJARJE E MADHE PËR VENDIN

Si një nga ngjarjet më të mëdha në vend e ka vlerësuar Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, vënien e gurit të themelit për fabrikën e makinave elektrike nga biznesmeni i mirënjohur z. Lazim Destani në Zonën e Lirë Ekonomike në Tetovë, thuhet në njoftimin e BFI.

Në faqen e tij zyrtarë Kreu i BFI këtë veprim e vlerëson si inspirim për të gjithë biznesmenët që duan të investojnë në vendlindje dhe thotë: "Sot ndodhi ngjarja e madhe. Biznesmeni i madh me repute ndërkombëtare, z. Lazim Destani, edhe më fuqishëm po i kthehet vendlindjes me investimin e madh - hedhjen e gur themelit të Fabrikës për prodhimin e veturave e.GO në Zonën e Lirë Ekonomike në Tetovë.

Kjo dëshmon edhe një herë se puna e palodhshme, vullneti i paluhatshëm dhe strategjia perfekte e një personaliteti siç është z. Lazim Destani dhe familja e tij, sjell deri tek arritjet madhore, siç është fabrika për prodhimin e veturave në Tetovë. Kjo, përveç tjerash, është një inspi-



rim i madh për të gjithë, që jetën ta mendojmë gjithnjë e më tepër në vendlindjen tonë, me investime të nivelit të lartë. Kjo është dëshmi e atdhedashurisë, e patriotizmit dhe e besimit në të ardhmen e vatanit.

Urime të përzemërta dhe ju priftë e mbara, z. Lazim Destani. Zoti ju bekoftë", shkruan Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, thuhet në njoftimin e BFI. (16.08.2022)

TAKOHEN IMAMËT MËRGIMTARË



Më 25 korrik, 2022, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, mori pjesë në takimin që u realizua në shkollën e mesme islame "Medreseja Isa Beu" në Shkup me imamët dhe kryetarët e Bashkësive dhe të Qendrave Islame në Zvicër, Gjermani, Austri, Itali, Skandinavi etj., thuhet në njoftimin e BFI.

Ishin të pranishëm Kryetari i KMSHZ (DAIGS) h. hfz. Mehas ef. Alija, Kryetari i Komunitetit të Bashkësive Islame të Austrisë (ALKIG) h. Vahidin Beluli, Kryetari i Kuvendit të BI së

Austrisë hafëz Emin Limani, imamë të qendrave islame nga mërgata, disa nga Myftinjët e Myftinive të BFI të RMV, Drejtorë të Sektorëve të Rijasetit të BFI, Drejtori i Medresesë Isa Beu prof. Ibrahim ef. Idrizi, Drejtori për çështje fetare në BFI prof. Jusuf Zimeri, profesorë të Medresesë etj.

Takimin e koordinoi Drejtori për Mërgatë, dr. Selver Xhemaili.

Në fjalën e tij të rastit, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, përshëndeti të pranishmit dhe i falënderoi për kontributin e dhënë në organizimin e jetës fetare

islame dhe synimet e saj (të jetës fetare) në të ardhmen.

Fjalë përshëndetëse mbajtën edhe h. hfz Mehas ef. Alija dhe h. Vahidin Beluli, të cilët falënderuan për takimin dhe informuan për punët që bëhen në organizimin e jetës fetare tek mërgata.

Takimi vazhdoi me ndarjen e mirënjohjeve për përfaqësuesit e jetës fetare, për kontributin e dhënë tek kurbanet dhe në aktivitete të tjera. Në fund, në shenjë respekti u shtrua darkë solemne për të gjithë të pranishmit, thuhet në njoftimin e BFI.

Informate

Rijaseti i BFI në RMV informon Hafizat e ri të Kur'anit Kerimit, se nga data **22-24.09.2022** Meshihati i Bashkësisë Islame në Kroaci organizon garat ndërkombëtare të 28-ta të Kur'anit Kerimit, prandaj të gjithë hafizat e Kur'anit Kerimit nga Republika e Maqedonisë së Veriut që dëshirojnë të marrin pjesë në këto gara kur'anore të paraqiten në Rijasetin e BFI-së në Shkup më së voni deri më **01.09.2022**.

Garat do të zhvillohen në katër kategori që janë:

- Kategoria e parë:** Hifz tërë Kur'anin (30 xhuz)
- Kategoria e dytë:** Hifz gjysmën e Kur'anit (15 xhuz)
- Kategoria e tretë:** Hifz pjesë (5) xhuz nga Kur'anit
- Kategoria e katërt:** Leximi Kur'anit- Tilawat.

Garuesit të cilët dëshirojnë të marrin pjesë në këto gara kur'anore, përveç përgatitjes profesionale duhet t'i plotësojnë edhe këto kushte:

- Duhet të jenë shtetas të RMV
- Të mos jenë më të moshuar se 27 vjet.

Marrë parasysh faktin se numri i garuesve është i kufizuar për çdo kategori vetëm nga një garues, në rast se numri i kandidatëve do të jetë më i madh, për përzgjedhjen e tyre nga Rijaseti i BFI do të formohet komisioni i veçantë i hafizave, ku do të testohen garuesit. Data e testimit do të jetë më 05. Shtator 2022 (dita e hënë) në shtet BFI-së me fillim në ora 11:00.

Të interesuarit do paraqiten në organet e BFI-së, Muftinitë përkatëse nga vjen garuesi, ose drejtpërdrejtë në Rijasetin e BFI-së respektivisht në sektorin Fetarë - Arsime në Shkup. Kontakt nr. +389 75 374 414 dhe +389 70 212 121.

Shërbimi Fetarë Arsime pranë Rijasetit të BFI në Shkup

Address: Cankina 52 Skopje 1000 North Macedonia / Tel: +389 (21) 311 410; 3117 412; Fax: 3117 883
www.bfi.mk | rijaseti.bfi@gmail.com | info@bfi.mk

GARAT E KURANIT
në nivel të medreseve në Balkan

QURAN COMPETITION
between high madrasas in the Balkans

مسابقة القرآن الكريم
على مستوى المدارس الإسلامية الثانوية في البلقان

VENDET PJESËMARRËSE
PARTICIPATING COUNTRIES
الدول المشاركة

KOSOVA BULLGARIA
SHQIPËRJA MALI I ZI

Faksimile e Informatës së BFI të RMV për Garat Kuranore në Zagreb, 22-24 shtator 2022. (4.08.2022)

MYFTINIA E GOSTIVARIT TAKON MËRGIMTARËT

Më 30 korrik, 2022, në qytetin e Gostivarit u realizua Takimi tradicional me veprimtarët tanë të diasporës, imamët, kryetarët e xhamive të ndryshme në Evropë dhe aktivistët e ndryshëm të jetës fetare jashtë vendit, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Gostivarit.

Në këtë takim, ku prezent ishte Myftiu i Gostivarit h. Sabahudin ef. Zendeli me administratën e Myftinisë, mori pjesë edhe kreu më i lartë i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu me bashkëpunëtorë.

Pas mirëseardhjes dhe hapjes së Takimit me përshëndetjen islame nga Myftiu h. Sabahudin ef. Zendeli, fjala e rastit iu dha Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i cili me këtë rast foli rreth rëndësisë që kanë këto qendra në Perëndim, por edhe për prezantimin e Islamit atje.

Ai i cilësoi këto qendra si përkrahja më e madhe vatanit dhe njerëzve të këtij nënqielli dhe i vlerësoi ata përfaqësues të



denjë të amanetit të Allahut (xh. sh.) në tokë, ndërsa udhëheqësit e këtyre qendrave kontribues të jashtëzakonshëm, me merita, që e mundësojnë prezantimin e fesë edhe në gjuhët e shteteve që vepronjë, të cilët kanë fatin, por edhe obligimin, që me një detyrë shumë të rëndësishme dhe të respektuar ta prezantojnë Islamit në Evropë, në Amerikë e gjetiu në mënyrën më të mirë të mundshme.

Ai gjithashtu i falënderoi veprimtarët

dhe aktivistët tanë të diasporës, të cilët, tha ai, me kontributet e tyre asnjëherë nuk i harrojnë qendrat edukativo-arsimore të BFI siç janë Medreseja Isa Beu dhe Fakulteti i Shkencave Islame në Shkup.

Prezent ishin përfaqësues të qendrave islame në vendet perëndimore, kryesisht nga BE, SHBA e më gjerë.

Në fund të takimit u shtrua dreka modeste në shenjë mirënjohjeje dhe falënderimi për nder të diasporës sonë, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Gostivarit.

KTHIMI NGA VENDLINDJA

Ti sot kthehesh në „gurbet“ me kokën pas, sepse përveç shtëpisë tënde të bukur, të cilën ti nuk e lë të shkretohet, e di se ke lënë edhe njerëz që të duan, që të çmojnë, që të vlerësojnë... Për ata ti je dikush dhe peshon në jetën e tyre...

Nga Rejhan Neziri

I nderuar bashkëkurbetçi. Sot është dita për të cilën nëna jote ka qarë qysh në nadjë, kur erdhe nga kurbeti. Atë ditë ajo qante edhe nga gëzimi, por edhe nga mërzia se do të vinte sërish kjo ditë e sotme, dita e ndarjes dhe e lamtumirës. Atë ditë ajo (sigurisht që edhe babai) nuk dinte ç'të bënte: të gëzohej për ardhjen tënde dhe të fëmijëve tu në çerdhen e ngrohtë familjare, apo të mërziqej për ditën kur do të largohesh prej saj...

Fjala kurbet (gurbet) është me prejardhje arabe - përmes turqishtes e bartur edhe te ne dhe nënkupton një vend a situatë të huaj, të panjohur, jo të zakonshme... Ti nuk e di se ku e ndjen veten garib (kurbetçi; gurbetqar): këtu ku je lindur dhe ku tani mezi e mbush muajin, apo atje ku qëndron njëmbëdhjetë muaj, ku jeton dhe punon vetë a me familjen tënde të ngushtë?! Nuk e di ku e ndjen veten të huaj e ku në shtëpi!

Ti je në dy karrige dhe, si duket, i rrëzuar nga të dyja karriget. Por, ti nuk dorëzohesh. Ti ngrihesh përsëri e përsëri, për t'u rrëzuar prapë e prapë... Ky qenka fati yt: bjer e ngrihu... Ngrihu dhe ji kokëllartë e ballëhapur, sepse ti po i jep vendlindjes tënde - jo dhe të fëmijëve tu - me bollëk, si kur je atje në „kurbet“, ashtu edhe këtu, në „atdhe/mëmëdhe“. Dhe, nuk merr asgjë prej këtu, përveç mallit, pikëllimit dhe fotove e videove, të cilat do t'i shikosh me lot e mallëngjim në njëmbëdhjetë muajt në vijim...

E di se mund të jesh mërziqur, nevrokësor dhe acaruar me disa situata jo të këndshme këtu, të cilat kryesisht kanë të bëjnë me komunikacionin, me ujin e pijshëm, me bërllokun etj., sepse ti e di se për t'i rregulluar dhe sistemuar këto, nuk duhet të jesh medoemos Zvicër a Gjermani - këto ndreqen edhe me pak mund e investim të mençur, por unë e di se ti do të vish përsëri këtu, në këtë vend, të cilin



ia ke mësuar përmendsh gropat dhe tumbat. Po, po. Ti do të vish, sepse këtu e ke nënën, babanë, vëllezërit, motrat, farefisnin, miqtë e mikeshat... që i do dhe të duan, të cilët qajnë për ty dhe për të cilët ti qan edhe kur i fsheh lotët, për të mos i mërziqur ata akoma më shumë...

Po, ti do të vish prapë dhe do ta pastrosësh shtëpinë, do ta rregullosh prapë oborrin dhe kopshtin tënd vitin e ardhshëm; do të mbjellësh lule, të cilave nuk do t'u marrësh erë gjatë kohës; do të mbjellësh pemë, të cilat vetë nuk do t'i shijosh... Ani, le t'i hanë të tjerët pemët, le t'i gëzojnë familjarët dhe miqtë tu. Ata janë tutë. Ti lumturohesh duke dhënë, duke dhuruar dhe jo duke grumbulluar vetëm për vete e duke zhvatur njerëz, shoqëri e shtet. Këtë të fundit ti e quan mëkat dhe të plas zemra kur sheh njerëz a institucione që e bëjnë pikërisht këtë nga mendjemadhësia shejtanore (djallëzore) dhe nga pangopësia shtazarake...

Krahas të gjitha këtyre rasteve që ta vrasin zemrën, syrin dhe veshin, ti gjete kohe t'i vizitosh, bashkë me gruan dhe fëmijët tu, miqtë e mikeshat, farën dhe fisin, që të mos harroheni, që të rinjtë dhe të rejtat e farës dhe të fisit të mos ngatërrohen me njëri-tjetrin përmes botës virtuale, nga shkaku se nuk njihen... Ti bën kujdes të madh në ruajtjen e lidhjeve familjare dhe

farefisnore, sepse këtë e di edhe si detyrë fetare e morale; jo thjesht vetëm si një traditë, apo si një rutinë që duhet përsëritur. Këto vizita i japin kuptim jetës tënde, të mbushin me dashuri e respekt, ta shtojnë vetëvlerësimin, ta heqin ndjenjën e vetmisë, të tëhuajësimin e të mbylljes në vetvete. Ti sot kthehesh në „gurbet“ me kokën pas, sepse përveç shtëpisë tënde të bukur, të cilën ti nuk e lë të shkretohet, e di se ke lënë edhe njerëz që të duan, që të çmojnë, që të vlerësojnë... Për ata ti je dikush dhe peshon në jetën e tyre...

I nderuar bashkëkurbetçi. Vazhdo ta duash atdheun tënd, vendin e të parëve tu, pavarësisht se nuk të pëlqejnë disa gjëra. Mundohu t'i gjesh anët e bukura, të mira e të dobishme të vendlindjes tënde, apo të prindërve tu. Syri që e kërkon të bukurën, do ta gjejë atë kudo; veshi që dëshiron ta dëgjojë të mirën, do ta gjejë atë kudo; zemra që lakmon të këndshmen, do ta gjejë atë kudo...

Rrofshim e qofshim bashkë me njëri-tjetrin në këtë botë dhe në botën tjetër. Allahu mos na ndaftë e mos na largoftë zemrat kurrë nga njëri-tjetri!

Mbeçi me dashurinë e pashtershme hyjnore!

(Autori është Imam në Xhaminë Hëna e Re në Kreuzlingen TG, Zvicër)

DUA HIFZI NË ÇELLOPEK TË TETOVËS



Në një ambient impozant, në xhaminë e fshatit Çellopek të Tetovës, në organizim të Myftinisë së Tetovës me në krye Myftiun prof. dr. Qani ef. Nesimi, më 27 korrik, 2022, u bë hatme pas mësimin përmendsh të Kuranit famëlartë nga ana e hafëzes Jusra Fatmir Shabani, thuhet në njoftimin e BFI.

Në hatmen e udhëhequr nga muhafizi h.fz. Ibrahim ef. Alija, Imam në Xhaminë Rinia, mori pjesë Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis'ul-Ulema h. h.fz. Shaqir ef. Fetahu, i shoqëruar nga dr. Husejn al-Davudi, Kryetar i SCR-Këshilli Skandinav për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe anëtar i Rabitatul alem el-Islami, i shoqëruar nga dr. Avad Saleh, anëtar i Asamblesë së UNESCO-s për Kulturë dhe Dialog, të cilët ishin mysafirë specialë në këtë manifestim të duasë së hifzit.

Po ashtu, të pranishëm ishin edhe Sekretari i Përgjithshëm i BFI h. Irsal ef. Jakupi, Myftiu i Strugës mr. Salim ef. Sulejmani, Myftiu i Shtipit mr. Nasir ef. Rexhepi, Myftiu i mëparshëm i Tetovës h.fz. Nexhati ef. Limani, Drejtori i Medresës Isa Beu prof. Ibrahim ef. Idrizi, familjarë të hafëzes së re, drejtorë të Sektorëve të ndryshëm të Rijasetit të BFI, mysafirë nga Kosova dhe Shqipëria, profesorë nga Medreseja dhe Fakulteti i Shkencave Islame, hoxhallarë e imamë nga vendi e nga diaspora, xhematlinj dhe besimtarë, të cilët përcollën një program të organizuar bukur si për nga forma,

ashtu dhe nga përmbajtja.

Tubimin e përshëndeti nikoqiri i këtij manifestimi, prof. dr. Qani ef. Nesimi, i cili tha se tubimet e këtilla janë bazë e një ardhmërie të shëndoshë islame, me ç'rast vërehen mosha gjithnjë më të reja të hafëzllarëve dhe kjo na bën të ndjehemi krenarë. Ai potencoi se hafëze Jusra është hafëzja më e re në këto dy dekadat e fundit.

Po ashtu, fjalën kryesore e mbajti Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. h.fz. Shaqir ef. Fetahu, i cili në paraqitjen e tij dha këshilla mbi rolin e edukimit të fëmijëve dhe gjeneratave të reja, për të trasuar rrugën e Islamit drejt ardhmërisë, pavarësisht se ku ndodhen ata - në vendlindje apo në mërgim, për ta përcuar amanetin e gjyshërve tanë në vend dhe për të krijuar kushte më të volitshme për edukimin dhe arsimimin e brezave të rinj, të cilët duhet të ecin me kohën. Rasti me hafëzen e re Jusra Shabani, dhe familjen Shabani të përgjithësi, është një dëftues që duhet të merret për shembull nga të gjithë.

Duanë e bëri Myftiu i mëparshëm i Myftinisë së Tetovës, h.fz. Nexhati ef. Limani, ndërsa namazit të drekës i priti Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame, Reis'ul-Ulema h. h.fz. Shaqir ef. Fetahu, thuhet në njoftimin e BFI.

Të dhënat për hafëzen e re i prezantoi Kryetari i Komisionit të Hifzit, Referenti për arsim fetar pranë Myftinisë së Tetovës h.fz. Abdurrahim ef. Murati. Diplomën e dorëzuan Kryetari i BFI-së dhe Myftiu i

Tetovës. Në shenjë respekti, Rijaseti i BFI-së dhe Myftinia e Tetovës hafëzes së re i ndanë nga një dhuratë simbolike, thuhet në njoftimin e Myftiut të Myftinisë së Tetovës prof. dr. Qani ef. Nesimi.

Pas përfundimit të programit në xhami, u shtrua dreka në restorantin "Planet". Para ushqimit, në këtë event të pranishmit kishin mundësi të dëgjonin ilahije të kënduara nga dy grupe ilahistësh. Ndërkohë, në vazhdim të pranishmit i përshëndetën: anëtar i familjes Enis Kastrati, Imami i Qendrës Islame Kulturore Shqiptare në Norvegji Berat ef. Hashani, Koordinator i shkollave të mësimbesimit dhe shkollës së gjuhës shqipe në Norvegji z. Metush Bajrami, Kryetari i Kuvendit të ALKIG-Austri Emin ef. Limani, Kryetari i Komunitetit Mysliman Shqiptar në Zvicër h.fz. Mehas ef. Alija, Imami i Xhamisë së Prishtinës Fadil ef. Musliu, Myftiu i Shkodrës Muhamed ef. Sytari, Kryetari i Këshillit Skandinav për Marrëdhënie Ndërkombëtare në Norvegji Husein Davudi, Myftiu i Tetovës prof. dr. Qani ef. Nesimi dhe Reis'ul-Ulema h. h.fz. Shaqir ef. Fetahu.

Pas duasë u bë ndarja e dhuratave nga Qendra Islame Kulturore Shqiptare në Norvegji për h.fz. Ibrahim ef. Alinë dhe h.fz. Muhamed ef. Mustafanë, thuhet në njoftimin e Myftiut të Tetovës.

Duaja e hifzit në fshatin Çellopek është transmetuar drejtpërdrejt, në kohë reale, në platformat elektronike të BFI të RMV.

ERDHI ME HIFZ TË PËRFUNDUAR NË OSLO



Nga Taxhudin Hamidi

Porosit Muhamedi (alejhis-selam): “Edukoni fëmijët të duanë Allahun (Krijuesin e Gjithësisë), të dërguarin e Tij dhe Librin e shenjtë, Kuranin.” Rruga drejt xhenetit fillon me shkronjat e para të mësuara nga Kurani famëlartë. Identiteti fetar është i pamundur të ndërtohet në mungesë të shkronjave të Kuranit, kështu që shkronjat e tij mundësojnë aftësinë e leximit të Kuranit fisnik.

Prandaj, sistemi arsimor dhe pedagogjik i leximit dhe mësimi të Kuranit fisnik kërkon një angazhim dhe përpjekje të vazhdueshme, duke filluar nga: njohja e alfabetit të Kuranit fisnik; mësimi i rregullave të leximit të Kuranit fisnik; njohja e texhvidit të Kuranit fisnik.

Hafëzja Jusra Fatmir Shabani nga fshati Çellopek i Epërm i Tetovës është me qëndrim në Oslo, Norvegji. Çellopeku, ndërkaq, është një fshat me banorë shumë religjioz, shumë patriot dhe shumë punëtor, në të gjitha sferat e jetës. Ata me dijen, me vullnetin dhe punën e tyre të palodhshme kanë ndërtuar një infrastrukturë urbane të banimit, saqë sfidojnë që këtë vendbanim ta kthejnë, me të gjitha efektet dhe mekanizmat e duhur, në një qytet të pastër dhe të sigurt për jetesë.

Fshati shtrihet rrëzë Malit të Thatë, në pjesën juglindore të Pollogut të Poshtëm dhe graviton në komunën e Berenicës. Gjendet jo më shumë se 12 km

në juglindje të Tetovës.

Jusra Shabani sot mahnti xhematin dhe myslimanët e fshatit Çellopek dhe të mbarë trevave shqiptare në Xhaminë e Mesme të Çellopekut të Epërm, ku u bë dua e hifzit. Ajo është e lindur më 20.05.2010 dhe me prindërit jeton në Oslo të Norvegjisë.

Hafëzja e re mësues-mualim të hifzit (mbamendjes së Kuranit) ka pasur drejtpërdrejt prindërit e vet, babanë dhe nënën. Me mësim online ka qenë i angazhuar muhafizi dhe imami i Xhamisë së Rinisë në Tetovë, h.fz. Ibrahim ef. Alija.

Manifestimi i dua-hifzit asnjëherë nuk ka qenë më atraktiv, më i dashur dhe më i bukur. Hafëzja na e solli hifzin nga Evropa, përkatësisht nga Skandinavia. Shumë mahnitës ishte lajmi se po na vjen një hafëze nga kryeqyteti i Norvegjisë, Oslo. Të gjithë u gëzuan nga fakti se ka zgjedhur vendlindjen për të inauguruar kompletimin e hifzit.

Prindi i hafëzes është një teolog i njohur dhe dëshira e tij ishte që kjo ceremoni dhe ky solemnitet të përshkohet nga autoritetet e strukturave fetare islame të BFI të RMV. Kryetari i saj, h.fz. Shaqir ef. Fetahu, tha se ky akt është një fuqi që tregon se dëshirën e besimtarit mysliman askush nuk mund ta pengojë, kudo që të jetë ai. Mehas ef. Alija, ndërkaq, me këtë rast deklaroi se hafëzen Jusra Shabani e kanë si yll dhe “do ta ruajmë si mbesëtonë në zinxhirin e gjatë të hafëzëve të fa-

miljes Alija”.

Hafëzja e re mësimin e Kuranit e ka kaluar para nënës së saj, e cila ka dhënë një mund të pakrahueshëm si mentore dhe muhafize. Është kjo një befasi e mirë, një dëshmi se një nënë myslimane shqiptare në Oslo mund të përgatit vajzën e vet në mësimin përmendsh të Kuranit fisnik. Është një rast i rrallë, një shembull për të rinjtë dhe të rejtat në vendin tonë, gjithkund në trevat shqiptare, dhe në Evropë. Një proverb thotë: “Vullneti bën çudira.”

Mbamendja e Kuranit ishte dhurata më e mirë, simboli i arsimit, i edukimit dhe shkollimit të shëndoshë që u solli hafëz Jusra Shabani shoqeve të saj në fshatin Çellopek dhe më gjerë. Me propozim të Myftinisë së BFI-Tetovë, ajo nga Reis’ul-Ulema h.fz. Shaqir ef. Fetahu, Kryetari i BFI të RMV, mori diplomën me titullin “HAFËZE E KURANIT FISNIK”! Kështu, ajo shpallet publikisht si një ndër rojet e Kuranit famëlartë në trojet e Evropës, përkatësisht në Oslo të Norvegjisë.

Modelet dhe mekanizmat e sensibilizimit të Kuranit fisnik nuk janë të një metodologjie, por ato janë të ndryshme dhe varësisht nga moshë, gjendja, vendi dhe rrethanat politike. Gjithnjë pa harruar fjalën e pejgamberit, Muhamedit (alejhis-selam): “Më i miri prej jush është ai që e mëson Kuranin dhe atë ua mëson të tjerëve.”

RIFAT JASHARI, QYTETAR NDERI I TETOVËS

BFI në shpalljen Qytetar Nderi të Rifat Jasharit nga Komuna e Tetovës: Më 22 korrik, 2022, përfaqësuesi i Reis’ul-Ulema h.fz. Shaqir ef. Fetahu, Drejtori për Mërgatën në Rijasetin e BFI të RMV dr. Selver ef. Xhemali mori pjesë në manifestimin e shpalljes Qytetar Nderi nga Komuna e Tetovës të z. Rifat Jashari, ikonës së familjes së Jasharajve nga Prekazi i Kosovës, thuhet në njoftimin e BFI.

Vendimin për të shpallur Qytetar Nderi Rifat Jasharin, vëllain e komandantit legjendar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Adem Jashari, e ka marrë Kryetari i Komunës së Tetovës Bilall Kasami. “Qytetar Nderi shpallim njërin ndër figurat më të rëndësishme të historisë më të re të shqiptarëve që jetojnë në Ballkan. Kjo do të jetë një simbolikë e mirë se shqiptarët po ecin përpara dhe se shqiptarët nuk i harrojnë ata që kanë sakrifikuar më



të dashurit e tyre për këtë që e kemi arritur sot si shqiptarë”, ka deklaruar për gazetën “Koha” (Shkup) Kryetari i Komunës së Tetovës Bilall Kasami.

Për shkaqe shëndetësore, z. Rifat Ja-

shari nuk mundi që të merrte pjesë në këtë manifestim. Në vend të tij titullin Qytetar Nderi e pranoi djali i kryekomandantit Adem Jashari, Lulzim Jashari, thuhet në njoftimin e BFI.

O, MOJ KOSOVË...

Nga Nexhati Spahiu

O, moj Kosovë, e mjera ti, në çdo anë nga një fatkeqësi!

Fatkeqësisht, vendi ynë është shndërruar në një vend çudirash të shumta.

Rinia: Çdo ditë që lind dielli dëgohen fjalë të ndryshme nga të rinjtë se si të largohen nga ky vend. Shumë vende të ndryshme luten ta kenë një rini të tillë, por fatkeqësisht te ne mungon e ardhmja e tyre (dikush po e grabit të ardhmen e tyre).

Shkollimi: Në të kaluarën, për të aritur te dituria është dashur të japësh djersë e mund, ndërsa sot mjafton të kesh para dhe njoftësi nuk mungojnë titujt; i dituri llogaritet analfabet, ndërsa çobani me universitet...

Papunësia: Fatkeqësisht, në vendin tonë përparësi në punë kanë njerëzit “e fortë”. Parësore për ta është që të kenë disa vende pune për vete e më pas t’i rehatojnë familjarët e tyre, ndërsa njerëzit meritore u prishin plane atyre...

Familja: Nuk ka harmoni, nuk ka dashuri, nuk ka respekt. Shtëpitë sot janë shndërruar në motele dhe nuk dihet kush është prindi e kush fëmija!

Morali: Ekziston vetëm si term; rrallëherë mund të gjendet. Njerëzit paraqi-



ten në formën engjëlllore, ndërsa e vërteta e tyre është djallëzore.

Pasuria: Nuk është problem si ftohet, por e rëndësishme: se si të grumbullohet edhe më shumë. Për disa nuk është problem as ligji, as Zoti...

Korrupsioni: Fatkeqësisht, njerëzit sot paraqiten si engjëj e, në realitet, e zëvendësojnë shejtanin në çështjet e mashtrimeve. Një gjë të tillë ata e llogaritin si zotësi të tyre...

Drejtesia: Nuk është një gjë e pamundur, por fatkeqësisht sot shpresat, besimi, çdo ditë e më shumë po humbet. Por, çdokush do ta paguajë një ditë...

Fatkeqësitë: E keqja më e madhe

vjen nga ana jonë, sepse përkrahen zulumqarët. P.sh. kohëve të fundit dëgohen vrasje, vetëvrasje, dhunime, korrupsime etj. Fajtori mbetet jetim...

Kontributi: A thua vetëm një shtresë njerëzore kontribuoi në këtë vend? Të gjithë kemi sakrifikuar, duke filluar nga shkollimi ynë, kontributi në mbrojtjen dhe zhvillimin e këtij vendi.

Ky vend, ky popull, ky atdhe dhe kjo fe nuk e meritojnë të paguhet një faturë të tillë.

Lutemi që Zoti të na ndihmojë në punë të mira... (24.07.2022/në bashkëpunim)

ASHURJA NGA NJË KËNDVËSHTRIM TJETËR

Nga **Nehat Ismaili**

“Zoti e mëshiroftë vëllain tim Musain; ai u lëndua më shumë se kaq, por ishte i durueshëm.” (Muhamedi a. s.) “Nuk dihet saktësisht se kush është faraoni, gjatë sundimit të të cilit ndodhin ngjarjet e rrëfimit. Identifikimi historik nuk është një nga qëllimet e rrëfimit kuranor; nuk i shton asgjë. Mjafton të dimë se kjo ishte pas kohës së Jusufit – paqja e Zotit qoftë mbi të - i cili solli babanë dhe vëllezërit e vet. Ata u shumuan në Egjipt dhe u bënë një popull i madh.”

Kaptina El-Kasas është kaptinë me-kase. Gjatë shpalljes së kësaj sureje myslimanët në Mekë ishin të paktë në numër dhe të dobët, ndërsa paganët mekas posedonin pushtet, forcë, prestigj dhe autoritet.

Kjo sure, e shpallur nga Zoti i Madhërishtëm, erdhi për të vendosur ekuilibrin e vërtetë midis forcës dhe vlerave. U shpall për të konfirmuar faktin se ekziston vetëm një fuqi në këtë ekzistencë, që është fuqia e Zotit; dhe se ka vetëm një vlerë në këtë univers, që është vlera e besimit. Kushdo qoftë që fuqia e Zotit është me të, ai nuk duhet të shqetësohet e as të ketë frikë për të, edhe nëse ai është i zhveshur nga të gjitha manifestimet e fuqisë. E, kush e ka vlerën e besimit, ai i ka të gjitha të mirat; e, kush e humb këtë vlerë, nuk i bën dobi asgjë. (Nën hijen e Kuranit/*Fi Dhilalil Kuran*, Sejid Kutub)

Në ajetet e para të sures El-Kasas e gjejmë hartën e rrugës, e gjejmë historinë si fillim, si projekt dhe si fund. Në këtë sure Zoti i Madhërishtëm flet në detaje shumë interesante për konfliktin e hartës. Zaten kështu është gjatë çdo periudhe të historisë njerëzore, pa ndonjë ndryshim, sepse Ligjet (ar. Sunen) e Zotit në Univers janë statike dhe kjo sure na jep një detaj shumë interesant se në këtë konflikt janë përfshirë tre palë:



Së pari, **faraoni**, i cili përfaqëson majën e tiranisë dhe të arrogancës së pakufishme. Ai mendoi se vetëm fuqia është ajo që e drejton universin, ndaj vendosi të zbatojë ligjin e përjashtimit në të gjitha detajet e tij, kështu që vrau meshkujt, i skllavëroi gratë dhe përdori politikën e përçarjes dhe fragmentimit. “Me të vërtetë, faraoni ka ngritur kryet lart në tokë, e popullin e saj e ka grupuar dhe një grup prej tyre e shtyp, ashtu që djemtë e tyre ua mbyt, ndërsa gratë e tyre ua lë të jetojnë. Vërtet, ai ishte prej më shkatërrimtarëve.” (përkth. Sherif Ahmed)

ATA U BËNË KUJDESTARË TË TIRANIT

Së dyti: Njerëzit që pranuan skllavërimin dhe u bënë kujdestarë të këtij tirani dhe nuk u përpoqën të rezistonin në të gjitha mënyrat e mundshme, por përkundrazi, u bënë një mjet për projektet dhe tiraninë e tij. Kurani foli për natyrën e sistemit faraonik në mënyrë të shkëlqyer dhe kur mediton të gjitha ajetet, arrin në perceptimin e saktë të sistemit të tiranisë të asaj kohe dhe nga ky sistem në pah shfaqet mendjemadhësia dhe arroganca e faraonit, të ushtruara në mënyrë çnjerëzore, duke ushtruar korrupsion politik dhe mendor në mënyrë sistematike, si: vrasjen e njerëzve padrejtësisht (duke therur fëmijët e tyre), pretendimin e hyjnisë dhe se vendi dhe shërbëtorët i për-

kasin vetëm atij dhe jo të tjerëve, kështu që në gjithë këtë korrupsion njerëzit ishin palë aktive në industrinë e korrupsionit, për shkak të joefektivitetit, pranimi të jetës nën tirani dhe mungesës së vizionit prej tyre për të dalë nga kjo krizë.

Së treti: Vullneti hyjnor që bën historinë përtej botës metafizike, siç tha i Plotfuqishmi: **“E Ne duam t’i lartësojmë ata që u shtypën në tokë, t’i bëjmë udhëheqës dhe t’i bëjmë trashëgues.”** (El-Kasas: 5) Ky vullnet nuk është palë e zakonshme, por është një palë e fshehtë dhe nuk vjen në mënyrë të rastësishme, por vjen në momentet e duhura. Për këtë arsye Zoti i Madhëruar i tha Musait (alejhiss-selam): **“e pastaj erdhe, o Musa, në kohën e caktuar”.** (Kaptina Ta-Ha: 40)

Historia është lëvizje drejt një qëllimi të caktuar, kështu që kushdo që përpiqet ta zvarrit historinë mbrapa, gabon. Kurani paraqitet referencë për ummetin mysliman në ekspozimin e problemeve të historisë dhe nuk është thjesht një libër rëndomtë i historisë, por më shumë se kaq dhe ne i kthehemi atij duke lexuar ajetet kuranore për të rishikuar qëndrimet, në mënyrë që të njohim defektet dhe boshllëqet në jetën tonë sipas dispozitave të tij dhe t’i korrigjojmë ato sa më shumë që të jetë e mundur.

Kurani fisnik diskutoi për korrupsionin politik të manifestuar përmes Faraonit. Sipas Kuranit fisnik, Faraoni nuk është thjesht një njeri që jetoi në një moment të caktuar dhe me kaq përfundoi, por ai ishte shembull i kohës për të mbetur në kujtesën njerëzore sa të jetë jeta në këtë botë. Gjithashtu, Musai (paqja qoftë mbi të) nuk ishte një profet dhe i dërguar që luajti një rol misionar në popullin e tij dhe vetëm kaq, por ishte dhe mbeti një simbol i rezistencës dhe luftës, një dritë në rrugën e thirrjes në besimin në Një Zot dhe luftës së shenjtë për hir të çlirimit të *beni israilëve*, të cilët për një kohë të gjatë i ishin ekspozuar poshtërimit, diskriminimit, persekutimit dhe vrasjeve më mizore, kështu që Musai (paqja e Zotit qoftë mbi) u bë model për të gjithë ata që erdhën pas tij dhe prej këtu peygamberi i Zotit, Muhamedi (alejhiss-selam) e përmendi shumë Musain në fjalët e tij: **“Zoti e mëshiroftë vëllain tim Musain; ai u lëndua më shumë se kaq, por ishte i durueshëm.”**

Atëherë, pse preferohet agjërimi i ditës së Ashuras?! Këtë më së miri e kuptojmë nga hadithi i peygamberit Muhamed (alejhiss-selam), i cili kur arriti në Medinë, i gjeti hebrenjtë e Medinës duke agjëruar ditën e dhjetë të muajit Muhar-

rem, kështu që i pyeti rreth sekretit të agjërimin të tyre dhe ata thanë: ‘Kjo është dita kur Zoti e shkatërroi faraonin dhe e shpëtoi Musain (alejhiss-selam), e ai tha: ‘Ne jemi më të merituar për Musain se ata’, kështu ai agjëroi dhe urdhëroi agjërimin e kësaj dite. Ndonëse transmetimet e shumta flasin që peygamberi Muhamed (a. s.) e agjëronte këtë ditë duke qenë në Mekë, edhe para emigrimit - hixhretit të tij në Medinë.

Dita e Ashures, përkatësisht dita e dhjetë të muajit Muharrem, është një moment historik që përfaqëson një moment përcaktues në histori, që nënkupton fillimin e periudhës së çlirimit të *beni israilëve* dhe fundin e shtypjes së faraonit ndaj tyre dhe këtu ka mësim të shumta, prandaj myslimanët e agjërojnë ditën e Ashures.

Islami e refuzon tiraninë, zullumin dhe padrejtësinë dhe e urdhëron drejtësinë. Nuk është e rastësishme që urtësia hyjnore të jetë prezente në të gjitha mesazhet qiellore për të vendosur drejtësinë në tokë: **“Ne i dërguam të dërguarit Tanë me dokumente të qarta dhe Ne zbritëm me ata librin dhe drejtësinë që t’i përmbahen njerëzit drejtësisë.”** (El-Hadid: 25) Prandaj myslimanët e agjërojnë ditën e Ashures.

JETA HUMB KUPIMIN ATY KU USHTROHET PADREJTËSIA

Jeta humb kupimin aty ku ushtrohet padrejtësia dhe vlera e një feje qëndron në mësimet e saj, që urdhëron besimtarët që të ushtrojnë drejtësinë me të gjitha kombet dhe racat pa përjashtim, sepse njerëzit janë krijuar të lirë dhe gjithashtu duhet të jenë të lirë dhe për këtë arsye peygamberi Muhamed (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) e ndërlihd adhurimin (lexo: agjërimin e Ashures) me këtë moment historik dhe situatë politike dhe anasjelltas.

Në anën tjetër, sipas shënimeve historike, në vitin 61 sipas kalendarit islam është vrarë në pabesi dhe padrejtësisht Imam Husejni (Allahu qoftë i kënaqur me të), nipi i peygamberit Muhamed (paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të). S’do mend që kjo datë shënon një nga datat më të dhimbshme të historisë së myslimanëve dhe ata që çuan dorë për ekzekutimin e tij, meritojnë poshtërimin dhe ndëshkimin e Zotit në këtë botë dhe në botën tjetër.

Por, ajo që manifestohet në këtë ditë nga pjesëtarët e shiitëve si: rrahja e vetes me kamxhik, me shufra hekuri dhe derdhje të gjakut deri në alivanosje, është e papranueshme për një mendje të shën-

doshë dhe për natyrën e pastër të Islamit, duke rikujtuar se më herët janë martirizuar dhe vrarë në pabesi edhe tre khalifët e mëdhenj të Islamit, si: Omeri, Othmani dhe Aliu, babai i Husejnit (Allahu qoftë i kënaqur prej tyre).

Jeta ka nevojë për njerëz që bartin vlera dhe parime, që i mbrojnë ato dhe për shkak të tyre sakrifikohen, burgosen, madje edhe jetojnë në mërgim larg atdheut dhe pikërisht kjo ndodhi me Musain (alejhiss-selam).

Në këtë ditë, Zoti i Plotfuqishëm e demaskoi dhe e fundosi në det Faraonin me tërë ushtrinë e tij. Ndërkohë, e shpëtoi Musain dhe popullin e tij. Prandaj myslimanët e agjërojnë ditën e Ashures.

Dita e Ashures shënon fundin e despotit më të madh që njohu historia, ndërkohë që myslimanët janë të urdhëruar të mbështesin dhe të rreshtohen çdoherë me drejtësinë dhe, si shenjë falënderimi nga Zoti, myslimanët agjërojnë Ashuren. (8.08.2022/në bashkëpunim)

MOSHA E PEJGAMBERËVE

Mosha e të dërguarve të Zotit kur ndërruan jetë:

Muhamedi (a. s.) - 63 vjeç;
Isai (a. s.) - 33 vjeç;
Jahja (a. s.) - 40 vjeç;
Dhul Kifli (a. s.) - 75 vjeç;
Luti (a. s.) - 80 vjeç;
Ejubi (a. s.) - 93 vjeç;
Davudi (a. s.) - 100 vjeç;
Jusha (a. s.) - 110 vjeç;
Musai (a. s.) - 120 vjeç;
Haruni (a. s.) - 120 vjeç;
Jusufi (a. s.) - 120 vjeç;
Ismaili (a. s.) - 137 vjeç;
Shuajbi (a. s.) - 140 vjeç;
Jakubi (a. s.) - 147 vjeç;
Hudi (a. s.) - 150 vjeç;
Ishaku (a. s.) - 160 vjeç;
Ibrahimi (a. s.) - 200 vjeç;
Salihu (a. s.) - 270 vjeç;
Idrisi (a. s.) - 365 vjeç;
Shithi (a. s.) - 912 vjeç;
Ademi (a. s.) - 1000 vjeç;
Nuhi (a. s.) - 1450 vjeç.

Përgatiti: Ibrahim Beqiri/
në bashkëpunim

NJË DELEGACION NGA GCERF VIZITOI BFI-në



Një delegacion i Fondit Global të Angazhimit dhe të Rezistencës së Komunitetit (Global Community Engagement and Resilience Fund, GCERF), me seli në Gjenevë (Zvicër), më 27 korrik, 2022, qëndroi në Bashkësinë Fetare Islame të RMV në Shkup, thuhet në njoftimin e BFI. Takimi kishte në fokus bashkëpunimin, përkatësisht koordinimet e mëtejshme të BFI-së, të institucioneve dhe të

organizatave të ndryshme nga vendi dhe jashtë, në aktivitetet e projekteve rreth ekstremizmit të dhunshëm, udhëhequr nga konsorciumi i Qendrës për Bashkëpunim Ndërkombëtar, mbështetur nga GCERF.

Delegacionin në emër të Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu e pritën Drejtori i Punëve të Jashtme të BFI-së mr. Mustafa Dauti dhe Shefi i Kabinetit të Reis'ul-Ulema h. hfz. Abdulkerim Iseni.

Në takim prezantuan: Kevin Osborne, Drejtor i GCERF për Ballkanin dhe ekipi i tij; Aleksandar Kërzhalovski, Drejtor Ekzekutiv i Qendrës Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar; Samet Shabani, udhëheqës i Horizon Civitas; Magdalena Lembovska, zyrtare nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Maqedoninë e Veriut – thuhet në njoftimin e BFI.

REISI TAKON KËSHILLIN E XHAMISË ASR



Këshilli i xhamisë "Asr" në Ingolstadt (Gjermani), në përbërje: z. Rexhep Rexhepi – nënkryetar; Izair Shahini, arkëtar dhe Bekim Zenuni vizitoi BFI-në dhe u prit nga Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, thuhet në kumtesën e BFI.

Udhëheqja e BFI-së pati kënaqësinë nga pritja në Kabinet. Qendra Islame në Ingolstadt është shumë njohur në Gjermani dhe më gjerë me aktivitetin e madh me dekada në shërbim të jetës fetare dhe kombëtare në Perëndim dhe në vendlindje.

Me këtë rast u bisedua gjerësisht për

punët e Qendrës, ndërsa Reis'ul-Ulemaja shprehu mirënjohje të veçantë për kontributin e madh, si dhe për atë çka bën për institucionet fetare-arsimore të BFI-së.

Në këtë xhematë me dekada është menaxhuar jeta fetare islame me lexues të mirënjohur, me famë botërore, të Kuranit famëlartë, me pjesëmarrje të shumta në gara ndërkombëtare dhe me përfaqësim të madh të myslimanëve të Ballkanit dhe të Evropës në to, me ligjëratat të mirëfillta që kanë lënë mbresa në zemrat dhe vetëdijen e besimtarëve.

Vizita e mysafirëve të çmuar impre-

sionoi Reis'ul-Ulema h. hfz. Abdulkerim Iseni, veçanërisht ideja nga Kryesia e Xhamisë me synimin për blerjen e një objekti, me qëllim të organizimit sa më të mirë të jetës fetare islame dhe edukimin e gjeneratave të reja.

BFI e RMV i dha përkrahje kësaj ideje, e bindur se besimtarët janë bujarë dhe se me ndihmën e Allahut fuqiptot mund t'ia dalin me sukses. Së bashku me Drejtorin për Çështje të Mërgatës, dr. Selver Xhemaili, Reis'ul-Ulemaja i inkurajoi mysafirët dhe u dha përkrahje në këtë ide të madhe. Zoti i bekoftë, thuhet në njoftimin e BFI. (10.08.2022)

KRYETARI I KËSHILLIT SKANDINAV NË BFI

Më 26 korrik, 2022, Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, priti në Rijaset dr. Husejn al-Davudin, Kryetar i SCR - Këshilli Skandinav për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe anëtar i Rabitaturit aleml-Islami, i shoqëruar nga dr. Avad Saleh, anëtar i Asamblesë së UNESCO-s për Kulturë dhe Dialog. Me mysafirët u zhvillua një bisedë konstruktive mbi rrjedhat e zhvillimeve në Ballkan dhe më gjerë, thuhet në njoftimin e BFI.

Në takim ndanë mendimin se myslimanët janë faktorë konstruktiv në këtë nënqiell dhe kudo në Evropë. Ekstremizmi dhe terrorizmi janë dukuri të huaja për Islam, andaj kultivimi i shkencës, bashkëpunimi, paqes është vlera më e madhe në marrëdhëniet ndërmjet popujve dhe besimeve.

Dr. Husejn Davudi është njohës i mirë e rrethanave dhe zhvillimeve në Evropë, sepse me dekada prezanton vlerat e Islamit në këtë ambient. Po ashtu, u bisedua edhe për shumë çështje të ba-



shkëpunimit në sfera të ndryshme.

Mysafirët e lartë janë të ftuar në duanë e hifzit të hafëzes së re Jusra Shabani, e bija e Fatmir efendiut nga fshati Çellopek (Tetovë), me punë në Oslo të Norvegjisë. Me dr. Husejn el-Davudin Reis'ul-Ulema h. hfz. Abdulkerim Iseni lidh miqësinë nga takimet në konferencat ndërkombëtare.

Vizitën e koordinoi z. Bekim Sulejmani, një punëtor shkencor universitar dhe aktivist i mirënjohur.

Në fund, Kreu i BFI dhe mysafirët u nderuan me mirënjohje të ndërsjella, në shenjë respekti dhe mirënjohjeje për veprimtarinë në institucionet gjegjëse, thuhet në njoftimin e BFI.

IMAMI I BERLINIT NË BFI



Më 15 gusht, 2022, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, në prezencë të Drejtorit të Mërgatës dr. Selver Xhemaili priti hoxhën Remzi Xhaferi, Imam në Xhaminë e Berlinit (Gjermani), thuhet në njoftimin e BFI.

Qendra Islame në kryeqytetin gjerman

me dekada i organizon bashkatdhetarët tanë. Aktivitetet e saj tashmë janë transferuar në ndërtesë të re, pronë e vetë Qendrës, me kushte jashtëzakonisht të mira.

Remzi Xhaferi që 17 vjet u shërben besimtarëve tanë nga të gjitha trojet shqiptare dhe me përgjegjësi të madhe kryen amanetin e besuar.

Reis'ul-Ulemaja e falënderoi për kontributin që i jep xhematit në Perëndim, si dhe në vendlindje. Njëherësh, mysafirët iu premtua se Kryesia e BFI do ta vizitojë së shpejti këtë xhemat dhe se institucioni fetar islam BFI e RMV do të jetë gjithmonë në përkrahje të tyre, kurdo që e do nevoja. Zoti i bekoftë, thuhet në njoftimin e BFI.

PRITJE PËR HFZ. MAHIR EF. ZEQRIN

Më 4 gusht, 2022, Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, me një konsideratë të veçantë priti aktivistin e madh të jetës fetare islame në Vjenë të Austrisë, imamin e mirënjohur dhe lexuesin e mirëfilltë të Kuranit famëlartë, h. hfz. Mahir ef. Zeqirin nga fshati Tenovë i Tetovës, i cili tërë jetën ia kushtoi shpjegimit të Islamit në xhamitë e Austrisë, ku është mësimdhënës i lëndës fetare në shkollat e Vjenës, ushtrues i detyrave të ndryshme udhëheqëse në Unionin e Bashkësive Islame në Austri (ALKIG) etj., thuhet në njoftimin e BFI.

Aktualisht, përveç detyrës së mësimdhënës në shkolla, ushtron detyrën e imamit në Spitalin e Përgjithshëm të Vjenës. Reis'ul-Ulemaja e vlerësoi si aktivist shembullor të BFI të RMV në Austri dhe në shenjë respekti i ndau mirënjohje për kontributin e tij të madh në ngritjen e im-



stitucioneve fetare-arsimore atje.

Në prezencë të dr. Selver Xhemailit, Drejtor për Mërgatë në Rijasetin e BFI, Reis'ul-Ulemaja dhe mysafiri i çmuar bi-

seduan për rrjedhat fetare në Austri dhe në Evropë, dhe për përvojat e tij në Përndim me mbi 30 vjet eksperiencë, thuhet në njoftimin e BFI.

TAKOHEN DY AKTIVISTË TË MIRËNJOHUR

Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, priti në vizitë z. Vullnet Pishtarin, aktivist i mirënjohur nga Shqipëria - aktiv në të gjitha trojet shqiptare dhe në Përndim dhe h. Llukman Lamallar, aktivist i mirënjohur i jetës fetare dhe kombëtare në Qendrën Bulle, Friburg (Fri-

bourg) të Zvicrës, dikur dhe kryetar i saj.

Reis'ul-Ulemaja i uroi për sukseset dhe për kontributin që japin edhe në BFI të RMV dhe u shpjegoi për ecuritë dhe rrjedhat e BFI, si dhe sfidat e kohës, thuhet në njoftimin e BFI. (10.08.2022)

DR. RESHAT IBISHI VIZITON BFI-në



Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, priti në selinë e Rijasetit të BFI-së Kryetarin e BFI të Italisë dhe Imamin e Xhamisë në Casaloldo dr. Reshat Ibi-

shin gjatë vizitës së tij në BFI të RMV, thuhet në njoftimin e BFI.

Në këtë takim u bisedua për rrjedhat fetare islame në Itali dhe më gjerë. Qendra Islame në Casaloldo llogaritet si më e

zhvilluara dhe më e organizuara në Itali. Bashkësia Fetare Islame e RMV qëndron fuqishëm në përkrahje të gjithë besimtarëve dhe bashkatdhetarëve tanë në Itali, thuhet në njoftimin e BFI. (9.08.2022)

ÇMOHET KONTRIBUTI I XHAMISË NË ASOLO

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 17 gusht, 2022, priti delegacionin e xhamisë "As-Culturale Most-ilPonte" në Asolo (Itali), në përberje: Imam Emro Ajdaroski, Kryetar Mukrem Sejdiu, anëtar i Kryesisë dhe Sekretar Axhija Selimi, Arkëtar Fejsal Seferi, Kryetar i Këshillit Nexhat Hoxha, thuhet në njoftimin e BFI.

Këtë pritje kreu i BFI e bëri i shoqëruar nga dr. Selver Xhemaili, Drejtor i Mërgatës.

Gjatë takimit Reis'ul-Ulemaja falënderoi mysafirët për vizitën dhe për kontributin e dhënë në organizimin e jetës fetare në Itali, e në veçanti kontributin e vazhdueshëm me vite të tëra për BFI e RMV dhe institucionet e saj fetare-arsimore.

Po ashtu, u bisedua për aktivitetin e kësaj qendre, si dhe për sukseset e mëdha të saj. Kjo qendër tashmë është pronë e besimtarëve dhe me kushte të mira për kultivimin e vlerave fetare dhe tradicionale.

Kryetari i Qendrës Islame i ndau një mirënjohje kreut të BFI për përkrahjen ndaj besimtarëve të kësaj qendre të njohur, ndërsa edhe Kryetari i BFI mysafirëve u ndau mirënjohje për kontributin dhe aktivitetin e tyre në Itali. Ai po ashtu u premtoi se BFI gjithmonë do të jetë pranë besimtarëve tanë kurdo që e do nevoja. Zoti i bekoftë – thuhet në njoftimin e BFI.



NJË DELEGACION NGA TROISDORFI QËNDEI NË BFI



Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, priti në Rijaset Kryetarin e xhamisë "Ebu Hanife" në Troisdorf të Gjermanisë h. Mahir Mustafën, i shoqëruar nga hoxhë Omer Arslani, imam në Gjermani, haxhi Xhelal Dalipin dhe z. Daut Demirin, thuhet në njoftimin e BFI.

Mysafirët informuan kreun e BFI në detaje për xhaminë e re në Troisdorf dhe i dorëzuan ftesën për hapjen solemne më 24.09.2022. Nga ana e tij, Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, u premtoi se BFI e RMV do të marrë pjesë në këtë ngjarje të rëndësishme dhe historike për besimtarët e këtij

vendi. Ai po ashtu u uroi suksese të gjithëve në punën e tyre dhe u dëshiroi shëndet të mirë. Haxhi Mahiri, bashkë me shoqëruesit e tij, njihen si aktivistë të mirënjohur në mërgim në shërbim të Islamit dhe të kombit. Zoti i bekoftë, thuhet në njoftimin e BFI.

(9.08.2022)

NGA "UNITETI" NË BFI



Më 4 gusht, 2022, në vizitë të BFI të RMV ishin haxhi Muhamer Baftijari, Kryetar i qendrës islame "Uniteti" në Lucernë (Lucerne/Luzern) të Zvicrës, bashkë me h. Xhumali Muharremin dhe h. Besir Hajdarin, të cilët u pritën nga Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, thuhet në njoftimin e BFI.

Haxhi Muhameri njihet si një aktivist

i mirënjohur dhe kontribues në zhvillimin e vlerave fetare dhe kombëtare në Zvicër dhe në vendlindje. Andaj, për këtë arsye, Reis'ul-Ulemaja i ndau një mirënjohje qendrës islame "Uniteti", për kontributin e dhënë në Fitra, Zeqatë dhe donacione të tjera.

Po ashtu, ai falënderoi edhe haxhi Besirin dhe haxhi Muharremin për angazhimet e tyre fetare e kombëtare kurdo që e

ka lyp nevoja.

U bisedua edhe për angazhimet e përbashkëta në të ardhmen.

Në takim Kryetari i BFI, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, u shoqërua nga dr. Selver Xhemaili, Drejtor për Marrëdhënie me Mërgatën. Delegacioni nga Zvicra u udhëhoq nga Myftiu i Gostivarit, h. Sabahudin ef. Zendeli. Zoti i bekoftë, thuhet në njoftimin e BFI.

RIJAD EF. ALIU VIZITOI REIS'UL-ULEMANË



Një vizitë e këndshme dhe e rëndësishme e hoxhës së mirënjohur në Evropë, në veçanti në Qendrën Islame Shqiptare në Gjenevë të Zvicrës, h. Rijad ef. Aliu, në BFI, thuhet në njoftimin e BFI.

Ai u prit nga Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, në Rijaset.

Kryetari i BFI e falënderoi mysafirin e çmuar për vizitën e bërë, për pritjen e

bukur që i bënë me rastin e vizitës së Xhamisë së Gjenevës, në veçanti për kontributin që jep hoxhë Rijad ef. Aliu kudo që ka vepruar, në veçanti tani ku vepron aktualisht.

Me Rijad ef. Aliun Reis'ul-Ulemaja plot katër vjet ka mësuar bashkë, në një mësonjëtoje, në Medresenë Isa Beu në Shkup – Reis'ul-Ulemaja në detyrën e shenjtë të mësimdhënësit, ndërsa Rijad

ef. Aliu si nxënës.

Mu për këtë ai sot ishte krenar për sukseset e tij.

Në pritjen që organizoi Reis'ul-Ulemaja u shoqërua nga z. Mustafa Dauti, shok gjenerate me mysafirin.

Zoti e bekoftë hoxhën e nderuar dhe xhematin e tij të vyeshëm në Gjenevë të Zvicrës, thuhet në njoftimin e BFI. (10.08.2022)

NË PROMOVIMIN E POLICËVE TË RINJ



Sot pranova ftesën që të jem i pranishëm në ceremoninë zyrtare të promovimit të nëpunësve të rinj policorë-gjenerata 2021/2022, ku ishte i pranishëm edhe kreu më i lartë i Shtetit, thuhet në njoftimin e Myftiut të Myftinisë së Shkupit dr. Qenan ef. Ismaili.

Shpreh urimet e mia të përzemërta në emër të Bashkësisë Fetare Islame gjeneratës më të re të 590 nëpunësve të Policisë, të cilët e përfunduan trajnimin njëvjeçar në Qendrën për Trajnim të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

I bëj lutje Zotit Fuqplotë që me dinjitetin dhe integritetin e tyre personal t'i kryejnë detyrat e tyre, gjithmonë duke qenë në dispozicion të qytetarëve dhe për nevojat e tyre, thuhet në njoftimin e Myftiut të Myftinisë së Shkupit. (20.08.2022)

MAGJISTRON NË JORDANI HAFËZ EVZAL SINANI

Gostivarit i shtohet edhe një magjistër në shkencat islame: hafëz Evzal Sinani nga Çeprani mbron me sukses temën e masterit "Qëndrimi i kuranistëve ndaj komentimit dhe interpretimit të ajeteve të legjislacionit në Kuranin fisnik", thuhet në raportin e TV Globit-Gostivar të datës 20 gusht, 2022.

Të enjten që lamë pas (18 gusht), në hapësirat e Fakultetit të Sheriatit, Katedra e Studimeve Bashkëkohore Islame pranë Universitetit Jordanian në Amman të Jordanisë, hafëz Evzal Sinani i dha fund masterit para Komisionit shkencor në përbërje të prof. dr. Behxhet Habashneh - mentor, prof. dr. Azmi Taha, prof. dr. Jahja Xhelal dhe prof. dr. Alaudidin Adewij - anëtarë.

Komisioni shkencor e ka vlerësuar lart temën e punuar, duke dhënë udhëzimin për botimin e saj në gjuhën angleze

dhe në gjuhën arabe, që është vlerësimi më i lartë i mundshëm, përfundon raporti i TV Globit-Gostivar.

Lajmi i mbrojtjes së temës së masterit nga hafëz Evzal ef. Sinani më gëzoi pa masë, ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, Kryetar i BFI të RMV.

Hafëz Evzalin e kam pasur Shef Kabineti një kohë. Me këtë ai edhe një herë dëshmoi talentin, aftësinë, punën dhe rrugëtimin e aftësimin të tij shkencor në sferën e studimeve islame dhe më gjerë, ka thënë ai.

Mr. Evzal ef. Sinani tashmë është një personalitet i njohur në sferën islame me vlerat e jashtëzakonshme, si i urtë, i matur, orator, njohës i shumë gjuhëve dhe tani edhe studiues i njohur i vlerave islame.

Shpreh urime të përzemërta, duke iu lutur të Madhit Zot që t'i japë shëndet,



jetë të gjatë dhe suksese të reja, thuhet në njoftimin e Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

Në emër të Myftinisë së BFI-Gostivar, Myftiut të saj h. Sabahudin ef. Zendeli dhe mbarë besimtarëve të vendit tonë, hfz. mr. Evzal ef. Sinanit i dëshirojmë suksese të mëtejme, shëndet dhe arritje edhe më të mëdha në lëmin shkencor, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Gostivarit të datës 21 gusht, 2022.

SHITJA E XHAMISË PËR XHAMI



European Council for Fatwa and Research (Këshilli Evropian për Fetva dhe Gjurmime) ka marrë këtë pyetje: Ju drejtohem juve që të na sqaroni se a lejohet të shitet xhamia? Ne kemi blerë një objekt, pastaj atë objekt e shndërruam në xhami, ku caktuam një hapësirë për mësimin e gjuhës arabe dhe mësimin e Kuranit. PAGESA U BË NGA DONACIONE TË BAMIRËSVE.

Por, pas pak vitesh u shtua numri i xhematit dhe xhamia nuk kishte kapacitet që ta absorbojë gjithë xhematin. Për këtë shkak, ne blemë një objekt më të madh.

Pyetja jonë është se a lejohet që ta shesim xhaminë e parë? Po ashtu, a lejohet që personi i cili do ta blejë, ta shndërronjë atë objekt xhamie në lokal për tregti, për banim, për shkollë, apo për ndonjë veprimtari tjetër? A lejohet që paratë që do të merren nga shitja e këtij objekti që shërbeu për xhami, të destinohen për të hapur shkollë në kuadër të xhamisë së re?

Fetvaja (2/33) nga European Council for Fatwa and Research (Këshilli Evropian për Fetva dhe Gjurmime): Në parim, xhamia kur blihet apo kur ndërtohet, e merr statusin e vakëfit, me çka del prej pronësisë së atyre që e kanë ndërtuar - qoftë atë ta ketë ndërtuar një person, apo një grup. Kjo, ngase Allahu i Madhërisëm ka thënë: **“Dhe (mua më shpallet) se vërtet xhamitë janë (vende të) veçanta për ta adhuruar Allahun...”** [E]

Xhinn: 18]

Disa juristë islamë e kanë lejuar shitjen e xhamisë, apo ndërrimin e lokalit me ndonjë tjetër - nëse nuk mund të jetë në shërbim dhe nuk mund të shfrytëzohet për atë për çka është ndërtuar, apo nëse në shitjen e saj ka ndonjë dobi të qartë dhe evidente, apo duhet të rrenohet për t'u zgjeruar, apo duhet të transferohet nga vendi ku është, apo paratë nga shitja e saj duhet të destinohen për një xhami më të madhe se ajo, apo për t'u evituar përçarja e myslimanëve duke u ndarë në dy xhami, pa pasur nevojë.

Është transmetuar se Omer ibn el-Hattabi, Allahu qoftë i kënaqur me të, i ka shkruar Sa'edit, posa i ka erdhur lajmi se është shpuar muri i Bejtul-malit (Arkës së shtetit) (që të grabitet) në Kufë, që ta transferojë xhaminë e cila është në tregun e Kufës, pas Bejtul malit, dhe ta pozicionojë Bejtul malin në anën e kibles (drejtimit kah Qabeja) së xhamisë, pasi ende ka njerëz që falen në xhami.

Ky veprim i Omerit argumentoi se lejohet të bëhet transferimi i xhamisë në një vend tjetër, për interesin e Bejtul malit. Atëherë, edhe më e arsyeshme është që të lejohet shitja e xhamisë dhe të destinohen mjetet përkatëse për një xhami tjetër më të madhe.

Është përcjellë prej Imam Ahmedit se ka thënë: “Nëse xhamia është e ngushtë dhe nuk ka kapacitet për ta nxënë xhe-

matin që falet në atë xhami, nuk ka pengesë që të transferohet në një hapësirë më të gjërë.”

Ndërkaq, kur është pyetur Imam Ahmedit për një xhami e cila është boshasitur, ka thënë: “Mendimi ynë është që ajo xhami të shitet dhe ato mjete të destinohen për një xhami tjetër, të cilën do ta ndërtojnë.”

Shejhul Islam Ibn Tejmije ka komentuar në lidhje me mendimin e Imam Ahmedit si vijon: “Nuk ka dyshim se ajo që ka thënë Imam Ahmedit flet se lejohet që xhamia të ndërrohet, për një interes, edhe nëse mund të shfrytëzohet, ngase shërbimi që ofron xhamia tjetër, është më i plotë.”

Bazuar në sa u tha më parë, themi se lejohet që ju ta shisni xhaminë e vjetër dhe mjetet e marra nga shitja e saj t'i destinoni për xhaminë e re.

Nuk ka pengesë që blerësi i xhamisë së vjetër atë hapësirë ta shndërronjë në shkollë, apo në lokal për tregti të lejuar.

Me rëndësi është që të gjitha mjetet e marra nga shitja e xhamisë së vjetër të destinohen për ndërtimin e xhamisë së re, si dhe për hapësira në kuadër të xhamisë, që janë të domosdoshme për myslimanët e qytetit përkatës, si: klasa për mësim të leximit të Kuranit, etj. (24.07.2022)

**Përktheu prej arabishtes:
Bashkim Aliu**

ARSIMIMI ISLAM I FEMRAVE NË MYFTININË E KËRÇOVËS (1995-2022)

Shkruan: Mr. Imer ef. Jusufi



Kur vendosa ta bëj publike këtë kontribut modest, së pari mendova ku t'ia nisi dhe si t'i qasem çështjes së pozitës së femrës në shoqëri, në përgjithësi, e veçanërisht femrës me përkatësi fetare islame – myslimane.

Meqë është shkruar dhe po shkruhet dhe flitet në vazhdimësi se femrën e ka shtyp dhe nuk e ka lënë të përparojë feja islame, këtë hyrje po e filloj me disa ajete kuranore që na bëjnë me dije se feja islame ia jep të drejtën femrës në përgjithësi, e sidomos asaj myslimane, njëlloj - sa ia ka dhënë mashkullit (burrit), duke e kursyer femrën nga obligimet të cilat ajo nuk mund t'i bart, sepse ajo është Nënë.

Sa për orientim, do të sjellim disa ajete nga Kurani qerim e ndonjë hadith të Muhamedit (a. s.), pa u zgjeruar, duke u hapu rrugën të interesuarve, të vazhdojnë sipas potencialit personal.

Allahu i plotfuqishëm në ajetin 13 të sures Huxhurat thotë:

يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِنَّا خَلَقْنَاكُمْ مِنْ ذَكَرٍ وَأُنْثَىٰ وَجَعَلْنَاكُمْ شُعُوبًا وَقَبَائِلَ لِتَعَارَفُوا ۗ إِنَّ أَكْرَمَكُمْ عِنْدَ اللَّهِ أَتْقَاكُمْ ۗ إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ خَبِيرٌ {13}

“O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vetë, e s'ka dyshim se tek Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (nga të këqijat); e Allahu është shumë

i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë.” (Huxhurat: 13)[1]

Ndërsa në ajetin 195 të sures Ali Imran thotë:

فَأَسْتَجَابَ لَهُمْ رَبُّهُمْ أَنِّي لَا أُضِيعُ عَمَلَ عَابِدٍ مِّنْكُمْ مِّنْ ذَكَرٍ أَوْ أُنْثَىٰ ۖ بَعْضُكُمْ مِنْ بَعْضٍ ۗ

“Zoti i tyre iu përgjigj lutjes së tyre (e tha): Unë nuk ia humb mundin asnjërit prej jush, mashkull qoftë apo femër...” (Ali Imran: 195)

Edhe në ajetin 35 të sures Ahzab, Allahu (xh. sh.) më gjerësisht na tregon se mashkulli dhe femra kanë të drejta të barabarta, me shprehjen:

إِنَّ الْمُسْلِمِينَ وَالْمُسْلِمَاتِ وَالْمُؤْمِنِينَ وَالْمُؤْمِنَاتِ وَالْقَانِتِينَ وَالْقَانِتَاتِ وَالصَّادِقِينَ وَالصَّادِقَاتِ وَالصَّابِرِينَ وَالصَّابِرَاتِ وَالْخَاشِعِينَ وَالْخَاشِعَاتِ وَالْمُتَصَدِّقِينَ وَالْمُتَصَدِّقَاتِ وَالصَّانِعِينَ وَالصَّانِعَاتِ وَالْحَافِظِينَ فُرُوجَهُمْ وَالْحَافِظَاتِ وَالذَّاكِرِينَ اللَّهَ كَثِيرًا وَالذَّاكِرَاتِ أَعَدَّ اللَّهُ لَهُمْ مَغْفِرَةً وَأَجْرًا عَظِيمًا {35}

“Nuk ka dyshim se për myslimanët e myslimanet, për besimtarët e besimtare, adhuresit e adhureset, të sinqertët e të sinqertat, durimtarët e durimtare, të përvuajturit e të përvuajturat, sadakadhënësit e sadakadhënëset, agjëruesit e agjërueset, ruajtësit e nderit e ruajtëset e nderit, shumë përmendësit e Allahut e shumë përmendëset e Allahut, Allahu ka përgatitur falje (mëkatesh) dhe shpërblim të madh.” (Ahzab: 35)

Se feja islame nuk e shtyp femrën në përgjithësi, as femrën myslimane, na tre-

gojnë shumë ajete kuranore. Madje, një sure e tërë e mban emrin **“Nisa”** (Gratë).

Islami e çliroi femrën nga të gjitha format e robërisë. Allahu (xh. sh.) thotë: يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ وَخَلَقَ مِنْهَا زَوْجَهَا وَبَثَّ مِنْهُمَا رِجَالًا كَثِيرًا وَنِسَاءً ۗ وَاتَّقُوا اللَّهَ الَّذِي تَسَاءَلُونَ بِهِ وَالْأَرْحَامَ ۗ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلَيْكُمْ رَقِيبًا {1}

“O ju njerëz! Kini frikë Zotin tuaj, që ju ka krijuar prej një vetje (njeriu) dhe nga ajo krijoji palën (shoqen) e saj, e prej atyre dyve u shtuan burra shumë e gra. Dhe, kini frikë Allahun, me emrin e të Cilit përbetoheni. Ruajeni farefisn (akraballëkun), se Allahu është mbikëqyrës mbi ju.” (Nisa: 1)

Muhamedi (a. s.) në Haxhin Lamtumurës, mes tjerash, tha: **“Do t'u porosita të keni parasysh të drejtat e gruas dhe frikën ndaj Zotit. Ju i morët gratë si amanet nga Zoti. Nderin dhe pastërtinë shpirtërore i pranuat në emër të Allahut (xh. sh.). Ju keni të drejta ndaj grave, por edhe ato kanë të drejta ndaj jush.”**

Nëse i referohemi literatures islame, duke filluar nga Kurani fisnik, haditheve dhe porosive të Muhamedit (a. s.) dhe pastaj edhe jetës së sahabëve etj., do ta kemi edhe më të qartë se çfarë pozite të lartë i ka dhënë feja islame femrës në përgjithësi... Si model kemi Hz. Aishen (r. a.), bashkëshorten e Muhamedit (a. s.). Kemi shembullin e veprimit të

Ervas bint Abdul Muattalib-it, e cila i tha hz. Omerit (r. a.): *‘Nuk ke të drejtë t’ua marrësh të drejtat grave që ua ka dhënë Allahu (xh. sh.)!’* dhe këtë e bëri përpara opinionit, në xhami.

Për të kuptuar më mirë se feja islame nuk është ajo që e shtyp femrën, mjafton që shkurtazi të merret në shqyrtim pozita e saj në periudha të ndryshme historike. Fjala vjen:

- 1- Pozita e gruas te grekët e vjetër,
- 2- Pozita e gruas te romakët,
- 3- Pozita e gruas te hindusët e vjetër,
- 4- Pozita e gruas te të krishterët dhe
- 5- Pozita e gruas tek arabët para ardhjes së Kuranit.

Kërçova, me një pozitë gjeografike specifike, mund të ketë edhe specifika sa i përket arsimimit islam të femrës. Kjo varet edhe nga faktorë të tjerë që ndikojnë në shkallën e ngritjes arsimore, profesionale, kulturore, sociale etj., por duhet theksuar se arsimimi islam në rajonin e Myftinisë së Kërçovës, për të cilën e kemi fjalën konkretisht në këtë kontribut, nuk është shumë larg nga myftinitë tjera të rajonit.

Në fund të shekullit 19 dhe në fillim të shekullit 20 Kërçova kishte dijetarë islamë (ulema) në zë edhe jashtë territorit të vet, të cilët sipas sistemit shkollor të sulltanatit osman sot mund të radhiten me thirrje akademike magjistra të shkencave në drejtësi, gjuhësi, matematikë etj.

Kujtojeni hfz. Hamdi ef. Mehmetin dhe Beqir ef. Abdullahun [2], myderrizë në medresetë: Hamidije, Haxhi Ali aga - në Kërçovë; Hajdar Kadi, Is'hakije, Haxhi Mehmet bej - në Manastir; në medresenë e Korçës, të Margëlliçit e gjetiu, myfti e kadi në Kërçovë, Manisa etj. [3]

Në Kërçovë edhe aktualisht kujtohen me respekt ulematë e brezit të fundit të shkolluar në *Daru-l-mual-limin* të Manastirit dhe të Stambollit, si mulla Qamili nga Prapadishti, mulla Ali Dila e mulla Jaho Emmini nga Zajazi, mulla Azemi nga Tuhini, mulla Zada (Sadudin) Xhambazi nga Cërvica, Ahmet ef. Kalessi nga Serbica, mulla Qerimi nga Mafmutajt, etj. [4] Brezi pas tyre vazhdoi me hfz. Qeshaf Ahmedin e hfz. Nazim Xhambazin [5] e deri të hafëzja Herolinda Emmini. [6]

Pa u lëshuar në hollësi, në vazhdim do të paraqes disa shënime biografike për femrat me arsimim islam të përgjithshëm [7] dhe me arsimim profesional [8] në Myftininë e Kërçovës, duke filluar nga viti 1995-2022, sipas librit am-zë* [9] të Medresesë Isa Beu në Shkup

1. Qanije Beshiri-Aliu

Lindur më 25.12.1973 në fshatin Dervenik, komuna e Manastirit. Shkollën fillore “Sande Shterjoski” e

ka kryer në Kërçovë. Mësimet e para të arsimit islam i ka nxënë në mejtepin e Xhamisë Sulltan Pajazit në Kërçovë, te mualimi mr. Imer ef. Jusufi. Në vitin shkollor 1988/89 regjistrohet si nxënëse e shkollës së mesme komunale “Mirko Mileski” (tash “Drita”). Pas një viti çregjistrohet nga kjo shkollë dhe në vitin shkollor 1989/1990 regjistrohet në Medresenë Isa Beu në Shkup - me korrespondencë dhe në vitin 1995 përfundon me sukses, kështu që bëhet medresantja e parë shqiptare në Myftininë e Kërçovës. Deri më tash, në mënyrë vullnetare, sipas nevojës, i shërben popullatës islame në rajonin e këtij xhemati.

2. Senada Osmani

Lindur në Kërçovë. Mësimet e para të arsimit islam i ka nxënë në mejtepin e Teqesë Çulu Baba në Kërçovë, te mualimi Reshat Bulbul. Pas përfundimit të shkollës fillore nëntëvjeçare, ka vazhduar në medresen e mesme “Isa Beu”, në Paralelen e Vajzave në Shkup. Maturën e kreu më 30.05.2018. Pas mbarimit të Medresesë, ka vazhduar studimet në Universitetin Erciyes-Fakulteti i Shkencave Islame në Turqi.

Gjatë kësaj periudhe ka dhënë kontributin e saj si vaize (ligjëruese shëtitëse) nëpër xhemate të Myftinisë së Kërçovës.

3. Elma Osmanoska

E lindur në Kërçovë. Mësimet e para të arsimit islam i ka nxënë në mejtepin e Teqesë Çulu Baba në Kërçovë, te mualimi Reshat Bulbul. Vetëm një vit ka qenë në shkollën e mesme të Medresesë Isa Beu, në Paralelen e Vajzave në Shkup. Më pas e lëshon këtë shkollë, për të vazhduar në Turqi...

4. Herolinda Emmini

E lindur në Kërçovë më 26.11.1994. Shkollën fillore e ka kryer në "Rexhë Rushit Zajazi", në vendlindjen e saj në Zajaz. Vitin e parë shkollor e ka regjistruar në shkollën e mesme komunale "Mirko Mileski" në Kërçovë dhe ishte nxënëse me korrespondencë në Medresenë Isa Beu në Shkup.

Vitin e dytë kalon në Medresenë Isa Beu në Gostivar, në Paralelen e Vajzave. Këtu diplomon me sukses të shkëlqyeshëm dhe zgjidhet nxënësjja më e mirë e gjeneratës. Më 10.02.2012 fillon hifzin (nxënien përmendsh) e Kuranit famëlarë dhe e përfundon më 31.01.2013. Hifzin e kryen te hfz. Arif Emmini [10], kurse provimin e ka dhënë para Komisionit të përbërë nga: hfz. dr. Abaz Jahja, hfz. prof. Shaqir Fetahu dhe hfz. prof. Shafi Osmani, me vlerësimin 5 (shkëlqyeshëm).

Studimet i ka vazhduar në Turqi, në Bursa Uludağ Üniversitesi İlahiyat

Fakültesi (Fakulteti i Teologjisë). Njëkohësisht, edhe Fakultetin e Ekonomisë në Anadolu Universiteti në Eskişehir dhe Ekonomi dhe Financa Islame në Geneva Bussines School në Gjenevë, Zvicër. Masterin e kreu në *Bankim dhe Financa* në Anadolu Universiteti-Eskişehir.

Tani i ndjek studimet master në drejtimin Psikologji pranë International Vision University në Gostivar. Ka qenë e punësuar si ligjëruese në Myftininë e Kërçovës.

5. Fatime Mislimi

E lindur në Kërçovë në vitin 1996, nga fshati Mahmutaj. Shkollën fillore (deri në klasën e 4) e kryen në fshat, më pas vijon mësimin në shkollën e qytetit në Kërçovë deri në klasën e nëntë.

Shkollimin e mesëm e ka kryer në shkollën e mesme islame Medreseja Isa Beu-Paralelja e Vajzave në Gostivar. Pas përfundimit të shkollimit të mesëm vazhdon studimet në Jordani, Amman, për mësim të gjuhës arabe në kolegjin " كلية المجتمع العربي - Arab Community College".

Pas qëndrimit njëvjeçar, u kthye në vendlindje, ku vazhdoi studimet në Universitetin e Tetovës, në Fakultetin Filozofik - drejtimi Psikologji.

Gjatë kohës së studimeve fitoi bursën e programit Erasmus+ për vazhdimin e një semestri në Turqi.

Në vitin 2021 - 2022 përfundon studimet e Psikologjisë me sukses. Ka vazhduar studimet e magjistraturës. Nuk ka marrëdhënie të rregullt pune.

6. Hyrije Mislimi

E lindur në vitin 2000 në Kërçovë. Shkollën fillore e kreu në Kërçovë. Shkollimin e mesme e vazhdoi në Turqi, ku kreu shkollën e mesme në Edirne Akmercan Anadolu İmam Hatip Lisesi në vitin 2015/2020 dhe në të njëjtën kohë e mësoi edhe gjuhën turke. Tani është duke vazhduar studimet, po ashtu në Turqi, në degën Disenj Grafik.

7. Medina Nur

Lindur në fshatin Lisiçan. Më 1.09.2015 ka filluar mësimet e mesme në Medresenë Isa Beu, në Paralelen e Vajzave Shkup. Pas mbarimit të vitit parë, vazhdoi në Paralelen e Vajzave në Gostivar dhe më 30.05.2019 ka përfunduar maturën në Medresenë Isa Beu në Shkup.

8. Melika Nur

Lindur në fshatin Lisiçan. Më 1.09.2014 ka filluar mësimet e mesme në Medresenë Isa Beu, në Paralelen e Vajzave në Gostivar dhe më 30.05.2018 i ka përfunduar ato. Nuk ka vazhduar me studime.

9. Vjollca Lutfiu

Lindur në fshatin Zhubrinë, komuna e Kërçovës. Më 1.09.2017 ka filluar mësimin në shkollën e mesme Medr-

eseja Isa Beu në Shkup, pastaj, prej vitit të dytë, vazhdoi mësimet e rregullta në Paralelen e Vajzave në Gostivar dhe më 30.05.2021 ka diplomuar. Nuk ka marrëdhënie të rregullt pune.

10. Mirjeta Bilalli

E lindur në Kërçovë më 29.07.1997. Njohuritë themelore të arsimit islam i ka mësuar në Shqipëri, në një konvikt privat për mësimin e leximit të Kuranit, gjatë tre muajve të pushimit veror. Shkollën fillore e ka kryer në “Sande Shterjoski” në Kërçovë në vitin 2011/2012. Shkollën e ka vazhduar në Medresenë Isa Beu, Paralelja e Vajzave në Gostivar. Ka diplomuar në vitin 2015/2016. Studimet i ka vazhduar në Universitetin Shtetëror të Tetovës, dega Akushere/Mami dhe me sukses ka diplomuar në vitin 2021. Nuk ka marrëdhënie të rregullt pune.

11. Beslinda Memedi

Lindur më 24.04.2001 në fshatin Drogomisht i Vogël, komuna e Kërçovës. Njohuritë themelore të arsimit islam i ka mësuar në mejtepin e xhamisë së fshatit Drogomishti Vogël, te mualimi, tash rahmetli, Ali ef. Ademi. Shkollën fillore e ka kryer në “Rexhë Rushit Zajazi” në Zajaz. Më pas, në vitin shkollor 2016/2017 është regjistruar si nxënëse e rregullt në Medresenë Isa Beu, Paralelja e Vajzave në Tetovë dhe në vitin shkollor 2019/2020 ka diplomuar. Studimet i vazhdoi në Universitetin Ballkanik - Gjuhë angleze dhe pas një viti vazhdon në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup, me korrespondencë.

12. Afije Jusufi

Lindur më 22.12.2002 në fshatin Radushë, komuna e Sarajit-Shkup, me

	Emri, mbiemri	Ditëlindja	Adresa	Gjendja mësimore
1	Bukurije Hajrullai	2.12.1978	Kërçovë	Vetëm e regjistruar
2	Gjulhima Shabanovska	1.12.1979	Kërçovë	Vetëm e regjistruar
3	Nedima Ismailoska	5.11.1979	Kërçovë	6 provime të vitit të parë
4	Ertines Ejupovska	26.11.1980	Kërçovë	Vetëm e regjistruar
5	Anika Elezovska	21.07.1982	Kërçovë	Vetëm e regjistruar
6	Emina Klenceska	7.02.1984	Kërçovë	Vetëm e regjistruar
7	Pajtime Bajrami	24.08.1990	Kërçovë	Vetëm vitin e parë
8	Urija Asanoska	15.12.1990	Kërçovë	Vetëm e regjistruar
9	Vullnete Rushiti	8.06.1990	Kërçovë	Në vitin e dytë
10	Kimete Rushiti	27.01.1993	Kërçovë	Në vitin e parë
11	Emel Alija	24.06.1994	Kërçovë	Vetëm e regjistruar
12	Herolinda Emmini	26.11.1994	Kërçovë	7 provime të vitit parë
13	Shadija Bamtashoska	29.10.1995	Kërçovë	Vitin e dytë
14	Qanie Beshiri- Aliu	25.12.1973	Kërçovë	E diplomuar

Nxënëset e regjistruara në Paralelen e Vajzave në Shkup në vitet shkollore 2006/07 - 2021/22

	Emri, mbiemri	Datëlindja	Adresa	Gjendja mësimore
1	Senada Osmanoska	18.02.2022	Kërçovë	Diplomoi 2017/18
2	Elma Osmanoska		Kërçovë	Çregjistrohet vitin e dytë

Nxënëset e regjistruara në Paralelen e Vajzave në Gostivar në vitet 2008/09 - 2021/22

	Emri, mbiemri	Datëlindja	Adresa	Gjendja mësimore
1.	Vlora Limani	15.05.1994	Kërçovë	U çregjistrua vitin e katërt
2.	Herolinda Emmini	26.11.1994	Kërçovë	E diplomuar
3.	Fatime Mislimoska	16.02.1996	Kërçovë	E diplomuar
4.	Mirjeta Bilalli	29.07.1997	Kërçovë	E diplomuar

vendbanim në qytetin e Kërçovës. Shkollën fillore e ka kryer në “Sande Shterjoski” të Kërçovës, në vitin shkollor 2016/2017. Mësimet e para të arsimit islam i ka nxënë në mejtepin e Xhamisë Sulltan Pajazit në Kërçovë, te mualimi mr. Imer ef. Jusufi. Më pas, në vitin shkollor 2017/2018 u regjistrua, e rregullt, në Medresenë Isa Beu, Paralelja e Vajzave në Tetovë dhe në vitin shkollor 2020/21 ka diplomuar. Studimet i ka vazhduar në Universitetin Shtetëror të Tetovës - Fakulteti Filologjik, dega Gjuhë dhe letërsi maqedonase në vitin shkollor 2021/2022.

Në fund të këtij kontributi po sjellim një pasqyrë për arsimimin islam të femrës në Myftininë e Kërçovës për periudhën 1995-2022.

5.	Blerta Abazi	31.05.1998	Kërçovë	E diplomuar
6.	Melika Nur	7.02.2000	Kërçovë	E diplomuar
7.	Medina Nur	15.07.2001	Kërçovë	E diplomuar
8.	Melek Demiroska	8.10.2001	Kërçovë	Çregjistrohet vitin e katërt
9.	Zelije Muhadinoska	31.12.2002	Kërçovë	Çregjistrohet vitin e parë
10.	Vjollca Lutfiu	9.06.2002	Kërçovë	E diplomuar
11.	Haxhera Mustafaoska	3.08.2006	Kërçovë	Çregjistrohet vitin e parë
12.	Vejke Sula	16.12.2006	Kërçovë	Çregjistrohet vitin e parë

Nxënëset e regjistruara në Paralelen e Vajzave Tetovë në vitet shkollore 2004/05 - 2021/22

	Emri, mbiemri	Datëlindja	Adresa	Gjendja mësimore
1	Beslinda Memedi	24.04.2001	Kërçovë	Diplomoi 2019/20
2	Afije Jusufi	22.12.2002	Kërçovë	Diplomoi 2020/21

I vetëdijshëm për mangësitë e mundshme, më mban shpresa se dashamirët e arsimimit islam – sidomos të femrës kërçovare, do të tregojnë mirësi dhe do të ndihmojnë për plotësimin e këtyre të dhënave dhe për korrigjime eventuale. Çdo sugjerim mirëpritet me kënaqësi.

(Autori është Imam i Xhamisë Sulltan Pajazit në Kërçovë)

[1] Përktimi i ajeteve të Kuranit është marrë nga Kurani, përktim me komentim, h. Sherif Ahmeti.

[2] Sadik Mehmeti, Hatixhe Ahmed, Ramadan Shkodra, *Dijetarë shqiptarë në Perandorinë Osmane 1880-1912*, sipas dokumenteve të Meshihatit të Lartë Osman, Prishtinë, 2021.

[3] Sadik Mehmeti, Hatixhe Ahmed, Ramadan Shkodra, *Dijetarë shqiptarë në Perandorinë Osmane 1880-1912*, sipas dokumenteve të Meshihatit të Lartë Osman, Prishtinë, 2021.

[4] Fetë Mehdiu, *Kërçova në histori*, Kërçovë, 2013, fq. 128-136.

[5] Fetë Mehdiu, *Hafëzët tanë gjatë historisë*, leksikon (shekulli XVIII-2010), Prishtinë, 2010.

[6] Fetë Mehdiu, *Kërçova në histori*, Kërçovë, 2013, fq. 198.

[7] Arsimim të përgjithshëm në Myftininë e Kërçovës kanë pasur edhe ndërmjet dy luftërave botërore.

[8] Nga viti 1995 e këndej femra myslimane, këtu, ka në dispozicion dokument-diplomë për kualifikim të mesëm, që mund të kryejë detyra të caktuara nga fusha islame, sipas natyrës e rregulloreve të Myftinisë.

[9] Me këtë rast falënderoj shërbimin përkatës të Medresesë Isa Beu në Shkup për ofrimin e dokumentacionit të nevojshëm. Po ashtu, kam kënaqësinë të falënderoj sinqerisht akad. dr. Fetë Mehdiun për sugjerime të çmueshme dhe ndihmesë të pakursyer për këtë kontribut.

[10] Fetë Mehdiu, *Kërçova në histori*, Kërçovë, 2013, fq. 198.

MARTESA ME NJË GRUA ËSHTË ESENCA E FESË HYJNORE

Nga dr. Rijad Imeri

Monogamia (martesa me një grua) është esencë në fenë hyjnore dhe në natyrën njerëzore, kurse poligamia (martesa me më shumë se një grua) është përjashtim, të cilin e përkufizojnë shkaqe dhe rrethana të ndryshme!

Zoti i madhëruar kur e krijoi Ademin (a. s.) nuk ia krijoi katër gra, por vetëm një; ajo ishte Hava, bashkë me të cilën të gjenin prehjen e shpirtit dhe të epshit.

Mirëpo, martesa nuk përkufizohet vetëm brenda kësaj, por është një varg përgjegjësish dhe standardesh, të cilat bien mbi supet e bashkëshortit dhe për të cilat, nëse nuk i përmbush, ka përgjegjësi para ligjit në këtë botë dhe para Zotit në botën tjetër.

Promovimi i poligamisë në një shoqëri ku bashkëshorti çalon në përmbushjen e obligimeve dhe kërkesave themelore martesore të një gruaje të vetme, është thirrje për më shumë pa-

drejtësi dhe për më shumë kaos në jetën shoqërore.

Arsyetimi i poligamisë me përhapjen e prostitucionit, ndërkaq, është një arsye-tim i mangët për dy shkaqe esenciale:

1. Prostitucioni nuk është i përhapur vetëm te personat e martuar me një grua, por e shumta e tij bëhet te personat që nuk janë fare të martuar;

2. Prostitucioni ndodh edhe në ato vende ku praktikohet poligamia dhe mjafton t'u hedhësh një sy vendeve si Dubai, që fatkeqësisht është bërë epiqendër e prostitucionit. Në historinë paraislame, ndërkaq, njeriu gjen imazhe të ndryshme të prostitucionit, edhe pse poligamia ishte e përhapur dhe e papërkufizuar.

Pra, prostitucioni është pasojë e rënies së moralit të individit në veçanti dhe të shoqërisë në përgjithësi, është dobësi e besimit të njeriut dhe humbje e ndjenjës së mbikëqyrjes hyjnore. Për këtë Muhamedi (a. s.) tha që "zinaqari në momentet



që bën zina nuk është besimtar".

Prostitucioni sot promovohet publikisht, fuqishëm dhe vazhdimisht dhe mbrohet e mbështetet ligjërisht, siç është manifestimi i egoizmit të individit dhe ikja nga përgjegjësitë e jetës.

Pra, janë një varg dobësish shpirtërore, morale dhe njerëzore për të thënë që poligamia nuk është zgjidhje e as opsion i duhur që të promovohet në kohën tonë.

Megjithatë, poligamia është zgjidhje e një sërë problemeve shoqërore nëse vepron dhe trajtohet sipas bazave islame, duke mos harruar se bazamenti mbetet monogamia nëse ajo është e shëndoshë dhe nëse ajo që do të ndërtohet mbi të do të jetë e shëndoshë. Nëse njeriu ka dështuar në të, poligamia do t'ia zgjerojë parametrat e dështimeve atij. (26.07.2022/në bashkëpunim)

DY FJALË RRETH LIBRIT "LIDERSHIPI I SUKSESSHËM"

Sot vështirë gjen prezantime të forta me qasje islame ndaj fenomeneve të ndryshme, apo të tillë që referencë kanë të kaluarën, siç janë, për shembull, veprat e mendjendriturit Nexhat Ibrahim "Islami në trojet iliro-shqiptare gjatë shekujve", "Premisat për dialog ndërmjet Oksidentit dhe Orientit" etj.

Në këtë vazhde, libri "Lidershipi i suksesshëm", i autorit të njohur shqiptar prof. dr. Hajredin Hoxha, në brendësinë e tij mbarat ide të thella, ndikuese dhe të forta në analizë dhe në prezantim.


Hajredin Hoxha është një autor objektiv, një shkrimtar i vërtetë, i cili para se ta shkruajë këtë vepër, ka konsultuar një sërë librash në këtë fushë. I pajisur me njohuri enciklopedike rreth temës, ai i ka balancuar njohuritë e veta midis sasisë dhe cilësisë dhe është zhytur në sasinë e njohurive nëpërmjet analizës, diskutimit dhe balancimit, duke arritur të shkarkojë gjithë atë bagazh të madh informacionesh të shkëlqyeshme aty ku duhet përmes sintezës, shqyrtimit dhe analizës së thellë.

Ky libër vjen në kohën më të mirë për

realitetet bashkëkohore; nuk është si pasojë e vakumit, por si rrjedhojë e një realiteti. Autori ka parashtruar një sërë pyetjesh të thella. Ato mund të duken si përfaqësore në shikim të parë, mirëpo nuk është kështu, sepse përmes atyre pyetjeve ne e kuptojmë thelbin, peshën dhe përgjegjësinë e librit.

Shpeshherë rastisim të lexojmë tekste prej autorëve që kanë shkruar pa qenë e nevojshme që tema e tillë të diskutohet dhe në librat e llojit të tillë nuk gjejmë freski. Disa, ndërkaq, shkruajnë vetëm sa për të na treguar se janë gjallë, për të mos humbur vëmendjen e audiencës, edhe pse në botimet e tyre nuk gjejmë as freski e as ngrohësi; madje, analiza shkencore dhe aspekti metodologjik as që vërehet aty.

Prof. dr. Hajredin Hoxha, ndërkaq, këtë e ka bërë në mënyrë të mrekullueshme, duke bërë ndërthurje midis freskisë së mendimit, vërtetësisë së fjalës, thellësisë së idesë dhe largpamësisë së vet. Përmes këtij libri ai dëshiron të rrit ndërgjegjësimin e të rinjve, të teologëve,



të drejtuesve të institucioneve fetare, kulturore etj. dhe jo vetëm të injektojë informacione të reja në mendjet e tyre.

Libri "Lidershipi i suksesshëm" synon të arrijë te të gjithë studentët, të studiuesit e fesë, teologët dhe te të gjithë lexuesit pa përjashtim. I lutemi Allahut të Madhërishtëm që autorit t'i dhurojë shëndet, mirësi dhe lumturi në jetë, për shkak se na ka ofruar një libër të suksesshëm për atë që ai e quan "lidership i suksesshëm". (16.08.2022)

Përgatiti: Nehat Ismaili, Zvicër/në bashkëpunim

QAFJA E SULLTANËS BASHKON HOXHALLARËT



Më 19 gusht, 2022, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i priu delegacionit të BFI në përbërje të disa myftinjve dhe drejtorëve të sektorëve të Rijasetit të BFI, me të cilët bashkërisht falën namazin e xhumasë në xhaminë e bukur të fshatit Qafë (Kërçovë-Gostivar), për një rast gëzimi dhe me ftesë të familjes Bajrami, përkatësisht të teologut të mirënjohur h. Rushan ef. Bajrami nga Padalishti i Gostivarit, me rastin e lindjes së nipit të tij Arenit, thuhet në njoftimin e BFI.

Dëshira e teologut të mirënjohur, që vepron në Vjenë të Austrisë, ishte që këtë mikpritje ta bëjë në fshatin legjendar Qafë, i njohur për heroizmin e vajzës 16-

vjeçare Sulltana, e cila në vitin 1913 mbrojti pragun e shtëpisë kundër hordive pushtuese serbe. Shumë bashkëshatarë të saj po ashtu luftuan për fe e atdhe, për iman e vatan.

Delegacioni i Bashkësisë Fetare Islame vizitoi varrezat ku pushojnë eshtrat e Sulltanës heroike dhe bashkë bënë lutje për shpirtin e saj dhe të gjithë atyre që kanë rënë në altarin e lirisë. Në këtë ditë xhumaje ftesës iu përgjig një numër i madh i myftinjve, drejtorëve, referentëve dhe shumë mysafirëve të tjerë.

Të gjithë uruan h. Rushan ef. Bajramin për nipin dhe falënderuan për respektin e treguar me mikpritjen e tij bujare.

H. Rushan ef. Bajrami është ndër të

parët që kontribuoi në organizimin e jetës fetare islame dhe kombëtare në Austri, si dhe në bashkëpunimin e tij institucional me dekada me BFI të RMV. Ai një kohë ka qenë imam, ndërsa aktualisht është mësimdhënës i lëndës fetare islame në shkollë në Austri.

Falënderime për të gjithë, veçanërisht për h. Qufli ef. Osmanin, përgjegjës për Administratë në BFI, si i afërt i familjes Bajrami, për ndihmesën që dha gjatë organizimit të këtij tubimi.

Peizazhi dhe bukuria e fshatit heroik të Qafës, të ndërthurura me mikpritjen bujare, bënë që delegacioni i BFI të kalojë çaste të bukura. Zoti e bekoftë familjen Bajrami, ndërsa nipit i urojmë jetë të gjatë, thuhet në njoftimin e BFI.

HAPET XHAMIA E RE NË FSHATIN ÇAJLANË

Më 29 korrik, 2022, në prag të vitit të ri 1444 Hixhri, u realizua ceremonia e hapjes zyrtare të xhamisë së re në fshatin Çajlanë (Shkup), thuhet në njoftimin e BFI.

Në këtë solemnitë pjesëmarrës ishin Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu me bashkëpunëtorë, Myftiu i Shkupit dr. Qenan ef. Ismaili, Kryetari i Kuvendit të BFI h. Fejzal ef. Kadriu, Kryetari i OH 'Hilal' mr. Fadil ef. Ramadani, hfz. Xhemal ef. Nuhiju, veprimtarë, donatorë dhe përkrahës të jetës fetare islame, imami i fshatit Çajlanë Hasip ef. Saqipi, si dhe mysafirë të ndryshëm nga vendi e jashtë.

Në këtë solemnitë mirënjohje morën: Kryetari i Këshillit inicues për ndërtimin e Xhamisë, z. Rufan ef. Sheipi, si dhe h. Abedin Aliu në shenjë falënderimi për



përkrahjen financiare në ndërtimin e Xhamisë.

Allahu (xh. sh.) i shpërbleftë të gjithë ata që kanë kontribuar në ndërtimin e Xhamisë me mirësitë e Tij të panumërta,

thuhet në njoftimin e BFI.

Hapja e xhamisë së re në fshatin Çajlanë u transmetua drejtpërdrejt, në kohë reale, në platformat elektronike të BFI të RMV.

NIÇPURI BËHET ME XHAMI TË RE

Më 12 gusht, 2022, u bë hapja solemne e xhamisë së re në fshatin Niçpur, komuna Mavrovë-Rostushë, thuhet në njoftimin e BFI.

Në këtë solemnitet madhështor, me prezencën e tyre banorët e fshatit Niçpur i nderuan hoxhallarë të rrethit të Gostivarit, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu me bashkëpunëtorë, Myftiu i Gostivarit h. Sabahudin ef. Zendeli me bashkëpunëtorë, Myftiu i Tetovës prof. dr. Qani ef. Nesimi me bashkëpunëtorë, drejtorët e Sektorëve pranë Rijasetit të BFI, Kryetari i Komunës z. Medat Kurtoski me bashkëpunëtorë, myftinj të Myftinive të tjera të BFI, si dhe shumë mysafirë të tjerë.

Hapjen e këtij solemniteti e bëri mr. Eljesa ef. Asani, Drejtor i Institutit të Hifzit dhe Bukurleximit të Kur'anit Famëlartë "Hfz. Hasan ef. Zendeli" në Gostivar dhe Drejtor i Sektorit për Kulturë pranë Myftinisë së Gostivarit, i cili me zërin e tij të bukur lexoi ajete nga Kurani i madhërishtëm.

Në aktin solemn të hapjes së këtij bejtullahu fjalë përshëndetëse pati kryetari i Këshillit iniciativ z. Sejdi Pajaziti, i cili pasi i përshëndeti të pranishmit tregoi raportin e ndërtimit dhe raportin financiar për aktivitetet rreth xhamisë së re.

Në vazhdim fjalë përshëndetëse mbajti Myftiu i Myftinisë së BFI-Gostivar, h. Sabahudin ef. Zendeli, si përgjegjës për organizimin e jetës fetare në këtë anë. Ai theksoi se kërkesat e mëherëshme të banorëve të kësaj ane e kanë sjellë punën deri këtu, që sot e përjetë, kështu të lumtur e të bashkuar, të jemi prezent për të bërë këtë kurorëzim, filluar nga Reis'ul-Ulemaja kur ishte Myftiu i Gostivarit në vitin 2019.

Por, ajo që e dalloi këtë akt solemn të inaugurimit ishte vetë prezenca e kreut më të lartë të BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i cili theksoi se ky vend dhe e tërë Reka e Epërme po kompletohen me xhami. Të gjitha këto janë një kon-



tribut për pasurimin e multietnicitetit dhe të multikonfesionalitetit, si dhe dëshmi për besimin dhe vullnetin e pashterur të besimtarëve islamë të kësaj ane.

Duanë e këtij akti solemn e bëri prof. Sherif ef. Dehari, kurse hytben e xhumasë e mbajti Myftiu i Myftinisë së Tetovës, prof. dr. Qani ef. Nesimi. Në namazin e xhumasë priu vetë Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

Banorët për këtë rast kishin përgatitur edhe një drekë solemne për të gjithë të ftuarit.

Theksojmë edhe një herë se kjo xhami, si pronë, është vakëf në emër të BFI dhe se numëron 8.750 m2 tokë. Objekti i xhamisë së vjetër është djegur nga okupatorët e asaj kohe në vitin 1912-13, duke lënë vetëm gërmadhat e gurëve, thuhet në njoftimin e BFI.


NDIKIMI RUS NË MJEDISET E PËRZIERA ETNIKE

Rusia e "nxeh tenxheren" saherë që sheh mundësi për të influencuar në Evropën Juglindore, ku GRU dhe agjencitë e dezinformimit rus gjithkund shfrytëzojnë trazirat. Të gjitha ngjarjet e fundit gjeopolitike po ndodhin në kohën e riorganizimit të ri të kufijve të rajonit, njëqind vite pas ndryshimeve dramatike në Evropë dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Shkruan: Dr. Selim Ibraimi

Rusia kërkon në mënyrë aktive mundësi për të zgjeruar ndikimin e saj në Ballkan, për të projektuar "fuqi të butë" në Evropën Perëndimore dhe për të komplikuar formulimin e politikës transatlantike drejt rajonit. "Fuqia e butë" ruse preferohet nga "mendjet dhe zemrat" e popullatës lokale në shtetet e rajonit të Ballkanit. "Fuqia e butë" e Rusisë është në procesin e rindërtimit si armë vdekjeprurëse në të gjithë botën për të promovuar interesat ruse në kohën e pandemisë globale dhe shfrytëzimit të gjendjes për të diskredituar Perëndimin dhe angazhimin konkret të BE-së në Ballkanin Perëndimor.

Rusia e "nxeh tenxheren" saherë që sheh mundësi për të influencuar në Evropën Juglindore, ku GRU dhe agjencitë e dezinformimit rus gjithkund shfrytëzojnë trazirat. Të gjitha ngjarjet e fundit gjeopolitike po ndodhin në kohën e riorganizimit të ri të kufijve të rajonit, njëqind vite pas ndryshimeve dramatike në Evropë dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare. Moska iu afrohet qëllimeve në disa mënyra dhe në tri zona Rusia ka ndikuar për më shumë se një dekadë: në Bosnjën serbe, në Kosovë sidomos në pjesën veriore dhe në Maqedoninë e Veriut nga viti 2008 e deri në formimin e qeverisë së re të drejtuar nga lideri Zoran Zaev në vitin 2017, ku aksionet ruse ishin shumëdimensionale për të parandaluar formimin e qeverisë së re dhe bllokimin e rrugës euroatlantike të vendit. Politika e jashtme e Rusisë, e quajtur ndryshe si "Near Abroad Policy", e drejtuar nga Putini dhe Medvedevi që nga viti 2000, ka konsistuar në ndërhyrjet ruse në shtetet me për-



Dokumenti 5. Spiunë rusë në Mal të Zi, të përfshirë në grusht shtetin e vitit 2016. Shih dosjen "Bellingcat", 2017. <https://www.bellingcat.com/news/uk-andeurope/2017/03/25/balkan-gambit-part-2-montenegro-zugzwang/>

bërje të përzier etnike. Raporti i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) thotë se kohët e fundit Rusia po ndjek në mënyrë aktive "Doktrinën Gerasimov", duke u mbështetur në "përdorimin e gjerë të masave politike,

ekonomike, informuese, humanitare dhe masave të tjera joushtarake, të zbatuara me keqpërdorimin e potencialit protektues të popullsisë..." për të arritur qëllimet politike dhe strategjike. Sipas studimit, ndikimi rus në Kosovë është të

POPULLSIA SIPAS PROVINCAVE OSMANE (1911)

Popullsia e Evropës osmane, 1911, sipas provincave dhe fesë (miletit):

Edreneja (Edirne) 760.000 myslimanë, 396.000 grekë, 171.000 bullgarë - 1.427.000 gjithsej.

Kosova 959.000 myslimanë, 93.000 grekë, 531.000 bullgarë - 1.603.000 gjithsej.

Selaniku 605.000 myslimanë, 398.000 grekë, 271.000 bullgarë - 1.348.000 gjithsej.

Janina 245.000 myslimanë, 311.000 grekë - 561.000 gjithsej.

Manastiri 456.000 myslimanë, 350.000 grekë, 246.000 bullgarë - 1.065.000 gjithsej.

Shkodra 218.000 myslimanë, 11.000 grekë - 340.000 gjithsej.

Këto të dhëna i ka paraqitur autori Justin (Xhastin) McCarthy në librin "Vdekje dhe dëbim. Spastrimi etnik i myslimanëve osmanë, 1821-1922" (fq.167).

Nga ajo që ka ndodhur më vonë, në



dy Luftërat Ballkanike dhe në Luftën e Parë Botërore, shihet se ndaj myslimanëve osmanë ka ndodhur një gjenocid i përmasave të përbindshme. Rasti i Kosovës duket indikativ: në vitin 1911 ka pasur 1.603.000 banorë, ndërsa në vitin

2011 - 1.739.825. Pra, në vitin 2011 ka pasur banorë sa në vitin 1911. /22.07.2022/

Përgatiti: Milazim Krasniqi/në bashkëpunim

fitojë fuqi Serbia. Në këtë linjë mediat amerikane raportojnë se që nga viti 2009 influenza ruse në ish-IRJM, tani Maqedonia e Veriut, ka qenë në rritje, me tendencën për të ndryshuar vendimet e qeverisë, të liderëve dhe partive politike duke nxitur tensione ndëretnike. Perandoria bankare e Kremlinit në Mal të Zi, në Serbi dhe ish-IRJM, nëpërmes metodave grabitqare kishte arritur të mbajë gjallë monedhat vendore dhe të depërtojë në bizneset që kryesisht kanë qenë të drejtuara nga zyrtarë të mbështetur nga Putini dhe rrethi i tij i ngushtë. Ende nuk është e qartë se sa thellë kishte hyrë politika ruse në IRJM, tek partitë politike maqedonase dhe ato shqiptare.

KISHA ORTODOKSE RUSE SI MJET NDIKIMI

Në të njëjtën linjë, përtej mediave, Kremlini e shfrytëzon Kishën Ortodokse Ruse (KOR) si një mjet ndikimi në vendet me popullsi të konsiderueshme ortodokse dhe pa dyshim këtu hyjnë edhe Maqedonia e Veriut. Moska vendosi tregimin e vëllazërimit sllav dhe të Krishterimit, për të forcuar marrëdhëniet me udhëheqësit politikë dhe aktorët tjerë në Bosnjë, Bullgari, Greqi, Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi dhe Serbi.

Patriku ortodoks rus Kiril shërben si një lidhje apo një kryesore midis kishës së tij dhe homologëve të saj në gjithë Ballkanin, përfshi grupet e pakicave ortodokse në vendet jo-të krishtera, si Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina dhe Kosova, përkatësisht pakicën serbe aty.

Pelegrinazhet fetare dhe kulturore, shumë të përfolura të Putinit në Malin Athos në Greqi në vitin 2005 dhe në 2016, ishin përpjekjet më të dukshme të Ruses. Vizitat e Putinit e shfaqën në mënyrë të dukshme përpjekjen e Ruses për të promovuar veten si një përfutuese të ortodoksisë së ditëve moderne. Në Ballkan, Rusia përpiket të forcojë lidhjet me zyrtarët lokalë ortodoksë për të përhapur mendimin e publikut dhe të elitës në favor të saj. Sidoqoftë, është e paqartë se si ndarja e fundit midis Kishës Ortodokse Ruse (KOR) dhe Kishës Ortodokse të Ukrainës (KOU) do të ndikojë në “fuqinë e butë” ruse në rajon, veçanërisht tani që Patrikana e Kostandinopojës ka anuar kah KOU, duke i dhënë asaj pavarësi dhe duke ndikuar që KOR shpejt të shkapulet nga Patrikana më e madhe. Patriku i Kishës Ortodokse Serbe (KOS) duket se po e mbështet Moskën, duke e cilësuar vendimin e Patrikanës së Kostandinopojës si katastrofë. Kishat tjera ortodokse

në Ballkan duken të kapura në mes nga politika e Kremlinit dhe me kalimin e kohës, kjo ndarje mund të dobësojë ndikimin rus dhe “fuqinë e butë” në rajon. Oligarkët dhe oficerët e sigurimit rus me lidhje të ngushta me KOR-in dhe elementë të ekstremit të djathtë në shoqërinë ruse kontribuojnë në mënyrë aktive në përpjekjet e “fuqisë së butë” në Ballkan, duke i siguruar Moskës një maskë besueshmërie nëse një operacion klandestin nuk ka sukses. Shembulli më i spikatur është ai i Konstantin Malofeev-it, “Fondacioni i Bamirësisë së Madhe-Shën Basili i Madh”, që është fondacioni më i madh ortodoks në Rusi, me një buxhet të raportuar prej mbi 40 milionë dollarë. Përveç punës së tij brenda Rusesë, fondacioni mbështet fushatat e vlerave familjare në gjithë Evropën Lindore. Malofeev dhe fondacioni e tij duket se janë kanalet kryesore për afrimin e Rusesë ndaj grupeve konservatore ortodokse në Ballkan. Për shembull, ishte ai pas përpjekjeve për të sjellë “Ritualin e Zjarrit të Shenjtë”, i cili simbolizon ringjalljen e Krishtit për të krishterët ortodoksë nga “Kisha e Varrit të Shenjtë” në Jerusalem në Serbi për herë të parë për Pashkën Ortodokse në vitin 2015 dhe duke vazhduar në Bosnjë dhe Kroaci për të nxitur trazira ndërfaqetare dhe etnike. Madje në mjediset e përziera, mediat “Ruski Ekspres”, një media me qendër në Beograd, e koordinoi dhe e transmetoi ceremoninë drejtpërdrejt në rusisht dhe serbisht. Gjithashtu, ai mbështeti financiarisht ndërtimin e një monumenti të Nikollës II në Republikën Serbe të Bosnjës, si një shenjë e miqësisë midis Rusesë dhe popullatës serbe të Bosnjës. Mendimi politik dhe radikal i Malofeev-it është shumë antiame- rikan dhe antiperëndimor dhe, siç dihet, promovon ide pansllave dhe shtyn përpara në opinionin publik teori të ndryshme konspiracioni, të cilat i dëmtojnë politikanët e moderuar në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Fondacioni gjithashtu ka botuar artikuj që justifikojnë “rolin civilizues” të Rusesë në Ballkan. Institucionet e Malofeev-it janë komponentët kryesorë të “fuqisë së butë” ruse për botën ortodokse. Të sanksionuar nga SHBA për përfshirjen e tij në aneksimin e Krimesë dhe përpjekjet për të destabilizuar Ukrainën Lindore, Malofeevi lehtësoi qasje shtesë të nacionalistëve ortodoksë dhe atyre rusë ndaj homologëve të ekstremit të djathtë në Evropën Juglindore. Gjashtë muaj pas aneksimit të Krimesë, ai raportohet se ka koordinuar hyrjen e më shumë se njëqind kozakëve në Republikën Serbe të Bosnjës, e

parë si një shenjë e përkrahjes ruse për presidentin Dodik në prag të zgjedhjeve të tetorit të vitit 2014 në Bosnjë. Malofeev dhe Leonid Reshetnikov, një ish-zyrtar i lartë rus i Shërbimit të Inteligjencës së Jashtme (SVR), dyshohet se ishin të përfshirë në fazat fillestare të planifikimit të përpjekjes për grusht shtet në Malit të Zi në vitin 2016 - një komplot i organizuar nga elementët që punojnë nën GRU (Shërbimi Inteligjent Ushtarak Rus) për të destabilizuar Malin e Zi.

Kur bëhet fjalë për lidhjet e sigurisë, përpjekjet e Moskës në Ballkan përqendrohen kryesisht në Serbi, një vend pa aspirata zyrtare për t'u anëtarësuar në NATO dhe në Republikën Serbe të Bosnjës. Për më shumë, Serbia u bë vëzhguese e aleancës ushtarake të Organizatës së Traktatit të Sigurisë Kolektive (CSTO) në vitin 2013 dhe merr pjesë në stërvitjet ushtarake me Rusinë dhe partnerët e tjerë të CSTO-së, ku si më e fundit ishte stërvitja ushtarake ruse “Vëllazëria Sllave” në korrik të vitit 2018. Në këtë drejtim Moska dhe Beogradi kanë nënshkruar marrëveshje të ndihmës teknike ushtarake në vitin 2016 për të mbështetur programin e modernizimit ushtarak të Serbisë. Rusia ka siguruar trajnime të stilit ushtarak për rininë serbe në Serbi dhe atë ruse, me sa duket si pjesë e një përpjekjeje për të promovuar lidhje kulturore dhe solidaritet ushtarako-patriotik në rajon. Rusia gjithashtu themeloi një Qendër të Reagimit Humanitar (QRH) në qytetin serb Nish, për të rritur “aftësinë rajonale për t’u përgjigjur emergjencave të motit dhe fatkeqësive të tjera natyrore”. Ndërsa titullohet si një bazë e gjerë e pajisjeve të reagimit ndaj situatave emergjente humanitare, të cilën disa shtete perëndimore e kanë akuzuar si objekt i mbledhjes së inteligjencës ushtarake. Pavarësisht se cili është qëllimi i tij, objekti i jep Moskës një platformë të mundshme operative për të monitoruar ngjarjet në Serbi dhe në Ballkan dhe të ndërhyjë në punët e brendshme të shteteve ballkanike.

Ndihma e sigurisë e Moskës për Republikën Serbe po rritet, megjithëse në kundërshtim me frymën e Marrëveshjeve të Dejtonit, e cila ndalon një ushtri të pavarur serbe të Bosnjës. Dodik i tejkalon këto kufizime duke rritur aftësinë ushtarake të forcave të pavarura policore të njësisë federative. Republika Serbe ka blerë të paktën 2.500 pushkë automatike nga Serbia për policinë e saj. Zyrtarët bohunjakë në Sarajevë pretendojnë se Dodik po përpiket të sigurojë raketa anti-

115-та седница на Владата

Седницата се одржа на: 15.01.2019 - 12:30

Соопштение за јавноста: <https://vlada.mk/node/16401>

Записник од седница: Преземи (488.29 KB)

Точка 120

Владата го разгледа новиот текст на Информацијата за имотот од стечајна постапка од должникот Шик Јелак АД Тетово, со Предлог-одлука за давање согласност со подавка преку нотар да се понуди дел од деловен простор на другите сосопственици на деловниот простор, ја усвои Информацијата и ја донесе Одлуката за давање согласност со подавка преку нотар да се понуди дел од деловен простор на другите сосопственици на деловниот простор, во предложениот текст.

Dokumenti 6. Vendimi qeveritar për Shik-Jellakun”. Portalb. 2020. www.portalb.mk. 10 3. Accessed 11 6, 2020. <https://portalb.mk/711599-nga-vmro-dpmne-protestuan-sot-ne-shkup-mickovski-permend-rastin-e-shik-jellak-netetove/>.

avionë të prodhimt rus **Igla 1-V**, që mund të montohen në helikopterë ushtarakë. Njësitë zyrtare të policisë nga Republika Serbe kanë marrë trajnime ruse që nga viti 2016 në Banjallukë dhe Moskë, përfshi trajnime kundër terrorizmit dhe kontrollit të turmës. Zyrtarët në Sarajevë janë të shqetësuar se Rusia mund të përpiket të krijojë një qendër tjetër operative të ngjashme me objektin e saj në Nish. Përtej policisë, një njësi paraushtarake serbe e Bosnjës, e quajtur si “Serbi i Nderuar”, raportohet se ka marrë trajnime specifike në objektin inteligjent rus në Nish. Një organizatë tjetër, “Veteranët e Republikës Serbe”, dyshohet se ka zhvilluar trajnime të stilit ushtarak gjithashtu. Ajo ka lidhje me “Komitetin Ndërkombëtar Këshillimor të Organizatave të Oficerëve Rezervë” (IAC), një organizatë ombrellë me origjinë ruse e themeluar në vitin 2010, e cila lidh oficerë ushtarakë rezervë dhe në pension nga ish-Bashkimi Sovjetik, Evropa Lindore, Republika Serbe e Bosnjës, si dhe nga disa vende të Lindjes së Mesme, me qëllim të promovimit të vlerave konservatore. Nuk duhet të mbivlerësohet ndikimi i këtyre grupeve paramilitare të ekstremit të djathtë, ose lidhjeve të tyre me qeverinë ruse. Sidoqoftë, ato përbëjnë mjete të gatshme që Rusia i ka përdorur për të ngjallur ndjenjën anti-BE dhe anti-NATO dhe të punojë kundër aktorëve po-

litikë pro BE-së. Moska mbështet organizatë të ngjashme nacionaliste, parti politike dhe personalitete politike si në Maqedoninë e Veriut partinë politike “Maqedonia e Bashkuar” - një parti simotër e partisë ruse e quajtur “Rusia e Bashkuar”, e drejtuar nga nacionalistët maqedonas si Stefan Vllahov Micov dhe Janko Baçev. Gjithashtu, nëpërmjet palëve të treta, oligarkët rajonalë të mbështetur nga Kremlini, bëjnë blerjen e pasurisë publike në shtetet e Ballkanit Perëndimor. Rasti konkret qëndron me shitjen e një prone publike në Maqedoninë e Veriut, përkatësisht në qytetin e Tetovës. Ndërmarrja publike e quajtur “Shik-Jellak”, bashkë me pronën tokësore, sipas dokumenteve të publikuara i është shitur oligarkut malazez me emrin Miodrag Daka Davidoviq, i cili mbështetet nga Moska dhe qarqet financiare ruse. Vendimi qeveritar është aprovuar në kohën e qeverisjes së kryeministrit Zoran Zaev në mandatin e parë dhe e miratuar nga Këshilli Komunal i Tetovës nën drejtimin e Teuta Arifit, njëherit zyrtare e lartë e partisë së quajtur Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI).

FORMAT E NDIKIMIT

Forma më vdekjeprurëse për shtetet e brishta të Ballkanit Perëndimor nga ana e Rusesë ka qenë dezinformimi, apo

shfrytëzimi i sulmeve hibride, të lansimit të informatave të rrejshme kundër qeverive pro-perëndimore në Ballkan. Prania e Rusesë në hapësirën e informacionit për Ballkanin Perëndimor është thelbësore për ndikimin e saj rajonal dhe për të përmbytur objektivat e politikës së jashtme ruse në Ballkan.

Veçanërisht në Serbi dhe në hapësirën etnike të quajtur “Serbo-sferë”, mbulimi i politikës së jashtme ruse, përkatësisht angazhimin e saj me Ballkanin është jashtëzakonisht pozitiv. Rusia këtu e portretizon veten si një aleate historike dhe mbrojtëse të sllavëve të jugut.

Në këtë fushë duhet nënvizuar se ka rrugë të financuara dhe të kontrolluara nga shteti rus, të cilat ofrojnë këndvështrimin për çështjet ndërkombëtare dhe çështjet e shquara rajonale, siç është moshmarrëveshja e Kosovës me Serbinë dhe ish-kontesti mes Greqisë dhe ish-IRJM-së, tani e quajtur Maqedonia e Veriut.

Në vitin 2015 agjencia ruse e lajmesh “Sputnik” hapi një shërbim lajmesh në gjuhën serbe. Po ashtu, “Radio Sputnik” është e disponueshme në të gjithë vendin përmes një rrjeti me më shumë se tri dhjetë stacione rajonale. Përmbajtja e tij gjithashtu filtrohet nëpër mediane dhe shkruar lokale dhe on-line. Kjo përfshin portale të njohura, shumë të lidhura me tabloide me qarkullim të lartë, të tilla si “Informet”, “Blic”, “Kurir”, “Večernje

Novosti”, “Rusia Sot” në Shqipëri dhe Radio “B-92”.

Ndikimi i agjencisë “Sputnik” shkon përtej kufijve të Serbisë. Për shembull, gjatë zgjedhjeve të Bosnjës në vitin 2018 “Sputnik” u pozicionua pro Millorad Dodikut. Shërbimi Evropian për Veprim të Jashtëm (EEAS) akuzoi agjencinë për përhapjen e lajmeve të rreme dhe të propagandës.

Përveç “Sputnikut”, pikat e forta të qeverisë ruse arrijnë audiencën lokale përmes platformave të tilla si gazeta dhe faja e internetit “Russia Beyond” (Rusia Përtej), e operuar nga “Rossiya Segodnya”, agjencia shtetërore që e pasoi “RIA Novosti”, e cila transmeton dhe prodhon lajme në disa gjuhë të huaja. Po ashtu, duhet theksuar se media ruse është shumë më pak me ndikim në formimin e tregimeve sesa kronikat e lajmet lokale të mediave serbe apo maqedonase si “Infomax” me qendër në Shkup. Siç pretendon një raport i fundit nga “German-Marshall Fund”, media publike dhe ajo private e kontrolluar, duket se janë promotor më aktivë të ndjenjave pro-Rusi në Serbi dhe në rajon.

Këto përfshijnë tabloidet pro-qeveritare si “Kurir”, “Informer”, “Alo” dhe “Sprski Telegraf”, të cilat hedhin lavde për Rusinë ndërsa kritikojnë BE-në dhe aleancën NATO për politikën e tyre kinse antiserbe. Një rrëfim i zakonshëm, i falsifikuar nga tabloidët gjatë një viti ose më shumë, ka qenë se “lufta kundër Kosovës po afrohet dhe se Serbia është e detyruar ta fitojë atë me ndihmën e Rusisë dhe të armëve ruse”. Ky tregim është përhapur dhe përforcuar në internet nga një rrjet prej më shumë se dyzet portalesh në rrjetet sociale Tuitër (Twitter) dhe Fejsbuk (Facebook). Ekosistemi mediatik në Republikën Serbe funksionon në një mënyrë të ngjashme, duke përfshirë kanalën zyrtar televiziv “RTRS”, “Alternativna Televizija”, agjencia e lajmeve “SRNA”, gazeta “Glas Srpske”, si dhe faqet në internet siç janë “InfoSrpska” dhe në Maqedoninë Veriore “Russia Beyond Makedonija” //mk.rbth.com/. Kurse Instituti Kosovar për Kërkimin e Politikave dhe Zhvillimit (KIPRED) nëpërmes një monitorimi të mediave ruse synon të kundërshtojë dezinformimin që synon Kosovën, përmes monitorimit në baza mujore të mediave të zgjedhura me origjinë nga Rusia, në të dyja gjuhët, anglisht dhe në gjuhën serbe.

PASOJAT E NDIKIMIT RUS NË DHJETËVJEÇARIN E FUNDIT

Pasojat e ndikimit rus nga viti 2008 deri në vitin 2018, në aspektin e zvarritjes së eurointegritimit dhe reformave, ka qenë tepër i madh, me fokus në sferën politike të brendshme dhe të jashtme. Në rastin e Maqedonisë së Veriut, ish-kryeministri Nikolla Gruevski bëri të njohur në shkurt të vitit 2015 se drejtuesi i opozitës Zoran Zaev nga LSDM ka përgatitur grusht shtet, si dhe ka bërë shkelje të Kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Maqedonisë. Një ditë më pas, Ambasada e Federatës Ruse në Shkup në një kumtesë shprehu brengosje për situatën dhe kërkoi të respektohen institucionet dhe ligjet e shtetit. Kumtesa e Federatës Ruse u vlerësua në Shkup si përkrahje ndaj veprimeve të Gruevskit në sferën e diplomacisë së standardeve të dyfishta. Duhet thënë se tronditjet e brendshme politike në Shkup ishin të mirëseardhura për erën putiniste që përfshiu Evropën Lindore dhe Ballkanin në atë kohë. Kjo zvarritje e anëtarësimit në BE të shteteve të Ballkanit gjithashtu ndikoi në uljen e tregtisë së jashtme me BE-në dhe SHBA-në.

Me SHBA-në, sipas Zyrës së Statistike të qeverisë amerikane, shkëmbimi tregtar i Maqedonisë së Veriut për vitin 2014 ishte rreth 121.2 milionë dollarë. Me BE-në, Shkupi rreth 60 për qind të shkëmbimit tregtar e realizon me shtetet anëtare të po këtij unioni. Partneriteti kryesor i këtij shkëmbimi zhvillohet me Gjermaninë, me Serbinë, Greqinë, Bullgarinë, Kroacinë, Bosnjën, Shqipërinë, Holandën, Britaninë e Madhe dhe Turqinë. Rrjedhimisht, ekonomia e Maqedonisë së Veriut është e varur nga BE-ja, sepse investimet janë po nga shtetet e BE-së. Për nga natyra e investimeve në fushën e gazit natyror dhe të minierave Rusia kishte në plan të merrte pjesën më të madhe të tyre. Ndërkaq, zgjerimi dhe antagonizmi rus kishte për qëllim krijimin e “zonave speciale” të influencës dhe dobësimin e strukturave demokratike në Ballkan.

Politika ruse nga viti 2008 kishte për qëllim rritjen e shkallës së nacionalizmit në Ballkanin Perëndimor dhe ky involvim në parim bëhej në sektorin diplomatik-ekonomik, me investitorë të llojit global dhe të rangut më të lehtë, të prezantuar si investitorë lokalë, duke iu dhënë sinjale ekonomike të rrejshme shteteve të rajonit se duhet të fokusohen nga Moska dhe jo nga BE-ja. Në vitin 2001 korporata ruse “Solvay”, e cila zotëron kapital dhe pronësi në dy minierat më të mëdha të Maqedonisë së Veriut “Sasa dhe Buçim” njoftoi se kishte në

plan të investonte deri në 150 milionë euro në hapjen e dy minierave të tjera në Maqedoninë lindore. Gjithashtu, korporata tjetër prestigjioze e industrisë së naftës “Lukoil”, e cila është shtrirë në tërë territorin e shtetit, njoftoi për rritje masovike të investimeve. Gjatë një takimi me ish -kryeministrin Gruevski në Shën Petersburg në vitin 2012, presidenti i kompanisë Vagit Alkeperov njoftoi se kompania e tij ka bërë shtrirje të rëndësishme dhe strategjike në të dy anët e Maqedonisë së Veriut, duke u bërë rivale e investimeve perëndimore në rajon.

SHBA dhe BE gjatë mandatit të presidentit Obama kërkonin një Ballkan stabil dhe politikanë të pakorruptuar, për të përparuar projektet ekonomike dhe reformat strukturore. “Kroacia mund të luajë rol kryesor dhe të bëhet qendër për stabilitetin energjetik të rajonit dhe të Evropës”, tha në Dubrovnik ish-zv.sekretarja e Shtetit Viktoria Nuland në vitin 2015. Po, a do të mundet Maqedonia e Veriut, ashtu njëjtë si Kroacia, të luajë një rol më të rëndësishëm dhe stabilizues në jug të Ballkanit dhe të luftojë korrupsionin në të gjitha nivelet shtetërore? Këto bindje kanë hedhur rrënjët e pabesimit te populli, e cila gjë ëndrrat ose zhgënjendrat evropiane dita-ditës i bën utopi. Vlerat e mirëfillta evropiane kërkojnë të investohet çdo ditë nga pak, dhe të harrohen kontestet dhe ankesat e vjetra, meqë mund të bëhen të përhershme”, tha ish-zëvendës sekretarja Nuland në Dubrovnik. Paralajmërimet amerikane ishin si rezultat i aneksimit rus të Krimesë, ku qeveria e SHBA-ve vazhdimisht ka përsëritur qëndrimin se do të angazhohet për një rajon të qëndrueshëm dhe të integruar në BE dhe në NATO. Respektimi i të drejtave të njeriut, dialogu ndëretnik, paqja, shtypi i lirë, gjykata të pavarura dhe luftimi i korrupsionit - kanë qenë synimet euroamerikane për më shumë se dy dekada për qeveritë pesimiste dhe ekonomitë e tranzicionit të Ballkanit Perëndimor. Nga ana tjetër, ndërkaq, Federata Ruse duke manipuluar me emocionet e popujve ortodoksë të rajonit, hapur ka mbështetur forcat radikale, të cilat promovojnë pesimizëm kundër BE-së, si dhe përpjekje për rritje të tensioneve ndëretnike. Ripërtëritja dhe qëndrueshmëria afatgjatë e shteteve të Ballkanit, i ka detyruar evropianët dhe amerikanët, por pa anashkaluar edhe rolin ekonomik turk në rajon, që të shtyjnë proceset demokratike në drejtim të konsolidimit të brendshëm etnik dhe demokratik. Korrupsioni, energjia dhe mosmarrëveshjet ndëretnike - kanë qenë




Figura 1. Format dhe fushat e ndikimit rus në Ballkanin Perëndimor. Institute for Security Studies and Development Macedonia, 2017. <http://cssd-ngo.org/lufta-hibride-e-rusise-ne-ballkan/>

një ndër pikat ku amerikanët së bashku me partnerët rajonalë kërkojnë rrugë alternative për një Ballkan stabil, paqësor dhe imun ndaj sulmeve hibride ruse. Prania amerikane në Adriatik lidhet me politikën e zgjerimit rus në Evropë dhe strategjinë kineze të ndërtimit të porteve detare në Kroaci. Fuqizimi amerikan në Ballkan i ka hedhur poshtë zërat e pesimistëve ballkanikë se Uashingtoni është duke e reduktuar prezencën në Evropë dhe në Ballkan.

Nga ana tjetër, Rusia paraqitet si lidere e tradicionalizmit ortodoks. Shoqëritë në Serbi, në Kosovën veriore dhe në Bosnjë e Hercegovinë nuk janë aspak entuziaste kur bëhet fjalë për integrimin evropian. Ata që e konsiderojnë anëtarësimin në BE "një gjë të mirë", në rastin

më të mirë janë një shumicë e vogël, me një pjesë të barabartë ose më të madhe të qytetarëve që e shohin atë si "as të mirë dhe as të keqe".

Në të kundërtën, Rusia gëzon një popullaritet të madh në rajone të caktuara në Ballkanin Perëndimor. Një sondazh i kryer në Serbi nga “Gallupi” në vitin 2018, tregoi se Putini është shumë larg nga çdo lider ndërkombëtar në popullaritet, me 88 për qind të serbët që kanë një qëndrim pozitiv ndaj tij dhe vetëm 12 për qind që kanë një mendim negativ. Të dhënat e sondazhit nga Serbia tregonin se të rinjtë janë mbështetës të një aleance me Moskën, por ende janë të orientuar drejt Perëndimit. Kështu, ata kanë shumë më tepër gjasa të udhëtojnë, të punojnë ose të studiojnë në Evropën Perëndimore

sesa në Rusi. Gjuha ruse dhe kultura populllore kanë tërheqje të kufizuara, megjithatë diplomacia publike dhe nismat e bashkëpunimit kulturor të ndërmarrura ndër vite kanë dhënë efektin e tyre. Gjithashtu, përafrimi i Rusisë me gjuhën serbe dhe në një masë më të vogël me atë maqedonase, ka bërë që nacionalizmi gjuhësor të kultivohet me vite. Moska ka përfituar nga problemet e brendshme në rajon: mosmarrëveshjet nga lufta e viteve ‘90-të, një marrëdhënie dashurie-urrejtje me Perëndimin, institucione dhe media të dobëta, sundimi i ligjit, ekonomitë e dobëta dhe mungesa e transparencës.

Qeveria e atëhershme e Nikolla Gruevskit theksonte se inkuadrimi në BE dhe në NATO është synim strategjik. Ai, duke e shfrytëzuar krizën në eurozonë, në

SHKENCA E LEXIMIT TË KURANIT NDËR SHEKUJ

Çdo njeri që mëson leximin e Kuranit, në fakt mëson njërin prej kirâeteve. Nga analiza e përgjithshme e këtyre leximeve, dijetarët në përgjithësi arrijnë në përfundimin se kirâeti i Imam Asimit është më i thjeshti e më i përshtatshmi - si për arabët, ashtu edhe për joarabët. Shqipëria dhe vendet tjera në Ballkan përfshihen në grupin e vendeve ku lexohet kirâeti i Imam Asimit, të transmetuar nga Hafs.



Shkruan: Hasime Salihu

T'i hedhim një sy historisë, për t'i kuptuar më mirë kirâetet. Kjo shkencë ka një rëndësi të veçantë,

sepse ka nisur që në ditën e parë që i ka zbritur zbulosa peygamberit Muhamed (alejhis-selam) dhe vazhdon ende të transmetohet brez pas brezi, thuajse në të njëjtën mënyrë.

Pejgamberi (alejhis-selam) i lexonte ajetet e zbritura dhe ua mësonte ato sahabëve me shumë kujdes. Ata, më pas, ua mësonin ajetet të tjerëve dhe kështu ka arritur deri në ditët e sotme. Ndër saha-

Ukrainë, problemet e brendshme dhe duke mos gjetur zgjidhje të emrit me palën greke, e ndryshoi kursin dhe strategjinë e lëvizjes, duke i zvogëluar gjasat që vendi të shkonte drejt BE-së. Qeveria e tij kishte preferenca të ndryshme emocionale, politike dhe ekonomike për sa u përket integritetit në BE. Në Shkupin zyrtar, euroskepticizmi zinte vend të konsiderueshëm dhe e gjithë kjo ishte menaxhuar mirë nga rusët. Megjithatë, gjatë qeverisjes së Gruevskit, Maqedonia e Veriut gjendej para një udhëkryqi ashtu siç gjendeshin disa shtete të rajonit. Përkundër gjithë kësaj ndërhyrjeje, varfëria, papunësia dhe tensionet ndëretnike janë një ndër kërcënimet e brendshme, të cilën Rusia e shfrytëzon si dobësi në Ballkan. Ndërsa si kërcënim i jashtëm për shtetet multietnike dhe fetare, mund të konsiderohet fragmentimi identitar i shteteve të rajonit.

Me zvogëlimin e trupave amerikane në Evropë dhe mungesën e demokracisë në vendet e Ballkanit Perëndimor, ndërkaq, forcat inteligjente ruse mund të depërtojnë thellë në shoqëritë e këtyre shteteve. Gjendja në Ballkan për shkak të vazhdimin të fushatës ruse në fillim të vitit 2015 me lajme të rreme dhe ekipe inteligjente, ishte jo e mirë, duke lënë shumë çështje të hapura. Indikatorët rusë të influencës në Ballkan për të rritur euroskepticizmin janë të karakterit provokues, të ndikimit politik, të investimeve në sektorin e minierave, industrinë e nafës dhe mundësisht kthimin e vendit në një poligon energjetik dhe për më shumë manovrimet ruse.

RREZIK PERMANENT PËR DËMTIMIN E PROCESEVE INTEGRUESE

SHBA, OSBE dhe organizatat vëzhguese kanë raportuar se përveç çështjeve të jashtme, rajoni ballafaqohet edhe me një rrezik permanent të dëmtimit të proceseve integruese, duke përmendur projektet qeveritare në mungesë dhe investimet joadekuate në rajonet shumetnike, ku Rusia mund t'i shfrytëzojë si burime krizash për nxitjen e përçarjeve. Përveç këtij fakti, këtu një kërcënim serioz për rajonin paraqitet pasurimi i shpejtë i politikanëve, duke vënë në harresë se për çka janë zgjedhur dhe prolongimet e seancave gjyqësore dhe dënimeve pasuese, për shkak të mos respektimit të ligjeve mbi detyrimet e kërkua. SHBA-të që nga Marrëveshja e Dejtonit, atë të Kumanovës dhe të Ohrit, u përpoqën që t'i ndryshojnë rrjedhat politike dhe ekonomike në zonat e përfshira nga konfliktet etnike. Ndërsa tani, përsëri

në Bosnjë dhe në Maqedoninë e Veriut të gjitha këto marrëveshje janë vënë në rrezik prej politikanëve me tipare oligarkësh demokratikë dhe që krijojnë terren për Rusinë duke harruar ligjin e vetadministrimit lokal, ku përshkruhet zhvillimi komunal paralel. Ndonjëherë edhe vetë qeveritë dhe institucionet shtetërore vendore janë bërë gjeneratorë të zënkave dhe fërkimeve të brendshme etnike. Ballkani për më shumë se një shekull ka qenë fuçia e barutit, ku liderë dhe rryma të caktuara kanë vendosur për ardhmërinë e kombeve. Këtu nuk duhet përfshirë përgjegjësinë e liderëve lokalë, të cilët jo më pak se qeveria qendrore mbajnë përgjegjësi për situatën e sigurisë. Gjetja e liderëve të duhur për zbatimin dhe normalizimin e gjendjeve postkonfliktuale në rajon, është mjaft e rëndësishme për të kundërshtuar aktivitetin rus. Çdo fragmentim dhe 'iluzion' tjetër do të kishte pasoja për demokracinë e brishta, sikurse fati i Evropës Lindore, ku Rusia me lehtësi bën manovra në vakumin e krijuar. Prandaj, ashtu siç thonë diplomatët, liderët duhet t'i kthehen rendit dhe zbatimit të reformave një shekull më parë, shtetet që dolën nga Perandoria Osmane ishin kryesisht të tipit agrar dhe nuk vonoi shumë dhe si rezultat i përlëshjeve politiko-ushtarake, këto shtete ballkanike u zhytën në krizë të thellë ekonomike dhe kështu filluan t'i shtonin lëvizjet për aleanca dhe territore. Sot, kjo paradigmë nuk është larguar nga qeveritë aktuale në Ballkan, ku përmes politikave të dyfishta të anëtarësimit në BE dhe të formimit të unioneve dhe të aleancave përpiqen të aktualizojnë idenë për një Ballkan të ri, me hartë të re. Por, në këtë drejtim duken mjaft të qarta veprimet e disa qeverive, si të Serbisë, në krijimin e aleancave të reja në Ballkan, duke ofruar marrëdhënie speciale me Rusinë dhe Kinën. Bilanci gjeopolitik gjatë fillimit të dekadës së dytë për serbët dhe për maqedonasit ishte se nuk e preferonin shumë BE-në dhe NATO-n. Maqedonia e Veriut me ardhjen e qeverisë së re në vitin 2017 e ndryshoi qasjen dhe shpejt filloi të tërhiqet nga kursi prorusi i instaluar nga qeverisja afatgjate përmes partisë nacionaliste VMRO. Nga pikëpamja gjeopolitike, ky orientim lindor i disa shteteve të Ballkanit, apo i dyfishtë, do të zvogëlonte angazhimin ushtarak dhe diplomatik disavjeçar të amerikanëve për stabilitet afatgjatë të rajonit, si arsye të mosbesimit të krijuar.

Tani këtu vijmë deri te një fazë tjetër në rajon, te ndryshimet që priten të ndodhin në vetë BE-në dhe ripozicionimet e

amerikanëve në Euro-Azi, me ç'rast kriza në BE mund të nxit fragmentimin e Ballkanit dhe në një mënyrë të shtojë rivalitetet mes popujve me nxitjen e aktorëve të huaj si ata rus, që të gjejnë vend për ndërhyrje të reja, ashtu si gjatë dy dekadave të fillim shekullit XX.

ⁱKCSS. 2020. "Kosovo Center for Security Studies." 11 1. Accessed 11 12, 2020. http://www.qkss.org/repository/docs/Report-Russian-Influence-in-Kosovo-English-Version_721419.pdf?fbclid=IwAR2NKsPnWpKs4KtTlmr1ZDR0CNPIUWFPdZ5knbBttGJI-WGYMOoOYyVBvXo.

ⁱⁱLiik, Kadri, Momchil Metodiev, and Nicu Popescu. Report. European Council on Foreign Relations, 2019. Accessed April 24, 2020.

ⁱⁱⁱKrijestorac, Mirsad. "Imposing Particular Identities: The Balkans as a meeting place of ethnicities and Religions." Insight Turkey 20, no. 3 (2018): 241-64. Accessed April 24, 2020. www.jstor.org/stable/26469853

^{iv}Konitzer, Andrew. "Serbia between East and West." Russian History 38, no. 1 (2011): 103-24. Accessed April 24, 2020. www.jstor.org/stable/24665384

^vJonsson, Oscar, et. al: Russian Cyber Strategies. Report. Edited by Popescu Nicu and Secieru Stanislav. European Union Institute for Security Studies (EUISS), 2018. 85-92. Accessed April 24, 2020. doi:10.2307/resrep21140.12

^{vi}Portalb. 2020. www.portalb.mk. 10 3. Accessed 11 6, 2020. <https://portalb.mk/711599-nga-vmro-dp-mne-protestuan-sot-ne-shkup-mickovski-permend-rastin-e-shik-jellak-ne-tetove/>.

^{vii}"F2N2. 2019". <https://f2n2.mk/>. Accessed 4 23, 2020. <https://f2n2.mk/sq/interesat-strategjike-dhe-mjetet-e-ndikimit-terusise-ne-ballkanin-perendimor-mjetet-e-rusise-per-ndikim/>

^{viii}KIPR. 2020. Kosovo Disinformation Alerts. 2020. "Kosovar Institute for Policy Research ." 3 20. Accessed 10 2 1, 2 0 2 0. http://www.kipred.org/repository/docs/D_-_Alert_-_Russian_Media_-_April_2020_536416.pdf

^{ix}Census. 2020. www.census.gov/foreign-trade/balance/c4794.html#2014. 2014. www.census.gov. 7 1. Accessed 4 24, 2020.

^xIbraimi, Selim. 2016. Paqja e Ftohtë: Dhjetëvjeçari i rikonfigurimeve gjeopolitike në Ballkan. Qendra për Studime të Sigurisë dhe Zhvillim, 2016. Tetovë: 217-228.

^{xi}"F2N2. 2019". <https://f2n2.mk/>. Accessed 4 23, 2020. <https://f2n2.mk/sq/interesat-strategjike-dhe-mjetet-e-ndikimit-terusise-ne-ballkanin-perendimor-mjetet-e-rusise-per-ndikim/>

^{xii}Ibraimi, Selim. 2016. Paqja e Ftohtë: Dhjetëvjeçari i rikonfigurimeve gjeopolitike në Ballkan. Qendra për Studime të Sigurisë dhe Zhvillim, 2016. Tetovë: 228-237.

bët më të dalluar në leximin dhe mësimin e leximit të Kuranit ishin Ubejd b. K'ab, Abdullah b. Mes'ûd, Zejd b. Thâbit, Sâlim, hz. Aliu, hz. Osmâni dhe Ebû Mûsâ el-Esh'ari (radijallahu anhum).

Siç përmendëm edhe më sipër, sahabët i jepnin shumë rëndësi leximit të Kuranit. Kështu që Kurani u transmetua sipas të shtatë shkronjave, vetëm se secili prej sahabëve kishte mësuar vetëm një-rën, ose disa prej gjithë këtyre formave të ndryshme të leximit. Në hapat e parë të historisë islame kjo çështje nuk përbënte ndonjë problem të madh, sepse pasuesit e hz. Muhamedit (alejhis-selâm) ishin në dijeni të lejes që kishte dhënë Zoti i Madhërishëm. Veçse, me zgjerimin e trevave islame, sahabët u shpërndanë në vende të ndryshme të botës dhe secili prej tyre ua mësonte Kuranin myslimanëve të rinj sipas formës që ai vetë e kishte mësuar prej të dërguarit të Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Si rezultat, myslimanët e rinj, që sapo kishin mësuar Kuranin sipas një leximi të caktuar, binin ndesh me njëri-tjetrin, sepse leximet e tyre ndryshonin pjesërisht. Për këtë shkak, ata kanë pasur disa herë konflikte me njëri-tjetrin.

HAPI GJIGANT I OSMANIT (R. A.)

Për zgjidhjen e kësaj çështjeje, kalifi i tretë, Osmani (radijallahu anhu), hedh një hap gjigant në historinë islame. Deri atëherë Kurani vetëm sa ishte grumbulluar. Kurse kalifi i kohës, e heq lejen e shtatë shkronjave, me nijetin që të bashkojë ymetin në një lexim të vetëm dhe rezultati është perfekt. Si përfundim, Kurani shkruhet në bazë të gjuhës së kurejshëve, sepse ishte gjuha që fliste Muhamedi (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe gjithashtu më letrarja. Kështu, bëhen 4 ose 7 kopje të Kuranit – sipas dallimit të transmetimeve – të cilat shpërndahen në qendrat kryesore të shtetit islam. Së bashku me secilën kopje u dërgua edhe nga një mësues, i cili do t'i mësonte popullit leximin e mus'hafit përkatës.

Atëherë, mund të themi që lindja e kirâeteve u realizua së bashku me lindjen e shtatë shkronjave. Deri në periudhën e shumëzimit të Kuranit, ato ishin brenda shtatë shkronjave. Kur Kurani u shumëzua, atëherë shtatë shkronjat u hoqën dhe mbetën vetëm kirâetet, të cilat mund të lexoheshin edhe në bazë të shkrimit të gjuhës së kurejshëve. Për shkak se atëherë nuk kishte as shkronja zgjatëse, as pika e as zanore - i njëjti shkrim mund të lexohej në forma të ndryshme. Ato, të mësuara edhe prej Pejgamberit (sal'lal-



lahu alejhi ue sel'lem) nuk u harruan, por u ruajtën dhe u transmetuan brez pas brezi. Ja, pra, edhe shkenca e kirâeteve e studion pikërisht këtë pjesë të mbetur nga shtatë shkronjat e lejuara në periudhën e Pejgamberit (alejhis-selâm). Kirâetet kanë ardhur sistematikisht deri në ditët e sotme. Në bazë të vetë rregullave të gjuhës arabe, nuk lejohet që Kurani të lexohet në mënyrë tjetër, pos siç e ka lexuar Muhamedi (alejhis-selâm), kurse shokët e tij me transmetim të sigurt na e kanë dorëzuar. Edhe vetë Pejgamberi i Zotit, vetëm në bazë të Shpalljes në mënyra të ndryshme, e ka lexuar Kuranin sikurse që e kemi përmendur këtë edhe më parë. Në këtë mendojmë kur themi se kirâetet janë “tevkifijje”, d.m.th. ashtu siç i janë shpallur Muhamedit (a. s.). Ai kështu ua ka thënë edhe shokëve të vet. Në asnjë rast nuk guxon të kuptohet se ato kirâete imamet në kirâet, ose individë të tjerë para ose pas tyre, nga vetvetja i kanë përcaktuar. Kjo jepet të kuptohet nga fjalët e h. Umerit, Zejd b. Thabitit, Urve b. Zubejrit, Umer b. Abdulazizit, Sha'biut e të kolosëve të tjerë islamë nga periudha e parë e Islamit, të cilët e kishin traditë të

thonë: “Kirâeti është sunnet e traditë, të cilën i riu duhet ta mësojë prej më të vjetrit. Dhe, mësoni vetëm ashtu siç ju kanë mësuar!”

Tregohet se Nafi'u dhe Ebu Amri kanë thënë: “Sikur mos ta kisha të ndaluar ta lexoj Kuranin tjetërfare se si më kanë mësuar mësuesit, unë këtë e këtë fjalë nga Kurani do ta lexoja kështu e kështu e këtë kështu.” Kjo shihet edhe nga ajo që dijetarët islamë gjithnjë rreptë janë ngritur dhe kanë gjykuar atë i cili sipas të kuptuarit të vet, pa transmetim, ka krijuar kirâete të reja. Kështu ka ndodhur me Ebu Bekr Muhammed b. Hasan b. Miksem el-Bagdadin, i cili ka qenë i aftë në sintaksën arabe (ka qenë pas vitit 300), kurse ka pohuar se Kurani mund të lexohet në të gjitha mënyrat e ndryshme që i lejon sintaksa arabe, edhe nëse ato nuk kanë mbështetje në transmetim. Ai është ftuar në përgjegjësi dhe botërisht është penduar dhe ka dhënë premtimin me shkrim se këtë më nuk do ta pohojë. Ngjashëm ka ndodhur me Ibn Shenbuzin - Ebu-Hasan Muhammed b. Ahmed b. Ejub ibni Shenbuz el-Mukri-un, vdiq në vitin 328 (shih: “Shezerau-udh-

dheheb”, vëll. 2, fq. 313 dhe 314) në Bagdad, i cili ka konsideruar se Kurani mund të lexohet sipas kirâeteve të cilat nuk i kanë të gjitha kushtet e autenticitetit që i kërkojnë dijetarët islamë. Për këtë zyrtarisht është ftuar në përgjegjësi, ku para tubimit të dijetarëve dhe karrive bagdadas botërisht ka deklaruar se pendohet dhe ka dhënë premtim me shkrim se më nuk do të preokupohet me atë punë fetarisht të ndaluar.

Në shekullin e parë e të dytë shkenca mbi kirâetet mësohej nga tradita gojore e njerëzve të ditur. Për kirâetet nuk ka pasur vepra të shkruara veçan dhe nëse diç më vonë edhe është shkruar, kjo është bërë tërthorazi, krahas tefsirit dhe shkencave të tjera kuranore. Diç më vonë vjen Ebu Bekr Ahmed b. Musa b. Abbas b. Muxhahid (vdiq më 324 H), i cili për kirâetin ka shkruar vepër të veçantë dhe për herë të parë ka zgjedhur shtatë imamet autoritativë, kirâetet e të cilëve më vonë veçanërisht janë lexuar dhe ligjruar. Pas tij janë radhitur shumë autorë për shkencën e kirâetit, si Ebu Bekr Ahmed b. Husejn b. Mihran (vdiq më 381 H), autori i veprës “Esh-Shâmil” dhe “El-Gâje” për

kirâetet e dhjetë imamëve dhe Ebu-l-Fadl Muhammed b. Xha'fer El-Huzai (vdiq në vitin 408 H), autor i veprës “El-Muntehâ”, në të cilën ka tubuar atë që nuk e ka tubuar askush.

Në Magrib dhe Endelus deri në fund të shekullit të katërt shkolla e kirâetit ka qenë mjaft dobët e zhvilluar, derisa disa prej tyre nuk shkuan në Egjipt dhe së ndejmi e sollën atë shkencë. I pari që këtë shkencë e solli në Endelus ishte Ebu Umer Ahmed b. Muhammed et-Talemenki (vdiq më 429 H), i cili për kirâetin ka shkruar veprën “Err-Revda”. Pas tij rrugës së njëjtë ka shkruar Ebu Muhammed Mekki b. Ebi Talib el-Kajsi (vdiq më 437 H), autor i veprës “Et-Teb sire” dhe “El-Keshf”. Pas tyre ka qenë dijetari i famshëm i kirâetit Ebu Amr Uthman b. Seid ed-Dâni (vdiq më 444 H), autor i “Et-Tejsir” dhe “Xhamiu-l-bejan”. Në “Xhamiu-l-bejan” gjerësisht i ka përpunuar shtatë kirâetet e njohura, të cilat i ka lidhur me transmetim deri te vetë shtatë imamet. Rrugët e transmetimit në atë vepër janë më shumë se pesëqind. Në atë kohë për ta mësuar shkencën e kirâetit u nis nga Perëndimi drejt Lindjes Ebu-l-

Kasim Jusuf b. Ali el-Huzeli-u, i cili i vizitoi të gjitha qytetet deri në Gazne, duke i kërkuar dijetarët e kirâetit. Fryt i atyre udhëtimeve të mëdha dhe hulumtimeve të gjithanshme është vepra e tij “El-Kâmil”, në të cilën ka tubuar pesëdhjetë kirâete nëpërmjet një mijë e katërqind e pesëdhjetë e nëntë rrugëve transmetuese prej 365 mësuesve në kirâet, që i ka takuar në rrugën e vet prej skajit të Magribit deri në Fergan, për së gjati e për së gjeri (vdiq më 465 H). Në këtë shekull ka jetuar në Mekë Ebu Ma'sher Abdulkerim b. Abdussamed et-Taberiu (vdiq më 478 H), i cili për kirâetin e shkroi veprën “Et-Telhîs”, që përmban të kirâete dhe veprën “Sûku-l-arûs”, në të cilën ekzistojnë 1550 rivajete dhe tariqe (transmetime dhe rrugë).

Në shumësinë e rivajeteve dhe tariqeve këta dy i kapërceu Ebu-l-Kasim Isa b. Abdulaziz el-Iskenderi (vdiq më 629 H), që ka shkruar veprën “El-Xhami-ul-ekber vel-Bahru-l-ez'har”, e cila përmban shtatë mijë rivajete dhe tariqe.

ZHVILLIMI I SHKENCËS SË KIRÂETIT PREJ SHPALLJES SË KURANIT

Ashtu si të gjitha shkencat tjera islame, si: tefsiri, hadithi, fikhu etj., edhe dija e leximit të Kuranit famëlartë u shndërrua në një shkencë më vete dhe me kalimin e kohës fitoi sistematikën dhe metodikën e saj. Qoftë leximi e shqiptimi i Kuranit, qoftë kirâetet, u mësuan brez pas brezi.

Sahabët ua mësuan Kuranin njerëzve në bazë të leximeve që të lejonte kopja e shumëzuar prej Osmanit (radijallahu anhu) dhe kjo shkencë dhe dijetarët që jepnin mësim Kurani u zgjerua edhe më tepër në vende të ndryshme islame. Kështu, kirâetet që ata praktikonin filluan të emërtoheshin me emrat e tyre. Vetëm se midis të gjithë kirâeteve që përdornin njerëzit, ndodheshin edhe lexime të dyshimta e pa sened të fortë. Për këtë arsye, Ebû Bekr b. Muxhâhid (324/935), me ndihmën e kalifit të asaj kohe, vendosi t'i analizojë këto kirâete nga këndvështrimi i transmetimit dhe veçoi leximet e sakta muteuâtir. Leximet tjera u përjashtuan dhe u ndaluan me urdhrin e kalifit. Ai përfshiu shtatë kirâete, ku në krahasim me shtatë kirâetet e shquara, në vend të Kisâit ndodhej Ja'kûbi.

Në fakt, disa orientalistë, me qëllim që të sulmojnë Kuranin, këtu mundohen të përfitojnë nga rasti, duke thënë që me shumë mundësi kirâetet ishin më tepër se shtatë, ashtu siç përmendnin edhe dijetarët e hershëm të kësaj fushe, por Ibn Muxhâhid, për shkak të shtatë shkronjave

përshatati edhe numrin e kirâeteve me numrin e tyre. Siç thotë edhe Ez-Zerkânî, ky numër nuk ishte i qëllimtë. Ibn Muxhâhid mblodhi kirâetet të cilave u përshatashin kriteret për t'u quajtur muteuâtir. Këtë fakt e vërteton edhe Imam Ibn el-Xhezerî, i cili numrin e kirâeteve e nxjerr në dhjetë.

Në mesin e më të shquarve, të cilët kishin fituar mirëbesimin e njerëzve në këtë periudhë, ishin: në Medinë, Nafi' (v. 169/785); në Mekë, Abdullah b. Kethîr (v. 120/737); në Basra, Ebû Amr (154/770); në Shâm, Ibn Âmir (v. 118/736); në Kufë, Âsim (v. 127/744) dhe Hamza (v. 188/803) dhe el-Kisâi (v. 189/804).

Në fund të shek. II Hixhri dijetarët me shumë mund i mblodhën të gjitha kirâetet dhe i regjistruan nëpër libra, duke ia atribuar ato lexuesve më të shquar. Gjithashtu, bënë dallimin midis të saktit e të dobët. Kështu, punimet e para nisën pikërisht në shekullin e dytë Hixhri. Dijetari më i dëgjuar në këtë fushë ishte Hârûn b. Mûsâ (v. 170/786), por punimet e tij ishin vetëm me gojë. Për të gjetur diçka të shkruar, duhet të shkojmë në shek. III të Hixhretit, ku ndodheshin Ebû Ubejd el-Kâsim b. Sel'lâm (v. 224/828), Ebû Hâtim es-Sixhistânî (v. 255/868) dhe Ibn Xherîr et-Taberî (v. 310/922). Këtu dallojmë që termi "shtatë kirâete" nuk kishte dalë akoma në dritë, sepse p.sh. Ebû Ubejd el-Kâsim b. Sel'lâm (v. 224/828), përveç kirâeteve të njohura, përmend edhe 25 kirâete të tjera.

Në shek. IV të Hixhretit Ebû Bekr b. Muxhâhid (v. 324/935) përmbledh në një vepër kirâetet e imamëve që përmendëm më sipër dhe e titullon atë "Kitâbu's-Seb'a" (Libri i të Shtatëve). Punimet e mëtejshme u zhvilluan në bazë të kësaj veprë dhe këto shtatë kirâete fituan ixhmanë (konsensusin) e ymetit. Më pas, dijetari i madh i kirâeteve Ibn el-Xhezerî (v. 833/1429), duke iu bashkangjitur këtyre të parëve edhe tri kirâete të tjera, e nxori numrin e imamëve në dhjetë. Tashmë ato quhen "dhjetë kirâetet".

Emrat e dijetarëve të kirâeteve që shtoi Ibn el-Xhezerî janë: në Medinë, Ebû Xhafer (v. 130/748); në Basra, Jakûb (205/820) dhe në Kufë, Halef (229/844). Në shekullin e parë e të dytë shkencë mbi kirâetet mësohej nga tradita gojore e njerëzve të ditur. Për kirâetet nuk ka pasur vepra të shkruara veçan dhe, nëse diç më vonë edhe është shkruar, kjo është bërë tërthorazi, krahas tefsirit dhe shkencave të tjera kuranore.

Vetëm në shekullin e tretë, kur çdo shkencë islame kishte lulëzuar, kurse

patën filluar me vull të mugullojnë veprat për të gjitha shkencat islame, atëherë edhe për kirâetet si fillim i parë janë shkruar disa vepra të rëndësishme. Dijetar i parë më i rëndësishëm që për kirâetet ka dhënë një vepër të rëndësishme është Ebu Ubejt Kasim b. Sel-lam (vdiq më 224 H). Ai ka shkruar veprën në të cilën ka tubuar kirâetet e njëzetepesë karrive të famshëm, ndër të cilët bëjnë pjesë shtatë të njohur për ne. Më vonë erdhi Ibni Xherir et-Taberiu, mufesiri i famshëm, i cili për kirâetin ka shkruar një vepër të rëndësishme, e cila përmban kirâetet e njëzet e disa karrive. Këtë vepër e ka quajtur "El-Xhami" (vdiq në vitin 310 H).

Në shumësinë e rivajeteve dhe tariqeve, këta dy i kapërceu Ebu-l-Kasim Isa b. Abdulaziz el-Iskenderi (vdiq më 629 H), i cili ka shkruar veprën "El-Xhami-ul-ekber vel-Bahru-l-ez'har", që përmban shtatë mijë rivajete dhe tariqe.

As për së afërmi nuk i kemi numëruar autorët më të famshëm në shkencën e kirâetit. Kjo është gjithsesi detyrë e veprave krejtësisht profesionale, sikurse që janë "Tabekatu-l-kurâ" prej Dhehebiut dhe Ibnu-l-Xhezerijes. Vetëm do të cekim edhe atë se në këtë shkencë sot më të njohura e më të përhapura janë veprat e Ebu Amr ed-Dâniut, të cilin pak më parë e cekëm, veprat e Ebu-l-Kasim b. Firruh b. Halef esh-Shatibiut (vdiq më 590 H.), e veçan poema e tij në 1173 dyvargësja, që është e njohur me emrin "Esh-Shatibijje" ose "Hirzu-l-emani ve vexhhu-tehâni" dhe veprat e Shemsuddin Ebul-Hajr Muhammed b. Muhammedit, të quajtur Ibnu-l-Xhezeri (vdiq më 833 H), e sidomos "En-Neshru fi-l-kiraati-l-ashri" dhe "Et-Takrîb".

GJENDJA E KIRAETIT NË DITËT E SOTME

Sa u përket shkencave të kirâetit, sahabët konsiderohen si brezi i parë që e trashëgoi leximin e Kuranit nga Pejgamberi (a. s.), kurse tabiinët si brezi II, që morën nga sahabët. Atëherë tabiinët e tabiineve (etbaut-tabiin) i konsiderojmë si brezi III në këtë drejtim. Pra, në çdo anë të Shtetit Islam etbau-tabiinët e morën leximin e Kuranit dhe u mësonin të tjerëve. Ata enkas iu kushtuan shkencës së kirâetit, duke pasur kujdes të veçante edhe ndaj vokalizimit të tij, aq sa u bene imame të cilëve u bindeshin të tjerët, bashkevendasit e tyre ua pranuan kirâetet, njerezit udhëtonin nga larg deri tek ata dhe merrnin mësim për kirâetet.

Kirâetet fituan një sistematikë të mirë

transmetimi që me Ibn el-Xhezeriun dhe u transmetuan kështu brez pas brezi. Por, kjo nuk është një shkencë që mund të studiohet e të përvetësohet nga çdokush. Personat që marrin mësimet e kirâeteve janë të veçantë, sepse është një punë e gjatë dhe kërkon sakrificë. Nga ana tjetër, për njerëzit e thjeshtë duhet mësuar vetëm njëri nga kirâetet, në mënyrë që të lexojnë Kurantin.

Çdo njeri që mëson leximin e Kuranit, në fakt mëson njërin prej kirâeteve. Nga analiza e përgjithshme e këtyre leximeve, dijetarët në përgjithësi arrijnë në përfundimin se kirâeti i Imam Asimit është më i thjeshti e më i përshtatshmi - si për arabët, ashtu edhe për joarabët. Ndoshta është leximi më i përafërt që përdorte vazhdimisht Pejgamberi (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), si një kurejshit që ishte. Prandaj, edhe në ditët e sotme kirâeti më i famshëm e më i përdorur është ai i Imam Asimit, të transmetuar nga Hafs. Madje, edhe gjatë botimit të Kuraneve, merret për bazë leximi i Hafsit.

Njëri nga kirâetet e tjera, që përdoren sot e kësaj dite është ai i Imam Nafi'ut, të transmetuar nga Uersh. E gjithë Afrika veriore, përveç Egjiptit, përdor leximin e Imam Nafiut.

Leximi i tretë ende i përdorur në ditët e sotme është ai i Imam Eb'u Amrit. Ky kirâet përdoret vetëm nga sudanezët.

Edhe Shqipëria dhe vendet tjera në Ballkan përfshihen në grupin e vendeve ku lexohet kirâeti i Imam Asimit, të transmetuar nga Hafs.

Sot dijetarët islamë akoma i ruajnë dhe i mesojnë te dhjetë kirâetet, kështu që ato kirâete akoma jetojnë ne qarqet shkencore.

Ne baze te kësaj që thame deri me tani, sot myslimanet e rëndomtë nuk i dinë keto kirâete se janë mutevatir, prandaj mund të gabojnë njeri ndaj tjetrit, duke u akuzuar gabimisht nga injoranca me qufër apo diçka tjetër. Një gabim i tillë ka ndodhur në kohën e Othmanit (r. a.), në betejën e Armenisë dhe Azerbejxhanit, kur myslimanet nuk gjenin mus'haf te lehte për ta lexuar dhe për ta kuptuar.

Libra për kirâetet kemi mjaft, nga të cilët ndër më të njohur janë: Essebatu fil Kiraati të autorit Ebu Bekr b. Muxhahid, Enneshru fil Kiraati ashri të autorit Ibnu-l-Xhezeri,

It'hafu fuadal beshër bil Kiraatil ar-beati asher të autorit Benna Eddimjati etj. Veprat e lartpërmendura gjenden rrallë dhe vetëm nëpër qarqet shkencore.

(Fusnotat janë hequr nga Redaksia gjatë përpunimit të tekstit)

DISPOZITA E VEPRIMIT ME HADITH TË DOBËT (3)

Shkruan: Melek Bislimi



Thëniet (qëndrimet) e dijetarëve në lidhje me të vepruarit me hadith daif

Në këtë nënkaptull do të shënojmë mendimin (qëndrimin) e disa dijetarëve më eminentë të shkencës së hadithit dhe të jurisprudence islame:

1. Imam Sufjan Thevriu سفیان الثوري (v. 161), transmeton Hatibi se Imam Thevriu ka thënë: Merrni këto vepra të mira nga dijetarët (pleqtë), kurse të lejuarën (hallallin) dhe të ndaluarën (haramin), mos e merrni vetëm nga ata që dinë se cila është e tepërt në të, nga ajo që është e pakë¹.

2. Imam Abdulla ibni Mubarek الامام عبدالله بن المبارك (v. 181). Transmeton Ibni Ebu Evfa në veprën e tij "El-xherh ve ete'dil", nga babai i tij, nga Ubejde ibni Sulejman, i cili ka thënë: Ju është thënë Ibni Mubarekut, pasi që ai kishte transmetuar nga një njeri një hadith se, ai njeri është daif (i dobët), ai ishte



JU TREGOJ HISTORINË E HANSIT, DASHAMIRËSIT TË ISLAMIT

Nga Abdurrahman Iseni
(Enkas për HeR)

Pas shumë paraqitjeve publike rreth aktiviteteve të ndryshme shoqërore dhe kombëtare, vendosa që së fundmi të përsiat për një mik, për një njeri të krishterë dhe dashamirës të Islamit, i cili potencialin e vet intelektual dhe njerëzor në pesë vitet e fundit e ka vënë në shërbim të xhamisë "Ikre" në Thun, kantoni Bernë, Zvicër. Është ky zotëri Hans Heinrich Weber, të cilin xhamati i Thunit e njeh gjerësisht, për shkak se e ka takuar në të gjitha performancat zyrtare, institucionale, komunale dhe kantonale, në promovimin e vlerave islame dhe gjatë bashkëpunimeve ndërreligjioze islame-krishtere

Kush është Hansi? Hans Heinrich Weber është 80 vjeç, i besimit katolik-roman. Zonja e tij quhet Anne Hediger. Janë prindër të dy djemve: Hans Weber Junior, jurist dhe të Christoph D.Weber, profesor në University of North Texas, SHBA.

Hansi, pasi ka kryer shkollën fillore në Menzinken, Aargau, katër vite ka pasur një trajnim si teknik i mekatronikës, pas së cilës ka kaluar në tregtinë e aviacionit si mekanik aeroplanësh, me stërvitje intensive. Bëhet nënoficer karriere në Ushtrinë Zvicerane. Ka pasur një karrierë të bujshme si mësues, specialist për inxhinierinë e automobilave dhe të elektronikës në shkollën e Qendrës së rekrutimit në bazën ushtarake Thun dhe më pastaj në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë, në Bernë.

NË FUNKSIONE TË LARTA NDERKOMBËTARE

Krejt ky aktivitet, të gjitha këto njohuri nga elektronika dhe informatika, kanë bërë që pas 15 viteve të kalojë në funksione të larta ndërkombëtare, si p.sh.

në NATO. Specializimi i tij në fushën e IT-së i mundëson të kalojë me detyrë ushtarake-diplomatike në Ambasadën Zvicerane në Uashington D.C., ndërsa më pas merr akreditimin brenda forcave të armatosura të SHBA. Pas pesë viteve eksperiencë në Ushtrinë Amerikane dhe në Ambasadën Zvicerane, në shërbime të ndryshme në fushën e inteligjencës dhe të teknologjisë së informacionit dhe të komandimit të kontrolluar nga kompjuteri, pensionohet në vitin 1999.

Prej vitit 2008 Hansi dëshiron një ndryshim të madh: nga shkencat natyrore, kalon në shkencat humane, kështu që pas pensionimit vazhdon studimet teologjike 2013-2019.

Takimi i tij i parë me Islamit ka qenë me Imamin e xhamisë "Ikre" në Thun, Azir Azirin.

Rrëfimi personal i Hansit: Ishte shkurti i vitit 2018 kur unë u takova për herë të parë me Azir Azirin. Si i krishterë, kërkoja të hyj drejtpërdrejt në kontakt me Islamit, sepse më 2013 fillova të studioj teologji dogmatike në Universitetin e Freiburgut. Lexova libra të ndryshëm për Islamit dhe gjithmonë bëhesha më i pakënaqur me interpretimin e tyre. Sepse, unë e refuzoj misionin e ndërsjellë, që mund të çojë në keqkuptime. Pyeta xhaminë "Ikre" në Thun, nëse mund të kisha akses autentik në Islam si i krishterë. Takimi i parë me Imam Azir Azirin do të mbetet i paharrueshëm. E pyeta Azirin nëse mund të ecja në një rrugë të re, të respektit të ndërsjellë dhe i thashë: 'Nëse do Zoti, ne do ta bëjmë.' Aziri, ndërkaq, u drejtua drejt meje dhe u përqaftua me njëri-tjetrin. I thashë se të kam vëlla.

Pas katër vitesh angazhime të ndërsjella, ne jemi bërë vëllezër të pandarë, thotë Hansi. Ndër aktivitetet tona të përbashkëta ndërfaqetare, thotë ai, do të veçoja faljen e përbashkët, myslimanë e të krishterë, nën qiellin e hapur dhe lutjet për paqe mes njerzve pa dallim, sepse ne të

gjithë kemi një Zot dhe jemi bijtë e Ademit (a. s.).

Nuk lutemi me njëri-tjetrin, por për njëri-tjetrin, me vizita të ndërsjella të myslimanëve dhe të krishterëve në kisha dhe xhamia. Studentë fetarë myslimanë dhe të krishterë takohen rregullisht dhe këmbëjnë mendime interesante dhe substanciale. Kemi organizuar që nëpër shkolla të shpërndajmë Islamit në mënyrë autentike dhe reale, në orët e shkollës në lëndën e fesë.

Vitin 2020 ishim xhamia e parë në Thun që prezantuar parandalimin e Covid-19, të mandatuar nga Shteti. Bashkë me Azirin punojmë që t'i afrojmë vlerat e Kuranit fisnik me ato të Ungjillit në një kontekst respektues dhe jo misionar. Me aktivitetin tonë të përbashkët dhe decid krijuam lidhje direkte me institucionet komunale, kantonale dhe federale, në bashkëpunim miqësor me Entin për kompetenca integruese. Qëllimi im ishte të merresha me kuptimin e ekzistencës sonë në jetë. Aziri dhe unë punojmë në vazhdimësi që xhamisë së Thunit "Ikre" t'i japim një pasqyrë të drejtë dhe korrekte, të bashkëpunim të ngushtë ndërfaqetare, të integrojmë kulturat dhe vlerat tona të përbashkëta. Punojmë që të zhdukim injorancën, të zhvillojmë respektin e ndërsjellë ndërfaqetare, tolerancën ndërfaqetare dhe përfundimisht ta luftojmë islamofobinë dhe urrejtjen reciproke.

Ndjem i privilegjuar që nga xhamia "Ikre" Thun, unë si i krishterë u emërova delegat për shkëmbime ndërfaqetare-kulturore. Ne kemi përfshirë edhe shtyllat në vazhdim si teza kryesore:

-Nuk duhet ta besosh, por duhet ta dish;

-Duajeni besimin tuaj dhe respektoni të tjerët;

-Ne punojmë pa financa, mbi baza vullnetare.

Ndër shumë aktivitete që kemi arritur,



Zotëri Hans Heinrich Weber (majtas) dhe Imam Azir Aziri në xhaminë "Ikre", Thun BE, Zvicër. (foto: Abd)

vlen të përmenden disa intervista në të përditshmen "Thunner Tagblatt", intervista në Radio-Bernë dhe shumë të tjera, pastaj takimin me zyrtarin më të lartë shtetëror për çështje fetare, z. Leutwyler etj.

FALJET E NAMAZEVE, "FALJE TË VËLLEZËRVE TË MI"

Hansi ka në funksion ueb-faqen e tij zyrtare, të cilën e përdor ekskluzivisht për interesat e xhamisë "Ikre" në Thun (www.ikra.thun.ch), edhe atë me harxhime dhe taksa personale. Këtë e bën, thotë ai, se është mik i madh i Islamit dhe i xhamisë "Ikre" Thun. Të gjithë kemi një Zot dhe të gjithë jemi bijtë e Ademit

(a. s.), thotë ai. Hansi me kënaqësi dhe respekt në Xhami ndjek faljet e namazeve. Ato janë falje të vëllezërve të mi, si bij të Ademit (a. s.), thotë ai.

Kush është Azir Aziri? Aziri është Imam në xhaminë "Ikre" Thun. Është nga Debreshi i Gostivarit. Shkollën fillore e ka kryer në vendlindje, të mesmen në "Isa Beu" në Shkup, kurse fakultetin dhe specializimin për Sheriat në Medinë-Arabi Saudite. Në Thun ka ardhur para pesë vitesh, me dëshirën e xhamatit dhe me një përvojë ekselente të profesorit të mësimi islam në Gostivar.

Në xhaminë "Ikre" Thun Imam Aziri në periudhën pesëvjeçare mbi dhjetë nënës i ka mësuar në leximin e Kuranit fisnik dhe kjo është mbyllur me hatme.

Mbi 70 nxënës të tjerë janë në përfundim e sipër, kurse 90% të anëtarëve të rregullt të xhamatit ua ka mësuar leximin e Kuranit fisnik. Imam Aziri me nxënësit për mësim fetar punon sipas planprogramit profesional, të ndarë në grup-mosha. Angazhimi profesional dhe shpirtëror i Imam Azirit dhe bashkëpunëtorit të ngushtë Hans Heinrich Weber, ka bërë që xhamia "Ikre" Thun të jetë në shtylla të sigurt, substanciale dhe shumë shprehëdhënëse për gjeneratat e reja.

Faleminderit, Hans! Faleminderit, Imam Aziri! Faleminderit, xhamatë, për përkrahjen e pakontestueshme!

(Autori është nga Zherovjani, Tetovë, prej kohësh veprimtar në Zvicër)

TULIPAN, XHAMIA QË TË LË PA FRYMË

Nga Nehat Ismaili

Traditat autoktone shqiptare, mi-shërimin midis arkitekturës tradicionale islame dhe artit bashkëkohor zviceran - me një ndjenjë të rehatisë shpirtërore dhe të qetësisë absolute i gjen në Xhaminë Tulipan në Reinach AG.

Çfarë e bën Xhaminë Tulipan një atraksion të veçantë, e cila ia vlen të vizitohet?

Ka disa arsye pse ia vlen të vizitohet kjo xhami:

1. Peizazhi i bukur i fshatrave përreth, derisa arrini në Xhaminë Tulipan. Sidomos gjatë natës ky peizazh shfaqet para nesh në mënyrë grandioze. Tempulli imponant duket edhe më mahnitës në mbrëmje, kur është i ndriçuar mrekullisht me drita dhe me simbolin e vet tulipan.

2. Aty është përdorur një teknologji shumë moderne, kështu që rrezet e diellit, pasi kalojnë nëpër dritaret e Xhamisë, në hapësirat e brendshme i japin asaj një pamje me një ndjenjë spiritualiteti, atmosferë meditative dhe shpirtërore.

3. Xhamia Tulipan është mishërimi i bukurisë, i arkitekturës më moderne zvicerane dhe asaj tradicionale islame. Në të njëjtën kohë, është një tempull madhështor që reprezenton paqen, dashurinë, diturinë, kulturën, identitetin kombëtar dhe vlerat shpirtërore. E tillë do të jetë gjithmonë: pjesë qendrore e jetës fetare dhe kulturore në Kantonin Aargau e më gjerë.

4. Në hyrje të Xhamisë, që karakterizohet me kolona të larta, do të lexoni mbishkrime të mëdha me motive kurane. Tavani i Xhamisë dhe lartësia e tij - të projektuara sipas modelit dhe dimensioneve të Qabesë së Shenjë në Mekë. Lart në tavan, me figura gjeometrike të katrorit kënddrejt, do të lexoni emrat e bukur të Zotit. Lart në kolona, me shumë art janë shënuar emrat e profetëve - paqja



e Zotit qoftë mbi të gjithë. Arti islam është kombinuar me ngjyra të arit, me një tepih me ngjyrë të kuqërremtë mbresëlënëse dhe shumë tërheqëse, e cila edhe namazin ta bën më të lezetshëm në tërë atë kolorit ngjyrash, mbishkrimesh dhe arkitekture madhështore.

5. Aty shijuan një iftar të rangut me pesë yje gjatë Ramazanit 2022, nën tingujt e ilahive dhe një shërbim mjaft cilësor. Nuk mungoi as bakllavaja, e ardhur nga brendia e restorantit, prej ku shfaqen pamjet më imponante të kodrave të blerta të Reinachut.

6. Shkëlqimi dhe bukuria e disenjës shfaqen në mënyrën më të mirë edhe te kaligrafia islame, me dekorimet e veta, veçanërisht në pjesën e mihrabit dhe brenda tavanit të lartë, të zbukuruar me vargje nga Kurani fisnik dhe emrat e bukur të Zotit, si dhe në dyer dhe në hyrje.

7. Tulipanët janë lule jashtëzakonisht të bukura, madje ndër më të bukurat për

nga ngjyrat dhe forma, të konsideruara edhe si lule të veçanta për fisnikët. Nga fusha e botanikës mësojmë që tulipani i bardhë përfaqëson paqen, pafajësinë, pastërtinë; tulipani i verdhë përfaqëson gëzimin dhe lumturinë; tulipani i kuq përfaqëson pasionin dhe dashurinë e zjarrtë; ndërsa tulipani me ngjyrë vjollcë përfaqëson elegancën, prosperitetin dhe sofistikimin.

8. Simboli i kësaj xhamie është tulipani, ndaj e mbart me shumë dinjitet këtë emër. Realisht, tulipani është mishërim i dinjitetit të stafit udhëheqës të kësaj xhamie, në krye me Imamin e saj të mrekullueshmin mr. Halil Ademi, Kryetarin e shkëlqyeshëm z. Azir Jusufi (i cili njëherësh është dhe Kryetar i Kuvendit të Komunitetit Mysliman Shqiptar në Zvicër), të Kryesisë së shkëlqyer dhe të një xhemati shumë mikpritës dhe dashamirës. Ky trekëndësh është simbol i suksesit të xhamisë më madhështore jo vetëm në Zvicër, por edhe në Evropë.

LINDJA E MUHAMEDIT (A. S.) DHE KOHA PARA DHE PAS SAJ

Kur bota hyri në luginat e defekteve njerëzore, atëherë Allahu (f. p.) e dërgoi Muhamed Mustafanë (s.a.v.s.) dhe ardhja e tij në këtë botë ka kuptimin: e shpëtimit, të mëshirës, të mësimin, të mbrojtjes dhe të radhitjes - që të radhiten përsëri njerëzit në radhët e njerëzisë, pasi që prej Isait (a. s.) kishin kaluar diku pesë shekuj e gjysmë dhe njerëzit kishin dalë nga këto radhë. Allahu (f. p.) Muhamedin (a. s.) e solli në këtë botë atë ditë kur ishte nevoja më e madhe për të; atë ditë kur njeriu kishte humbur të gjitha vlerat njerëzore; atë ditë kur njeriu e varroste njeriun për së gjalli!



Shkruan: prof. Rexhep ef. Ziberi

Tema që elaborohet në këtë shkrim ka të bëjë me rrjedhat e mëdha historike që ndodhën në rruzullin tokësor, konkretisht në mënyrë të veçantë me paralajmërimet e lindjes së Mësuesit

të Njerëzisë, Muhamedit (s.a.v.s.).

Nëse i kthehemi historisë pak para lindjes së Mësuesit të Njerëzisë, do të gjejmë paralajmërimet e shumta që sinjalizuan ardhjen e shpëtimtarit të njerëzisë. Sinjalet e para burojnë që nga koha e Abdulmutalibit, gjyshit të Muhamedit

(a. s.).

Sipas disa transmetimeve, në të cilat flitet për burimin e ujit të zemzemit, tregohet se në kohën e tij, Abdulmutalibi ishte ai i cili e rihapi burimin e zemzemit, pasi që me kalimin e kohës ky burim (zemzemi) ishte mbuluar.

Për vendin e gërmimit ai kishte dëgjuar në ëndërr një zë, i cili i ishte përsëritur disa herë. Herën e fundit i dha parandjenjë për vendin ku do ta gërmonte zemzemin, duke iu shfaqur në ëndërr: “Me të vërtetë, do ta gësh zemzemin në vendin ku do të lëshohet korbi i zi, me këmbë dhe sqep të kuq dhe me pendë të bardhë në krahë.” Nuk kaloi gjatë e në qiell u duk pikërisht korbi me të gjitha shenjat që i ishin paralajmëruar në ëndërr dhe fluturonte në vendin ku duhej të fillonte rigërmimin e ujit të zemzemit.

Dhe, më në fund vendosi që së bashku me Harithin, djalin e vetëm që kishte në atë kohë, ta rigërmonte. Pas një debati që zhvilloi me kureshtarët e asaj kohe lidhur me vendin dhe motivin e rigërmimit të burimit të zemzemit, asnjëri prej tyre nuk i erdhi në ndihmë. Madje, për më tepër edhe u krenuan me pasuritë dhe me bijtë e tyre, duke qenë se ata kishin të drejtë që ta rihapnin.


Pas kësaj ngjarje, Abdulmutalibi u betua: “Nëse Allahu më fal disa djem, njërin prej tyre do ta sakrifikoj për Allahun, ashtu siç bëri gjyshi ynë Ibrahim (a. s.) me djalin e tij Ismailin (a. s.).”

ZEMZEMI KTHEHET SËRISH NË JETË

Ai vazhdoi të gërmonte dhe pas një pune disaditëshe, shpërtheu uji prej burimit të zemzemit, duke e kthyer zemzemin sërish në jetë.

Kaluan disa vite dhe Allahu (f. p.) më vonë i fali dhjetë djem dhe gjashtë vajza. Pas kësaj, ai duhej që ta kryente betimin lidhur me sakrifikimin e njërit prej djemve. Pas hedhjes së shortit se cilin prej djemve duhej të sakrifikonte, shorti i kishte rënë Abdullahut, babait të Pejgamberit (a. s.), i cili në atë kohë ishte vetëm 18 vjeç. Kur Abdulmutalibi vendosi ta sakrifikonte të birin Abdullahun, turma e masës kureshtarë kërkoi prej tij që të shkonte dhe të konsultohet me një fallxhore në Hajber. Fjala e fallxhores ishte ligj në kohën parakuranore dhe ishte normale që, atëherë kur nuk ka të dërguar, shkencë, dituri dhe mësues, njerëzit të drejtohen tek ajo, duke qenë se ajo ishte më e ditura në mesin e popullit.

Shkuan tek ajo dhe ia treguan rastin e Abdulmutalibit dhe të djalit të tij, ndërsa ajo i pyeti: “Kur njëri prej jush vret një njeri dhe dëshiron që familjes së të vërit t’ia paguajë vlerën e gjakut të tij, sa duhet t’i japë?” “Duhet t’i japë dhjetë deve” - iu përgjigjën ata. Atëherë, ajo tha: “Llogaritni edhe ju dhjetë deve, e pastaj hi dhi short ndërmjet tyre dhe Abdullahut;



në qoftë se shorti u bie deveve, therini ato, e nëse i bie Abdullahut, rriteni numrin e tyre edhe për dhjetë. Këtë përsëriteni derisa shorti nuk bie mbi devetë.”

Kurejshitet me në krye Abdulmutalibin u kthyen në Mekë të entuziazmuar nga propozimi i fallxhores dhe menjëherë filluan hedhjen e shortit. Pas nëntë herë i ra shorti Abdullahut, të dhjetën herë shorti u ra deveve, kështu që gjyshi i tij theri njëqind deve për të. Allahu (f. p.) e shpëtoi Abdullahun, sepse më vonë do t’i lartësojë pasardhësit e tij e njëherësh do t’i mëshirojë me vulën e gjithë pejgamberisë dhe thembrën e gjithë pejgamberëve, ashtu siç do të thotë më vonë edhe vetë Muhamedi (a. s.)!

Sipas disa transmetimeve, para se Abdulmutalibi të martohet me Eminen, Abdulmutalibi e kishte marrë për dore dhe

kishte trokitur në derën e një mekasi për t’ia kërkur dorën e së bijës për Abdullahun, mirëpo deshi Allahu (f. p.) dhe kjo nuk ndodhi.

Të nesërmen e ditës së martës së Abdullahut me Eminen, ai takoi në rrugë vajzën dorën e së cilës babai ia kishte kërkuar për grua. Ajo në atë rast i tha: “Ç’u bë me ty?! Të paska humbur drita e ballit që e kishte dje; sot nuk e paske atë dritë!” Kjo ishte drita që ishte bartur në barkun e Emines, e prej barkut të saj në fytyrën e Mësuesit të Njerëzisë, dritë të cilën babai nuk arriti t’ia shihte asnjëherë, sepse kishte vdekur dy muaj pas martesës me Eminen.

Disa ditë para ardhjes së Mësuesit të Njerëzisë në këtë botë, ndodhi mrekullia kuranore kur Ebrehetul Eshrem - mbreti jemenas - kishte vendosur që ta rrëronte

Qabenë me një ushtri të paparë deri në atë kohë, ushtri së cilës i paraprinin tetë, dymbëdhjetë ose trembëdhjetë elefantë, varësisht nga mendimet e komentuesve të Kuranit famëlartë.

Në Jemen sundonte mëkëmbësi i Nexhashiut, i quajtur Ebrehe bin Sebah el-Eshrem, i cili kishte ndërtuar në San’a të Jemenit një katedrale të bukur dhe gjigante, të cilën e kishte emërtuar El-Kullejs. Këtë e kishte bërë vetëm e vetëm që t’i tërhiqte dhe t’i largonte njerëzit nga vizita Qabesë, shtëpisë së Allahut fuqplotë, në një haxh të deformuar, në rite, në këtë katedrale, duke menduar se tani njerëzit do ta lënë pasdore Qabenë, duke qenë se në atë kohë ajo ishte e ndërtuar thjesht, prej shtyllave të drurit dhe ishte tepër modeste.

Mirëpo, “zotëria” që pati për qëllim

që ta zbehte famën e Qabesë, kishte haruar se Krijuesi Absolut i kishte lidhur zemrat e njerëzve me këtë shtëpi që nga koha e Ibrahimit (a. s.).

Një transmetim flet se një grup djelmoshash ia kishin vënë flakën katedrales së Ebrehesë, kurse një tjetër, që llogaritet më i vërtetë, thotë se një arab nga fisi ken’an i kishte ndotur muret e katedrales me papastërti dhe ky ishte një arsytim i mjaftueshëm për Ebrehën që të mësynte Mekën për ta rrënuar Qabenë!

Për këtë ekspeditë ndëshkuese ishte përgatitur një ushtri e madhe, e cila përbëhej edhe nga një numër i konsiderueshëm elefantësh.

Gjatë rrugës për në Mekë Ebreha u ndesh dy herë me disa fise arabe, të cilat u munduan ta ndalnin për të mos e realizuar qëllimin e tij, por që të dyja këto për-

pjekje dështuan dhe prijësit e tyre u zunë robër nga ushtria e Ebrehesë.

Kur ushtria arriti afër Mekës, u ndal dhe ngriti kampin në vendin e quajtur El-Mugammes. Ndërkohë, ushtarët e Ebrehesë filluan të plaçkitnin pasurinë e kurejshëve, ku përfshiheshin edhe 200 devetë e gjyshit të Muhamedit (a. s.), Abdulmutalibit, i cili ishte edhe prijësi i kurejshitëve asokohe.

Ebreheja urdhëroi që të fliste me të parin e kurejshitëve, për t’ia treguar qëllimin e tij.

Me të arritur Abdulmutalibi, Ebreheja së pari e pyeti, ashtu siç e kanë zakon edhe mbretërit, nëse kishte ndonjë nevojë apo shërbim të cilin Ebreheja mund t’ia kryente, por Abdulmutalibi pa një pa dy ia ktheu: “Unëdua që të m’i kthesh prapa 200 devetë e mia që m’i more.”

Ebreheja u habit nga kjo kërkesë dhe i tha: “Unë të dija për të mençur. Ti nuk pyet se përsekam ardhur këtu dhe as nuk kërkon prej meje që të heq dorë nga rrënimi i Qabesë, por drejt e m’i kërkon devetë tua.”

Abdulmutalibi ia ktheu: “Mbret i nderuar, unë jam pronar i deveve dhe t’i kërktoj ato, kurse Qabeja e ka Zotin, pronarin e vet, që do ta mbrojë atë nga shkatërrimi që ju synoni.”

I habitur nga kjo përgjigje plot urtësi e mençuri, Ebreheja ia ktheu devetë, ndërsa Abdulmutalibi pasi mori devetë, u kthye në Mekë për të kuvenduar edhe një herë me mekasin për mbrojtjen e Qabesë.

Por, më në fund panë se nuk kishin forcë të mjaftueshme që t’i kundërvihen ushtrisë së Ebrehesë, prandaj Abdulmutalibit iu desh të shkonte në Qabe dhe me sy të përplotur u kap për shtyllat e Qabesë, të cilat asokohe ishin dru i thjeshtë, e ngriti kokën kah qielli dhe tha: “O Zot, e lëmë në dorën tënde, sepse ne nuk kemi forcë dhe mundësi që ta mbrojmë.”

Në këtë gjendje, ai dhe gjithë mekasin që ishin rreth e rrotull, u larguan të pikëlluar kodrave të Qabesë, për të parë se çka do të ndodhte më tutje.

Të nesërmen Ebreheja mësyu Mekën deri në luginën Muhassar, vend afër Muzdelifes së sotme, por për çudi elefanti më i madh që kishin me vete për ta shkatërruar Qabenë, atë ditë nuk bënte asnjë hap përpara në drejtim të Qabesë. Kur e kthenin në drejtim të Jemenit, ai merrte vrapin për andej. Njësoj vepronte edhe në drejtim të Shamit, por assesi në drejtim të Qabesë, sepse Krijuesi i tij dhe i gjithçkasë i kishte thënë ‘jo në këtë drejtim’.

Përpjekjet e ushtrisë së Ebrehesë vazhduan me metoda të ndryshme tërë ditën, për t’i detyruar elefantët të hynë në

harem, por gjithçka rezultoi e kotë.

Të nesërmen nga drejtimi i bregdetit u panë tufa të mëdha zogjsh (për formën dhe madhësinë e të cilëve ekzistojnë mendime të ndryshme të komentuesve të Kuranit famëlartë), të cilat kurrë më parë nuk ishin parë. Zogjtë në kthetrat dhe sqepat e tyre bartnin gurë të vegjël.

Këta zogj, me urdhrin e Allahut fuqplotë filluan të gjuanin gurë mbi ushtarët e Ebrehesë dhe i shkatërruan ata.

Të habitur nga një sfidë e tillë e paparë, ushtarët morën arratinë për të ikur. Shumica prej tyre vdiqën rrugës për në Jemen, ashtu siç i zinin gurët e zogjve, të cilët goditnin çdo ushtar veç e veç. Ebreheja, ndërkaq, u godit rëndë nga një sëmundje, prej së cilës i binte mish nga trupit.

Kështu, posa arriti në San'a, vdiq.

Kjo ngjarje ndodhi në vitin e lindjes së Mësuesit të Njerëzisë, Muhamedit (a. s.) dhe përshkruhet gjerë e gjatë në një sure të plotë të Kuranit famëlartë, që mban emrin Suretul-Fil ose Kaptina e elefantit.

Muhamed Abduhu u përpoq që këtë mrekulli t'ia përshtat perceptimit të mendjes njerëzore, duke pretenduar se bëhej fjalë për një lloj epidemie, kolere apo lie, e cila u përhap në mesin e ushtrisë së Ebrehesë, pasi zogjtë hodhën gurët mbi ta me disa mikroba apo viruse! Mirëpo, kësaj teorie iu kundërvunë të gjithë dije-tarët eminentë të botës islame. Ata i hodhën poshtë teoritë e Abduhusë, me fakte të mirëfillta tradicionale-shkencore, duke thënë se ajo që dihet rreth kolerës dhe lisë është se aspak nuk përputhet me atë që është përmendur në Kuran për efektet e ngjarjes mbi trupat e ushtarëve të Ebrehesë. Asnjëra nga këto dy sëmundje nuk shkakton rënien e mishit të gjymtyrëve të trupit të njeriut dhe as që shkakton çarjen e gjoksit. Në këtë rast kemi të bëjmë me një ngjarje të veçantë mbinatyrore, e cila nuk mund të kryhet nga askush tjetër, përpos nga Allahu fuqplotë. Kurse nga ana tjetër, nëse paska qenë virus vdekje-prurës, shtrohet pyetja se pse ky virus kaploi vetëm ushtrinë e Ebrehesë dhe jo edhe të tjerët - a thua, vallë, virusi paska mendje dhe logjike që dikë duhet ta kapë e dikë jo?

Kur Muhamedit (a. s.) i zbriti kjo sure, ende kishte nga ata që nuk e kishin pranuar fenë e Muhamedit (a. s.), të cilët këtë ngjarje e kishin përjetuar dhe ende e kishin të freskët në memorie, por asnjëri prej tyre asnjëherë nuk e mohoi, sepse me të vërtetë kjo kishte ndodhur ashtu siç e përshkruan Kurani famëlartë.

Kjo mrekulli ishte një parashenjë e

madhe e ardhjes së të Dërguarit të fundit, të cilin të gjithë popujt e atëhershëm po e prisnin me padurim - në mos, vallë, do të ishte nga mesi i tyre; si hebrenjtë, ashtu edhe të krishterët.

Por, deshi Allahu fuqplotë që ky i Dërguar të ishte nga arabët, nga fisi më i zgjedhur i tyre kurejsh, kurse nga mesi i këtij fisi kishte zgjedhur më të madhin e njerëzisë - Muhamedin (a. s.), i cili do të barte flamurin e misionit të fundit hyjnor në tokë.

Kështu që, pas gjithë këtyre shenjave dhe paralajmërimeve të shumta që ndodhën, në mëngjesin e 20 prillit të vitit 571, në një shtëpi të vogël në Mekë afër Qabesë, me ballë përpjetë dhe me dorën e djathtë përpara, lindi mëshira e të gjithë botëve, lindi vula e gjithë pejgamberisë, lindi Mësuesi i gjithë Njerëzimit, lindi Muhamedi (a. s.): *Allahume Sali ala Muhammedin ve ala ali Muhamed.*

DISA NGA SHENJAT E LINDJES

1. Në dallim nga të gjitha lindjet e zakonshme, Muhamedi (a. s.) lindi me ballin përjetë dhe me duart përpara, respektivisht me dorën e djathtë përpara. Ai lindi i bërë synet dhe nëna e tij Emineja nuk ndjeu dhimbje të lindjes, siç është zakoni të gratë e tjera në çastet e lindjes!

2. Sipas tregimit të Fatime binti Abdullahut, e cila e shoqëronte Eminen në çastet e lindjes, thotë: "Kur djali doli nga barku i nënës, e gjithë shtëpia u mbush me një ndriçim të fortë dhe yjet filluan të shkëlqejnë aq shumë dhe filluan të afrohen, sa që pata frikë se po na bien sipër. Kjo dritë vinte nga djali i posalindur." Fatimja thotë se 'në gjithë dhomën dhe në krejt shtëpinë nuk pashë tjetër, veçse dritë'. Në transmetimin e Ahmedit thuhet se Emineja në atë dritë kishte parë edhe pallatet e Shamit.

3. Natën e lindjes së Muhamedit (a. s.) i gjithë rruzulli tokësor ishte dridhur.

4. Natën e lindjes dhe tërë ditën e nesërme ishin shembur gjithë zjarret e mbretit të Persisë, sa që tërë ditën kishin tentuar që t'i ndiznin, por s'kishin arritur që ta bënin një gjë të tillë. Kjo tregon se ky që ka lindur do t'i jap fund adhurimit të zjarrit dhe perandorisë dyzetshkulllore persiane. Ashtu siç ndodhi me letrën kur Mësuesi i Njerëzisë ia dërgoi mbretit Kisra, kur ky i fundit e shkeu atë, ndërsa Muhamed Mustafaja (s.a.v.s.) i ngriti duart kah qielli dhe tha: "O Zot, shkyje Perandorinë Persiane ashtu siç e shkyen këta letrën time, ku emri Yt ishte shkruar në të, o Zot."

5. Natën e lindjes së Muhamedit (a. s.) ishin shterur të gjitha ujërat dhe pusët e Palestinës. Kjo simbolizon se ky që ka ardhur në këtë botë do t'i jap fund adhurimit të ujit dhe do të na mësojë se si të shfrytëzohet dhe të pihet uji!

6. Menjëherë pas lindjes, gjyshi i tij Abdulmutalibi e mori në kraharor nipin dhe bashkë hynë në Qabe. Gjyshi i tij tregon se para se të hynte në Qabe, djali i posalindur ishte shumë i qetë, ndërsa në momentin e hyrjes brenda në Qabe, ai filloi të qante pamasë dhe këtë ai thotë se e provoi disa herë. "Sa herë hyja brenda në Qabe, ku ishin mbi treqind idhuj, të cilët ishin adhuruar nga arabët parakuranorë, djali i vogël fillonte të qante aq shumë, sa që disa nga idhujt filluan edhe të rrëzoheshin. Më në fund dola, nga frika që dikush prej shokëve të mi të mund të më hetonte dhe që atëherë pashë se ky fëmijë nuk do të jetë i zakonshëm!"

7. Të nesërmen, Thuvejbeja ia dërgoi lajmin xhaxhait të Muhamedit (a. s.), Ebu Lehebit, për lindjen e nipit, i cili ia fali robërinë Thuvejbesë për këtë lajm të gëzueshëm që i solli. Kjo ngjarje na mëson se me ardhjen e Muhamedit (a. s.) ky sistem do të ndryshojë rrënjësisht: kolonive do t'u jepet fundi, nuk do të ketë më robëri, nëpërkëmbje të nderit, të mallit dhe të pasurisë së njëri-tjetrit!

ARDHJA E PISHTARIT NDRIÇUES, MËSHIRË DHE SHPËTIM I NJERËZISË

Më parë shkruam diç mbi lindjen e Mësuesit të Njerëzisë dhe, nga ajo që elaboruam, pamë se paralindja e tij ishte parashenjë e madhe, lindja e tij ishte mrekulli, ndërsa paslindja e tij ishte shpëtim për tërë rruzullin tokësor.

Kur bota hyri në luginat e defekteve njerëzore, atëherë Allahu (f. p.) e dërgoi Muhamed Mustafanë (s.a.v.s.) dhe ardhja e tij në këtë botë ka kuptimin: e shpëtimit, të mëshirës, të mësimin, të mbrojtjes dhe të radhitjes - që të radhiten përsëri njerëzit në radhët e njerëzisë, pasi që prej Isait (a. s.) kishin kaluar diku pesë shekuj e gjysmë dhe njerëzit kishin dalë nga këto radhë.

Allahu (f. p.) Muhamedin (a. s.) e solli në këtë botë atë ditë kur ishte nevoja më e madhe për të; atë ditë kur njeriu kishte humbur të gjitha vlerat njerëzore; atë ditë kur njeriu e varroste njeriun për së gjalli!

Muhamedi (a. s.) lindi pa baba, sepse ai kishte vdekur disa muaj para lindjes së tij, ndërsa pak më vonë do t'i vdiste edhe e ëma, Emineja. Pra, ai do të mbe-



tej pa të dy prindërit.

Sipas normave dhe rregullave islame, ai duhej të mbetej jetim, sepse, sikur ai të rritej nën mbikëqyrjen dhe kujdesin prindëror, atëherë armiqtë e Islamit, kur ai pas moshës dyzetvjeçare doli dhe proklamoi para botës qartazi sistemin e pavdekshëm kuranor, do të thoshin se ai këtë e ka trashëgim nga prindërit, sepse prindërit qenë ata që ia mbollën këtë edukatë dhe këtë dije, me të cilën ai thërret para botës!

Por jo; ndodhi e kundërta! Prej fillimi e deri në mbarim Allahu (f. p.) atë e mori nën mbikëqyrjen e mëshirës dhe të rahmetit të Vet.

Pas dyzet viteve, faktikisht pasi që filloi t'i zbriste Shpallja, ai në një hadith të vet do të thotë: "Mua më edukoi Zoti im, me edukatën më të mirë."

Muhamedin (a. s.) Allahu (f. p.) e dërgoi mëshirë për të gjitha krijesat. Ai është i Dërguar i njerëzve dhe i xhindve, ai është mëshirë e kafshëve dhe e shpezëve. Ai është mëshirë e bimëve dhe e insekteve. Me një fjalë, ai është mëshira e dërguar për këtë botë dhe për botën tjetër.

Transmetohet nga Xhabiri (r. a.), i cili thotë se i dërguari i Allahut (f. p.) - paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të - ka thënë: "Shembulli im dhe juaji është si shembulli i atij që ndez zjarrin, i cili

padhembshëm përbin karkalecat dhe mushkonjat. Unë përpiqem t'ju mbaj për beli dhe t'ju shpëtoj nga zjarri, ndërsa ju më rrëshqitni nga duart dhe zhyteni e treti në të."

Hadithi flet për shkakun final, për të cilin u dërgua Muhamedi (a. s.) në këtë botë: që i Dërguari (a. s.) të ndihmonte dhe të mbronte ummetin e vet.

Nga analogjia e hadithit nënkuptojmë se i Dërguari (a. s.) bënë krahasim mes një pjese të ummetit të vet dhe një lloji të mushkonjave, të cilat sa herë që shohin flakë, turren e zhyten në të.

Nuk ka dyshim se shërbimet që i bëri Muhamedi (a. s.) njerëzisë në këtë botë janë të paarritshme dhe të pakonkurrencë. Ky pejgamber arriti që në kohën e tij nga një njeri që e konsideronte njeriun krijesë të egër, dhunuese, të pamëshirshme dhe nga një shtresë njerëzish që i groposnin fëmijët të gjallë, të krijojë një popull pjesëtarët e të cilit u bënë etaloni i gjallë i mëshirës e i delikatesës! Barinjte e de-veve, të edukuar dhe të shkolluar para dërrasës së zezë të Muhamed Mustafasë (s.a.v.s.), arritën të bëheshin zotërinjtë e njerëzisë, komandantë të ushtrive dhe krijues të qytetërimeve! Me plot të drejtë atë edhe jomyslimanët e quajtën shpëtimtar të njerëzimit!

Për modestinë, respektin, guximin, trimërinë, të arriturat dhe ndryshimet

rrënjësore që Mësuesi i Njerëzisë i bëri në rruzullin tokësor, kanë folur dhe flasin me qindra dijetarë jomyslimanë, shkruajnë enciklopeditë e ndryshme botërore, flasin politikanët, astronomët, historianët, ekonomistët, si dhe shkencëtarët e mëdhenj botërorë!

Por, të mos harrojmë në asnjë moment se, pa dyshim, këto suksese ai i arriti vetëm me ndihmën e Allahut të madhërishtëm dhe të askujt tjetër. Ai punoi për këtë botë sikur nuk do të vdiste kurrë, kurse për botën tjetër punoi sikur do të vdiste nesër; këtë e dëshmoi si me fjalë, ashtu edhe me vepër.

Përpos kësaj, qëllimi kryesor i dërgimit të Pejgamberit (a. s.) ishte flijimi dhe sakrificimi i tij për tërë ummetin e vet. Ai këtë më së miri do ta dëshmojë në botën tjetër, respektivisht Ditën e Ummitit të vet, ndërsa në pyetjen lidhur me Ditën e Ummitit të Tij, ai tha: "Ditën kur bie me ballë në sexhde dhe i them Allahut tim që t'ma falë edhe njeriun e fundit të Ummitit tim."

Kjo është dita kur njerëzit do të llogariten për veprat e tyre, ditë e cila do të zgjasë sa pesëdhjetë mijë vjet të kësaj bote; dita kur dielli u rri njerëzve mbi kokë; dita kur djersët e njerëzve do të arrijnë deri te veshët e tyre! - Lutjen dhe kërkesën e tij Mësuesi i Njerëzisë e ruajti për këtë ditë!

977), e vizitoi Sicilinë dhe ka shkruar një vepër të posaçme për Sicilinë me emrin "Mehasin ehli Sikilijje (Vetitë e mira të sicilianeve). Në kohën e tij në qytetin e Palermos ka pasur afër 300 xhami dhe secila xhami kishte nga një mualim (mësues).^{vi}

Myslimanët kanë dhënë kontribut të madh në përkthimin e teksteve. Popujt latinë përfituan shumë nga lëvizja e përkthimit në Sicili dhe Salerno. Ndikimi i arabëve në Rilindjen Evropiane përmes Sicilisë dhe Salernos ishte më i madh se gjatë kryqëzatave.^{vii}

Sa i përket letërsisë, shkencave dhe filozofisë arabe, Evropa u ndikua prej tyre nëpërmjet Spanjës dhe Sicilisë.^{viii}

Robert L. Gulick, Jr. thotë: Ua kemi për borxh myslimaneve mirënjohjen tonë që ruajtën, përkthyen dhe ia dorëzuan Evropës veprat e filozofëve grekë.^{ix}

Edhe në trojet shqiptare elementi islam paraosman mund të ketë ardhur përmes Sicilisë. Në shek. VII-IX ishin inkursionet episodike në brigjet shqiptare të arabëve të Sicilisë, të cilët gjithsesi nuk u vendosën në këto anë.^x

Shkencëtarët dhe dijetarët myslimanë futën njohuri shkencore në Evropë. Studiuesit myslimanë ishin drita udhëheqëse të zhvillimit shkencor midis viteve 700-1500 dhe ushtruan një ndikim të thellë mbi historinë e njerëzimit.^{xi} Mjeku Ferexh ibn Salim më 1279 nën patronatin e Karlit I Anzhui përktheu nga arabishtja në latinisht veprën medicinale të Raziut, e cila është vepër enciklopedike.

Banoret e qytetit Lucern në Italinë Jugore (në veri të Barit) ishin myslimanë të shpërngulur nga Sicilia, ata haptazi shfaqnin Islam, thirrnin ezanin e falnin namazin e xhumasë. Më fjalë të tjera, qyteti Lucern me parë kishte qenë i shkatërruar dhe këtë e rindërtoi Frederiku i Dytë në vitin 1233. Në këtë qytet u vendosën myslimanët e shpërngulur nga Sicilia. Myslimanët e këtij qyteti me parë i dëboi nga ky vend Karli II. Ky këtë qytet e quajti Santa Maria.^{xii} Nuk ka asgjë më absurde se një sicilian që flet keq për Islam, kur gjyshërit e tij ishin mysliman. Sepse, kështu është: sicilianët ishin myslimanë, ju pëlqen apo jo! Sicilianët u konvertuan në Islam dhe i qëndruan besnikë atij për shekuj, edhe pas rifutjes së Krishterizmit nga Altavilla. Në të vërtetë, fisnikët më të shquar sicilianë ishin myslimanët në shekujt e parë të Mbretërisë së Sicilisë dhe ata ishin vendas, ndërsa fisnikët e krishterë ishin kryesisht emigrantë, megjithatë kjo epërsi politike u zvogëlua dhe në shekujt në vijim dhe tensionet e shumta çuan në persekutimin

e myslimanëve.^{xiii}

Pas viteve 1300 dhe në shekujt në vijim Italia nuk ka pasur më vendbanime islame të një rëndësie të caktuar, aq sa feja islame as që u konsiderua edhe ndër fetetë me pakicë.^{xiv} Çrregullimet e qëllimshme të historisë kanë mbuluar kontributet e Islamit dhe myslimanëve në qytetërimin njerëzor; për fat të keq, vetë myslimanët kanë pak ose aspak ide për dritën e tyre shpirtërore e cila tani ka humbur famën e saj.^{xv}

EPOKA MODERNE E ISLAMIT NË ITALI

Prania e myslimanëve në Evropën Perëndimore pas Luftës II Botërore llogaritet si dukuri e re. Disa prej tyre erdhën si emigrantë, ndërsa të tjerët u sollën nga kolonizatorët si fuqi punëtore për përsheptimin e progresit dhe zhvillimit ekonomik. P.sh. anglezët sollën shumë myslimanë nga nënkontinenti indian, francezët sollën myslimanë nga Afrika veriore, holandezët nga Indonezia, ndërsa gjermanët që nuk kolonizuan asnjë vend, sollën punëtorë nga Turqia. Në shtetet e tjera evropiane, myslimanët depërtuan nëpërmjet emigrimit dhe sot numri i përgjithshëm i myslimanëve në Evropë llogaritet të jetë jo më pak se dhjetëra milionë.^{xvi}

Dekadave të fundit Islami ka mbërritur në shumë pjesë të Evropës me anë të njerëzve të cilët me kalimin e disa viteve vijjnë në jetojnë, të punojnë dhe të gjejnë strehë në këto vende për arsye të nduarnduarta.^{xvii}

Organizimi i parë kolektiv mes besimtarëve myslimantë në Itali u krijua në vitin 1937, me Shoqatën myslimane të librit, e cila kishte si qëllim "të garantonte shërbimet thelbësore fetare për myslimanët e pranishëm në gadishull, duke u kujdesur gjithashtu për zbatimin e ligjit të Kuranit në fushën civile dhe familjare" (Stefanini, 2004, 110) dhe që u shpërbë me rënien e fashizmit.

Në vitin 1947 një grup i vogël shqiptarësh myslimanë që kishin ikur nga komunizmi themeluan në Romë atë që më vonë do të bëhej Bashkimi Islamik në Perëndim (Uio) deri në vitin 1966 - kur u krijua zyrtarisht Qendra Kulturore Islame e Italisë, e cila do të mbetet organizata e vetme islame e pranishme në Itali. UIO tani është përfshirë në "mësimin e arabishtes për fëmijët e diplomatëve dhe të pasurve tregtarë, dhe përhapja e gjuhës dhe kulturës islame, përmes kurseve dhe mbi-shkrimin e Akademisë së Kulturës Islame, duke redaktuar një revistë ele-

gante kulturore në italisht 'Islami, historia dhe qytetërimi'."

Në Itali, ndryshe nga pjesa tjetër e Evropës (ku protagonistët ishin punëtorët), këtu ishin studentët emigrantë myslimanë që ishin të parët që organizuan me të vërtetë Islam, me themelimin e Unionit të Studentëve Myslimanë në Itali (Usmi) në vitin 1971, në Universitetin për të huaj në Perugia.

Shumë nga udhëheqësit myslimanë me origjinë arabe, veçanërisht nga Lindja e Mesme dhe Palestina, morën arsimin këtu dhe tani janë me shtetësi italiane. Përveç sallës së lutjeve që i paprapriu xhamisë së madhe aktuale në Romë (e inauguruar në vitin 1995), vendi i parë islam i lutjes në Itali në kohët moderne mund të konsiderohet pikërisht Perugia, ku në vitin 1971 USMI themeloi xhaminë.^{xviii}

Me rritjen e emigracionit nga vendet myslimane, ka një evolucion të dukshëm në organizimin e Islamit në Itali. Përqindja e studentëve pëson një rënie të dukshme, përballë flukseve të reja të emigrantëve, të përbërë kryesisht nga njerëz me një nivel të ulët arsimor, të nxitur nga arsye ekonomike. Për më tepër, nëse në mes studenteve shumica e prejardhjes se tyre ishte me origjinë nga Lindja e Mesme, egjiptianë dhe somalez, brenda fluksit të ri të emigrantëve mbizotërojnë marokenët, senegalezët, egjiptianët; këtu përfshihen, pas vitit 1991, shqiptarët dhe myslimanët nga ish-Jugosllavia. Prandaj, USMI pushon së ushtruar një rol mbizotëruës të drejtpërdrejtë në Itali. Në të njëjtën kohë, ish-anëtarët e USMI, të vendosur në Itali, ishin shumë aktivë duke ofruar kontributin e tyre për zhvillimin e organizatave të ndryshme myslimane të sapolindura në forma më të artikuluara, në të cilat ata shpesh vazhdojnë të luajnë role të rëndësishme. Ndonjëherë kalimi nga menaxhimi i USMI në një menaxhim të përbashkët me aktorë të rinj ndodhte me fërkime të brendshme, gjë që çoi në ndarje të mëtejshme organizative, me lindjen e qendrave të reja islame.

Sigurisht, përhapja më e madhe e organizatave dhe e shoqatave me origjinë islame në Itali është zhvilluar nga fundi i viteve tetëdhjetë, për të arritur zhvillimin e saj të plotë në vitet nëntëdhjetë, sipas normave shumë të forta të rritjes.

Nëse në vitin 1993 ishte vlerësuar se xhamitë dhe dhomat e lutjeve në Itali ishin pak më shumë se pesëdhjetë, sot mund të vlerësohet se numri i tyre të paktën është trefishuar: qendrat e reja islame



po hapen si në qendrat urbane që nuk i kishin deri më tani, ashtu edhe në qytetet ku ato tashmë ishin aktive si qendra të themeluara në periudhën e parë.

Nga pikëpamja e aktiviteteve të kryera nga qendrat islame dhe xhamitë, praktika e adhurimit kolektiv vjen pa dyshim e para, e cila shpesh është qëllimi i vetëm i shumë dhomave të lutjeve (mesxhideve) në Itali.

Qendrat më të organizuara, veçanërisht ato në qytetet më të mëdha, kanë botimet dhe revistat e tyre, ofrojnë kurse të gjuhës arabe dhe kurse islame, si dhe shërbime të mirëqenies; në disa raste organizohet edhe Haxhi në Mekë.

Sa u përket praktikave të tjera themelore islame në Itali, myslimanët nuk kanë pasur vështirësi në marrjen e lejeve për të therur kafshë sipas ritit islam, dhe në qytetet kryesore italiane ata kanë hapur thetore dhe mishratore (dyqan mishi), ku është tregtuar mishi i therur hallall në vend. Në disa vendet janë kërkuar dhe marrë leje nga administrata lokale për hapësirat e tyre të varrezave brenda varrezave ekzistuese. Vetë imamët shpesh marrin njohje gjysmëpublike në vend,

dhe lejohen të vizitojnë spitalet dhe burimet si ndihmësit shpirtërorë. Edhe në Itali, si në pjesën tjetër të Evropës, ne jemi dëshmitarë të përhapjes së strukturave dhe të shoqatave myslimane, eksponentët e të cilave bëhen në radhë të parë bashkëbiseduesit e institucioneve vendore, dhe më pas u drejtohen edhe institucioneve shtetërore qendrore.^{xix}

(Teksti që po botojmë këtu në vazhdimë është punim diplome, FSI, Prishtinë, 2021, mentor dr. asoc. Fahrush Rexhepi)

ⁱ Bekare, 21.

ⁱⁱ Dr. Hajredin Hoxha, "Pakicat islame në Evropën Perëndimore dhe Lindore", përktheu Sedat Islam, Furkan Ism fq. 7.

ⁱⁱⁱ Karen Armstrong, Islami, një histori e shkurtër, Tiranë, 2006, fq. 108.

^{iv} Anita Braka, Islami në Itali, <https://www.islamgjakova.net/artikulli.php?id=5286>

^v Nuredin Ahmedi - Mahir Hasani, *Historia islame për vitin e tretë të Medresesë*, 1997, Shkup, fq. 55.

^{vi} Po aty fq. 55.

^{vii} Grupa autora, *Arapsko-Islamski uticaj na evropsku renesansu*, Sarajevo. 1987, fq. 199

^{viii} Mr. Ajni Sinani, *Të tjerët për Islam, Prishtinë*, 2015, fq. 163

^{ix} Mr. Ajni Sinani Të tjerët për Islam, Cit., 174

^x Mr. Samir. B. Ahmeti, Osmanlinjtë dhe metodat e tyre, Në: "Edukata Islame", nr. 89 fq. 208

^{xi} Grup autorësh, *Kontributet myslimane në qytetërimin botëror*. Tiranë, 2019 AIITC, fq. 24

^{xii} Nuredin Ahmedi - Mahir Hasani, *Historia islame për vitin e tretë të Medresesë...*, cit.fq. 58-60

^{xiii} <https://www.tempostretto.it/nees/la-sicilia-lislam-e-la-memoria-corta-del-nostro-passato.html>

^{xiv} Stato, Chiesa e pluralismo confessionale Rivista telematica (eëe.statoe.chiese.it), n. 32, 29 ottobre 2012, fq. 6

^{xv} Grup autorësh, *Kontributet myslimane në qytetërimin botëror...*, cit. f 29

^{xvi} Hajredin Hoxha, *Pakicat islame në Evropën Perëndimore dhe Lindore*, përktheu: Sedat Islam, Furkan Ism fq. 7.

^{xvii} Rejhan Neziri, *Islami dhe myslimanët në Perëndim*, Zvicër, Tetovë, 2004, Hyrje VI

^{xviii} L'immagine delle istituzioni della Repubblica italiana nelle comunità di immigrati Ricerca Ce.Mi.S.S. B5/AA Direttore di ricerca: Fabrizio Battistelli. Ricercatori: Lorenzo Striuli e Leonardo Giannini Consulenza: Andrea Coppi, p. 35.

^{xix} Andrea Pacini, *I musulmani in Italia Relazione tenuta presso la Facoltà di Scienze Politiche dell'Università di Padova nell'ambito del seminario sull'islam in Europa e nel mondo*, organizzato dal GRIM (Gruppo di ricerca su islam e modernità), 29 gennaio 2001 p. 11.

NË MESIN E BESIMTARËVE PËR NGUSHËLLIME



Për ngushëllim te familja Zenku në Gostivar: Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, bëri vizitë ngushëllimi te familja Zenku në Gostivar, me rastin e ndërrimit jetë të bashkëshortes së z. Enver Zenku. Në këtë vizitë Reis'ul-Ulemani e shoqëronin Myftiu i Gostivarit z. Sabahudin ef. Zendeli me bashkëpunëtorë, me ç'rast shprehën ngushëllime të sinqerta në këto ditë dhimbjeje, duke i dëshiruar durim të pasqorë familjes, ndërsa të ndjerës Allahu t'i falë xhenetin e amshueshëm. Enver Zenku është personalitet i shquar në sferën e shkencës, të kulturës, të rrjedhave politike, ndërsa ka qenë dhe Kryetar i Komunës së Gostivarit. Pati guxim e madh që si Kryetar Komune të japë nënshkrimin dhe përkrahjen për hapjen e Universitetit të Tetovës dhe gjithmonë ka qenë i gatshëm të jetë në shërbim edhe të vlerave fetare islame. Andaj, vizita ngushëlluese e BFI të RMV ishte edhe një respekt dhe përkrahje, në këto momente të rënda, për angazhimin e tij në sferën fetare, shkencore dhe kombëtare, thuhet në njoftimin e BFI. (9.08.2022)

Më 15 gusht, 2022, Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët, qëndroi për ngushëllime te disa familje që humbën të afërmit e tyre, thuhet në njoftimin e BFI.

Në Myftininë e Kumanovës, në emër të BFI të RMV i shprehën ngushëllime teologut të mirënjohur, përndryshe imami i xhamisë qendrore në Kumanovë, hoxhë Nazmi ef. Muadinit, me rastin e ndërrimit jetë të bashkëshortes së tij.

Imam Nazmi ef. Muadini tërë jetën ia kushtoi Islamit dhe besimtarëve në pozicion të Imamit, të anëtarit të Myftinisë dhe të Kuvendit të BFI të RMV.

Më pastaj delegacioni i BFI, i udhëhequr nga Reis'ul-Ulemaja, vizitoi familjen Dauti në Likovë, me rastin e ndërrimit jetë të Jonuz Dautit. Familjes së ngushtë të z. Ejup Dauti i shprehën ngushëllime dhe falënderime për pritjen e bërë.

Në këto dy vizita ngushëllimi kreun e BFI të RMV e shoqëroi Myftiu i Kumanovës, h. Abedin ef. Imeri me bashkëpunëtorë.

Në Shkup, ndërkaq, delegacioni ngushëlloi h. Shaban ef. Ahmetin, edukator në SHMI "Medreseja Isa Beu" në Shkup, me rastin e ndërrimit jetë të nënës së tij. Ata falënderuan për pritjen dhe shprehën ngushëllime të thella.

Te të tri familjet u bënë lutje që Al-



lahu fuqiptotë t'u japë durim të pasqorë, ndërsa merhumëve - të ndjerëve t'u falë xhenetin e amshueshëm. BFI e RMV e ka amanet që të respektojë besimtarët dhe aty ku ka kohë dhe mundësi, në momentet e dhimbjes, po edhe të gëzimit, të gjendet në mesin e besimtarëve, thuhet në njoftimin e BFI.



Vizitë ngushëllimi te familja Sadiku në Studeniçan (Shkup): Më 8 gusht, 2022, Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, bashkë me Myftiun e Shkupit dr. Qenan ef. Ismaili vizituan familjen Sadiku, me qëllim ngushëllimi dhe përkrahjeje me rastin e ndërrimit jetë të birit të vetëm të z. Azem Sadiku, Kryetar i Komunës së Studeniçanit. Kryesia e BFI-së u shpreh për durim të paluhatshtëm, me lutje që Allahu (xh. sh.) të ndjerin ta mëshirojë me mëshirën e Tij të pakufishme me xhenet të amshueshëm, thuhet në njoftimin e BFI.





Agjencia për Hallall Standard
Агенција за Халал Стандард
Helal Standard Ajansı
Agency for Halal Standard
مكتب شهادة للمنتجات الحلال



Bashkësia Fetare Islame e R.M.V.

Add: Cairska 52.1000 Skopje, North Macedonia.
Tel: + +389(0)2 3117410; 3117 412.
Fax: + +389 (0)23117 883

websait: www.bfi.mk
email: halal.bfi@gmail.com